



NDIKIMI I FAKTORËVE MAKROEKONOMIK DHE BANKAR NË KREDITË ME PROBLEME TË VENDEVE TË BALLKANIT PERËNDIMOR

Teza e doktoraturës
Fakulteti i Biznesit dhe ekonomisë

Mentori:
Prof. Dr. Shenaj Haxhimustafa

Kandidati:
Sindise Salihi

Shtator, 2020

Përmbajtja

LISTA E TABELAVE:	5
LISTA E FIGURAVE	6
LISTA E GRAFIKONËVE:	6
1. HYRJE DHE QËLLIMET E STUDIMIT	7
1.1. Hyrje.....	7
1.2. Objektivat e studimit	8
1.3. Pyetjet kërkimore.....	10
1.4. Hipotezat.....	10
1.5. Metodologjia e studimit	11
1.6. Rëndësia e studimit.....	13
1.7. Kufizimet e studimit	14
KAPITULLI I:	16
SHQYRTIMI I LITERATURËS TEORIKE DHE EMPIRIKE MBI KONCEPTIN E KREDIVE MË PROBLEME	16
I. 1. Koncepti i kredive me probleme	16
1.1.1 Koncepti i kredive me probleme në tregjet financiare të vendeve të zhvilluara	16
1.1.2 Koncepti i kredive me probleme në vendet e Ballkanit Perëndimor	27
1.1.3 Koncepti i kredive me probleme në literaturën akademike.....	36
I. 2. Shqyrtim i literaturës empirike në lidhje më kredit më probleme	40
1.2.1.Karakteristikat kryesore të studimeve të kredive me probleme.....	40
1.2.2. Studime të kryera për vende të veçantë.....	44
1.2.3 Studime të kryera për disa vende	54
I. 3. Përmbledhja e e literaturës mbi kreditë me probleme.....	58
KAPITULLI II. TRAJTIMI TEORIK I FAKTORËVE QË NDIKOJNË NË KREDIT ME PROBLEME	61
II.1.Trajtimi teorik i faktorëve që ndikojnë në nivelin e kredive me probleme.....	61
II.2. Faktorët makroekonomik	63
2.2.1. Rritja e GDP-së	65
2.2.2. Norma e papunësisë	67

2.2.3. Norma e inflacionit	69
2.2.4. Norma e interesit	71
II.3. Faktorët bankar	73
2.3.1. Niveli i kredisë	78
2.3.2. Treguesi ROE dhe ROA	80
2.3.3. Raporti kredi – aktive	82
2.3.4. Faktorët tjerë bankar	83
KAPITULLI III. METODAT E MATJES DHE TË VLERËSIMIT TË RISKUT TË KREDISË...	86
III. 1. Hyrje në riskun e kredisë	86
III.2 Menaxhimi i riskut të kredisë	89
III.3 Modelet e vlerësimit të riskut të kredisë	93
3.3.1 Analiza themelore e riskut të kredisë	94
3.3.2 Sistemet e vendimarrjes me ekspertë	96
3.3.3 Rrjetet neurale	98
3.3.4 Sistemet e brendshme të vlerësimit	100
3.3.5 Sistemet e pikëzimit të kredisë	103
3.3.6 Koncepti i vlerës në risk (VaR)	106
3.3.7 Metrika e kredisë	107
3.3.8 Modeli Kamakura	115
3.3.9 Modeli KMV i Moody's	116
3.3.10 Krahësimi midis metodave tradicionale dhe të reja të matjes dhe vlerësimit të riskut të kredisë	120
KAPITULLI IV	123
ANALIZË E KREDITIMIT TË SISTEMIT BANKAR TË VENDEVE TË BALLKANIT PERËNDIMOR	123
IV. 1. Vështrim shkurtë i sistemit bankar të vendeve të Ballkanit Perëndimor	123
4.1.1. Sistemi bankar në Republikën e Maqedonisë	125
4.1.2. Sistemi bankar në Shqipëri	126
4.1.3. Sistemi bankar në Mal të Zi	127
4.1.4. Sistemi bankar në Bosnje dhe Hercegovinë	128

4.1.5. Sistemi bankar në Sërbë.....	129
IV.2. Treguesit kryesor të sistemit bankar	131
IV.3. Sistemi kreditimit bankar në vendet e Ballkanit Perindimor	141
4.3.1. Veprimtaria kredituese sipas subjekteve.....	144
IV.4. Kreditë me probleme në sistemin bankar në vendet e Ballkanit Perindimor	154
4.4.1. Arsytet e shtimit të kredive me probleme në sistemin bankar të vendeve të Ballkanit Perëndimor	162
4.4.2. Masat e mara nga Banka Qendrore dhe bankat e nivelit të dytë për uljen e kredive me probleme në sistemin bankar të vendeve të Ballkani Perindimor.....	163
4.4.3. Prespektiva e menaxhimit të kredive me probleme në sistemin bankar të vendeve të Ballkanit Perëndimor	167
KAPITULLI V	170
METODOLOGJIA E HULUMTIMIT DHE TË DHËNAT	170
5.1.1 Modeli Pooled OLS	171
5.1.2 Modelet Fixed dhe Random Effects	172
5.1.3 Modeli me variabla instrumentale.....	174
5.1.4 Metoda e përgjithshme e momenteve (GMM).....	175
5.1.5 Të dhënat e përdorura në analizën empirike	176
5.1.6 Specifikimi i modelit ekonometrik.....	179
5.2. REZULTATET EMPIRIKE.....	183
5.2.1 Lidhja midis kredive me probleme dhe rritjes së GDP-së reale.....	186
5.2 Rezultatet empirike nga regresionet	187
5.2.3 Testi Hausman, testi i homogjenitetit, Breusch-Pagan dhe Arellano-Bond	191
5.2.4 Limitimet e hulumtimit	192
KAPITULLI VI.....	194
KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME	194
LITERATURA E SHFRYTËZUAR	204
APENDIKSI	211

LISTA E TABELAVE:

Tabela 1. Përkufizimet e kredive me probleme (NPL) në vende të ndryshme.....	20
Tabela 2. Klasifikimi i kredive në përputhje me klasifikimin e aktiveve sipas standardeve ndërkombëtare.....	25
Tabela 3. Analiza e definicioneve të kredive me probleme në Maqedoni, Shqipëri, Mal të Zi, Bosnje dhe Hercegovinë, dhe Serbi.....	34
Tabela 4 Faktorët makroekonomikë dhe bankarë që ndikojnë në nivelin e kredive me probleme.....	58
Tabela 5. VaR kur çmimi aksionit $P=80\$$ dhe $\delta p=10\$$	104
Tabela 6. Kategoritë e vlerësimit të kreditit.....	106
Tabela 7. Numri i bankave tregëtare në Bosnje dhe Hercegovinë (2006-2018).....	126
Tabela 8. Ndryshimi vjetor i kredive për subjektet jo-financiare.....	141
Tabela 9. Shkalla vjetore e ndryshimit.....	142
Tabela 10. Kredia, sipas sektorit dhe qëllimit të përdorimit (vlera në miliardë lekë dhe pesha e secilit zë ndaj kredisë gjithsej).....	143
Tabela 11. Struktura sektoriale e kredive.....	145
Tabela 12. Kreditë sipas subjekteve.....	147
Tabela 13. Struktura sektoriale e kredive afatshkurte.....	148
Tabela 14. Struktura sektoriale e kredive afatgjate.....	149
Tabela 15. Kreditë me probleme (përndaja e totalit të kredive).....	151
Tabela 16. Kreditë më probleme në subjektet jofinanciare.....	154
Tabela 17. Përshkrimi i të dhënave dhe burimet.....	173
Tabela 18. Statistika deskriptive e të dhënave.....	174

Tabela	19.	Rezultatet e regresioneve të ndryshme.....	186
--------	-----	--	-----

LISTA E FIGURAVE

Figura (Moody's).....	1.	Qasja makro	73
Figura (Moody's).....	2:	Solveniteti dhe struktura e likuiditetit	75
Figura nervore.....	3:	Skema e rrjetës	97
Figura 4. Mesatarja e kredive me probleme ndër vite për periudhën 2000-2019.....			180
Figura 5. Mesatarja e kredive me probleme për vendet për periudhën 2000-2019.....			181
Figura 6. Lidhja midis kredive me probleme dhe rritjes së GDP real.....			182

LISTA E GRAFIKONËVE:

Grafiku 1. Totali i aktiveve, kredive dhe depozitave në sistemin bankar të Republikës së Maqedonisë.....	128
Grafiku 2. Totali i aktiveve, depozitave dhe kredive në sistemin bankar të Shqipërisë.....	130
Grafiku 3. Totali i aktiveve, kredive dhe depozitave në sistemin bankar të Serbisë.....	132
Grafiku 4. Totali i aktiveve, kredive dhe depozitave në sistemin bankar të Republikës së Malit të Zi.....	134
Grafiku 5. Totali i aktiveve, kredive dhe depozitave në sistemin bankar të Republikës së BeH....	136

1. HYRJE DHE QËLLIMET E STUDIMIT

1.1. Hyrje

Ky studim, ka të bëj pikërisht me sistemin bankar si pjesë e sistemit të përgjithshëm ekonomik, e njëherit segmenti më i rëndësishëm i zhvillimit ekonomik te vendit ngase ky i fundit është njëherit edhe pasqyrë e zhvillimit të sistemit financiar. Sistemi financiar përfaqësohet më së shumti nga sistemi bankar si ndërmjetësi financiar më kryesor në një vend. Bankat janë institucione financiare, që luajnë rolin e ndërmjetësit në ekonomi nëpërmjet kanalizimit të burimeve financiare nga njësitë ekonomike sufiçitare drejt atyre defiçitare. Bankat, si çdo njësi tjetër ekonomike, tentojnë që të maksimizojnë outputin duke përdorur minimumin e inputeve, por jo të gjithë arrijnë të minimizojnë kostot dhe/ose maksimizojnë fitimin, duke mos arritur të prodhojnë me efikasitet të plotë.

Andaj, për të arritur kjo efikasitet e bankave duhet parasegjithash të studjohet ç'ështëja e kredive me probleme si faktorë kryesor që ndikojnë në ecurinë dhe cilësinë e kreditimit të metutjeshëm të sistemit bankar të një vendit, si dhe duke patur parasyshë se vitet e fundit vërejmë një rritje të lartë të

portofolit të kredive me probleme në sistemin bankar të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Faktori kryesor që ka ndikuar në këtë rritje të shpejtë është efekti i krizës ekonomike. Por duhen përmendur dhe faktorë të tjerë siç janë planifikimi i dobët financiar, raportim i situatës financiare jo reale nga huamarrësit, etj. Nivelet e larta të kredive me probleme kanë kufizuar rritjen e sektorit privat, gjë e cila ka ndikuar drejtëpërsëdrejti në uljen e ritmit të rritjes së ekonomisë së vendeve.

Krahas zhvillimeve në sistemin bankar dhe rolit në ekonominë e vendeve të rajonit, rritet edhe nevoja për studime të thelluara mbi sistemin e kreditimit të vendeve të Ballkanit Perëndimor, të shërbimeve që bankat ofrojnë, të menaxhimit dhe të masave që duhet të ndërmeren në lidhje me kredit me probleme me qëllim të sigurimit të stabilitetit të vetë sistemit bankar si dhe të sistemit financiar dhe ekonomik të një vendi.

Në këtë punim do të trajtojmë dy probleme të rëndësishme: I pari, ka të bëjë me analizën e ecurisë dhe cilësisë së portofolit aktual të kredive me probleme në sistemin bankar të vendeve të Ballkanit Perëndimor si dhe i dyti ka të bëjë me identifikimin e shkaqeve kryesore që kanë ndikuar në rritjen e portofolit të kredive me probleme, masat që duhet të ndërmeren nga Bankat Qendrore dhe bankat e nivelit të dytë për uljen e kredive me probleme në sistemin bankar të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Objektivi kryesor në këtë punim është të shpjegojë si dhe pse rritja e volumit të kredive me probleme ndikon negativisht në ritmin e rritjes së disa përcaktuesëve makroekonomike të ekonomive të vendeve të Ballkanit perëndimor. Gjithashtu do të shpjegojmë cilat janë kushtet ligjore dhe sfidat në lidhje me zgjidhjen e problemit të rritjes së volumit të kredive të këqija në vendin e Ballkanit Perëndimor, si dhe do të evidentojmë disa masa parandaluese dhe korrigjuese që duhen marrë për të menaxhuar portofolin e kredive me probleme.

Comment [MOU1]: Cili është i dyti?

1.2. Objektivat e studimit

Objektivat e këtij punimi do të ndahen në dy drejtime kryesore: *analiza e literaturës* në lidhje me fushën e kërkimit mbi kreditë me probleme dhe metodave të vlerësimit të riskut të kredisë; dhe *analiza e situatës aktuale e sistemeve bankare të vendeve të Ballkanit Perëndimor* në lidhje me sistemin kreditues dhe kreditve me probleme.

Trajtimi i literaturës ka objektivat kryesore:

- 1. Analiza e literaturës në fushën e kredive me probleme si dhe e faktorëve që ndikojnë në përcaktimin e tyre: faktorët makroekonomikë sic janë rritja e GDP-së, normës së inflacionit, normës së interesit, normës së papunësisë, që ndikojnë në nivelin e kredive me probleme si dhe faktorët bankar si faktorë të mbrendshëm të sistemit bankar: rritja e nivelit të kredisë, treguesi ROE dhe ROA, dhe raporti kredi/aktive.
- 2. Metodat e matjes dhe të vlerësimit të riskut të kredisë që shumë autorë e lidhin me nivelin e kredive me probleme në një sistem bankar. Në kuadrin e këtij punimi analizohen edhe disa aspekte të lidhjeve që ndikojnë në nivelin e kredive me probleme dhe faktorëve makroekonomik dhe bankar që kanë pasur dhe pritet të kenë një ndikim shumë të madh në ecurinë dhe mbarëvajtjen e sistemeve bankare të ndryshme.

Në lidhje me analizën e situatës aktuale të sistemeve bankar të vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe specifikisht veprimtarisë kredituese dhe kredive me probleme objektivat e punimit janë:

- Analiza e situatës kredituese të sistemit bankar të vendeve të Ballkanit Perëndimor duke bërë një krahasim midis periudhave të ndryshme si dhe duke evidentuar dhe analizuar: kredinë sipas monedhës, kredinë sipas subjektit si dhe veprimtarinë kredituese sipas degëve të ekonomisë;
- Analiza e kredive me probleme në sistemin bankar të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Në këtë çështje analizohen edhe faktorët kryesorë që kanë ndikuar në nivelin e kredive me probleme në mënyrë të hollësishme.
- Analiza e lidhjes midis kredive me probleme dhe disa variablave makroekonomikë dhe bankar me anën e një modeli ekonometrik, ku me anë të regresionit do të shihet se cilët nga variablat e panvarur ndikojnë në variable e nvarur. Rezultatet e këtij modeli ekonometrik interpretohen dhe krahasohen me rezultatet e studimeve të tjera në këtë fushë me qëllim që të evindentohen elementët e përbashkët dhe të ndryshëm të sistemeve bankar të vendeve në Ballkanit Perëndimor me sistemet e tjera bankare.

1.3. Pyetjet kërkimore

Përgjatë hulumtimit rëndësi të madhe paraqet edhe fakti që, në veçanti, do të fokusohemi në përgjigjen e pyetjeve kërkimore, që dalin nga ky studim, sikurse:

- Si është zhvilluar ecuria e sistemit të kreditimit në vendet e Ballkanit Perëndimor?
- Si është situata e kredive më probleme në vendet e Ballkanit Perëndimor?
- Si kanë lëvizur faktorët makroekonomik dhe bankar në vendet e Ballkanit Perëndimor?
- Si kanë ndikuar faktorët makroekonomik dhe bankar në nivelin e kredive me probleme të vendeve të Ballkanit Perëndimor?
- Cilat janë teoritë bazë që mund të shpjegojnë më së miri ndikimin e faktorëve makroekonomik dhe bankar në kreditë me probleme?
- Rritja e GDP-së a ka ndikim në nivelin e kredive me probleme?
- Norma e inflacionit a ka ndikim në nivelin e kredive me probleme?
- Norma e papunësisë a ka ndikim në nivelin e kredive me probleme?
- Norma e interesit a ka ndikim në nivelin e kredive me probleme?
- Rritja e nivelit të kredisë a ka ndikim në nivelin e kredive me probleme?
- Treguesi ROE dhe ROA a ka ndikim në nivelin e kredive me probleme?
- Cilat janë metodat kryesore të trajtuara në literaturën empirike që mundësojnë matjen e ndikimit të faktorëve makroekonomik dhe bankar në nivelin e kredive me probleme?
- Çfarë masashë duhet ndërmarur Bankat Qendrore dhe bankat e nivelit të dytë në vendet e Ballkanit Perëndimor për të zvogluar nivelin e kredisë me probleme?

Disa nga pyetjet hulumtuese do t'u jap përgjigje nëpërmjet qasjes narrative dhe krahasuese, kurse të tjerave me anë të qasjes kuantitative, duke përdorur metoda të sofistikuara ekonometrike. Me qëllim, që t'u jap përgjigje pyetjeve hulumtuese që janë parashtruar në hipotezat në vijim.

1.4. Hipotezat

Ky studim mbështetet në ngritjen e disa hipotezave të cilat priten të vërtetohen me anën e modelit të regresionit që do të përdoret.

Në studim merret si variabël i varur meret treguesi i kredisë me probleme, ndërsa si variabla të pavarur meren disa faktorë makroekonomik dhe disa faktorë bankar.

Comment [MOU2]: Permende regresionin ke objektivat

Faktorët makroekonomikë që merren në shqyrtim janë: rritja e nivelit të PBB-së, norma e inflacionit, niveli i papunësisë dhe norma e interesit të kredive;

Faktorët bankar që merren në shqyrtim janë: rritja e nivelit të kredisë, treguesi ROE dhe ROA, dhe raporti kredi/aktive.

Nën hipotezat e studimit do të përqëndrohen në lidhjen që ekziston midis kredive me probleme dhe variablave të pavarura si më poshtë:

HIPOTEZA 1: Rritja e GDP-së ka ndikim në nivelin e kredive me probleme.

HIPOTEZA 2: Norma e inflacionit ka ndikim në nivelin e kredive me probleme.

HIPOTEZA 3: Norma e papunësisë ka ndikim në nivelin e kredive me probleme.

HIPOTEZA 4: Norma e interesit ka ndikim në nivelin e kredive me probleme.

HIPOTEZA 5: Rritja e nivelit të kredisë ka ndikim në nivelin e kredive me probleme.

HIPOTEZA 6: Treguesi ROA ka ndikim në nivelin e kredive me probleme.

HIPOTEZA 7: Treguesi ROE ka ndikim në nivelin e kredive me probleme.

Të gjitha këto hipoteza do të testohen me anën e modelit ekonometrik ku do të vlerësohet shenja e lidhjes që priten të kenë me variablin e pavarur, si dhe rëndësia e tyre statistikore.

Comment [MOU3]: Te gjitha hipotezat ti ban ne kete format.

1.5. Metodologjia e studimit

Si gjithmonë, duke marrë për bazë qëllimet e formuluar (mësipërm), objektivat e studimit, si dhe pyetjet kërkimore rreth së cilave do të rrotullohet i gjithë studimi, rrjedhimisht kushtëzohet nevoja për përcaktimin e një kornize të përshtatshme metodologjike. Në këtë kontekst, fillimisht, në mënyrë simetrike do të analizohen karakteristikat dhe specifikat e sistemit bankar të vendeve të Ballkanit Perëndimor - ku në këtë drejtim, rëndësi të veçantë do i kushtohet metodës së **analizës strukturore - funksionale** (metoda e analizës strukturore - funksionale, si pjesë e hulumtimit do të bazohet në dokumente dhe raporte zyrtare, punime shkencore, artikuj te ndryshëm, ligje dhe akte ligjore, në lidhje me ndryshimet esenciale të sistemit bankar dhe sistemit të kreditimit). Për të vijuar më tej, **përdorimi i metodës krahasuese** do të jetë dukshëm i pranishëm në këtë studim - metodë, kjo për të

analizuar situatën e sistemit bankar midis vendeve të Ballkanit Perëndimor, respektivisht skenimi i gjendjes në të kaluarën dhe asaj sot, **metodën statistikore** e cila do të konstatoj problemet me të cilat tanimë ballafaqohet sistemi bankar, për ta përmbyllur **me një analizë empirike**, respektivisht përdorimin e një modeli ekonometrik ku do të identifikohen faktorët që ndikojnë në kredit me probleme, të cilët konsiderohen si mjaft të rëndësishëm.

Për të shtjellu këtë çështje, ky studim do merr përsipër të analizoj marrëdhënien mes pesë grupeve të faktorëve makroekonomik që pritet të ndikojnë në nivelin e kredive me probleme edhe atë: rritja e GDP-së, norma e papunësis, norma e inflacionit, norma e interesit si dhe tre faktorëve bankar që priten të ndikojnë në nivelin e kredive me probleme edhe atë: rritja e nivelit të kredisë, treguesi ROE dhe ROA, dhe raporti kredi/aktive.

Ky punim për mbledhjen e të dhënave sasiore ka shfrytëzuar raportet e ndryshme të Bankave Kombëtare dhe Institutit të Statistikave (INSTAT) të cilat më pas janë analizuar me anë të një programi kumpjuterik të quajtur SPSS sipas një modeli ekonometrik.

Të dhënat e përdorura për ndërtimin e modelit ekonometrik në këtë studim janë për një periudhë 19 vjeçare dhe me frekuencë vjetore. Gjithsej kemi 8 variabla nga ku 1 variabël është i varur ndërsa 7 të tjerët konsiderohen si variabla të pavarur ose shpjegues.

Duke marrë parasysh kredibilitetin e gjetjeve mbi kreditë dhe disponueshmërinë e të dhënave statistikore mbi variablat shpjeguese, këto të fundit, më tej do t'i klasifikojmë në grupe të veçanta të faktorëve, edhe atë:

- makroekonomik: rritja e GDP-së, norma e papunësis, norma e inflacionit dhe norma e interesit
- bankar: rritja e nivelit të kredisë, treguesi ROE dhe ROA.

Pra, pas grumbullimit të të dhënave rreth variablave që konsistojnë me grupet e faktorëve të lartpërmendura, do vemë në përdorim metodën statistikore Panel Data - në. Kjo e fundit, si metodë statistikore, gjen përdorim të gjerë në shkencat shoqërore dhe ka për qëllim observimin e të dhënave gjatë dy dimensioneve, sikurse: "Cross Sectional dhe Times Series". Të dhënat në fjalë, do të grumbullohen përgjatë 16 viteve dhe mbi të njëjtin individ (në rastin tonë konkret mbi 5 shtete), e më pas do të drejtohet një regresion mbi këto dy dimensioneve.

Do të startojmë me **POOLED OLS Regression Model**, si model më i thjeshtë (mbi bazë të së cilit krijohen modelet tjera), për të vazhduar me **Fixed Effect, Random Effect apo GMM** - si model më i sofistikuar. Për më tutje, për diagostifikimin nëse POOLED OLS Regression Model është i qëndrueshëm, do të shërbejemi me testin e homogjenitetit (slope homogeneity) dhe Breusch-Pagan testin, kurse rreth asaj

se, a duhet të ndiqet Fixed Effect ose Random Effect do të shërbehemi me Hausman test-in, për ta përmbyllur me GMM. Po ashtu, vendimin në lidhje me atë se, a duhet apo nuk duhet të pranohet hipoteza zero, për secilin test në veçanti, do të marrim për bazë signifikancën në nivel $\alpha = 0.05$. E gjithë kjo (procedura e vlerësimit), do realizohet përmes soëfare-it, STATA 12.

Pra (specifikisht), metodologjia e studimit do të vijoj kryesisht duke i ndjekur hapat e mëposhtëm:

1. Studimin e problematikës së kredive me probleme ne sistemin bankar të vendeve te Ballkanit Perëndimor dhe ndikimin e tyre nga faktorët makroekonomik dhe bankar;
2. Njohjen me bazat teorike dhe analizë e gjetjeve të literaturës së huaj, si dhe e studimeve vendase sa i përket fushës së sistemit bankar dhe kreditimit;
3. Analizë e modeleve dhe eksperiencave më të njohura, sa i përket menaxhimit dhe masat e ndermara në lidhje me kredit me probleme në drejtim të përmirësimit të protofolit të kredisë;
4. Ndërtimi i pyetjeve kërkimore, formulimi i hipotezave dhe mënyra e zhvillimit të tyre;
5. Ndërtimi i modelit empirik, grumbullimi, përpunimi i të dhënave dhe nxjerrja e rezultateve;
6. Nxjerrja e konkluzioneve dhe rekomandimet e ardhshme.

Mbi të gjitha, rrugëtimi im i studimit, do të shoqërohet me pjesëmarrjen time në forume, diskutime dhe konferenca ndërkombëtare (si pjesë të rëndësishme të hulumtimit tim). Në ndërkohë, do vazhdoj me mbledhjen e materialeve (nga simpoziumet, konferencat, forumet dhe librat), që në bashkëpunim me mentorin tim, do t'më shërbejnë për shkrimin e tezës së doktoraturës.

1.6. Rëndësia e studimit

Kreditë me probleme janë një nga treguesit bazë të „shëndetit,, financiar të bankës dhe përfaqësojnë vendosjen kryesore të rrezikut të kredisë në sistemin bankar. Rritja e kredive me probleme tregon se ka një rritje të numrit të agjentëve ekonomikë, të cilët kanë vështirësi në shlyerjen e detyrimeve në bazë të huasë së huazuar, gjë që rrit gjasat që kredia të mos kthehet fare.

Problemet e sistemit bankarë në lidhje me tendencën rritëse të kredive me probleme vazhdojnë të tërheqin vëmendjen e mbarë opinionit por edhe të bëhët shqetësim për Bankat Qendrore edhe bankat e nivelit të dytë të vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe jo vetëm kaq por edhe në raportet vjetor të institucioneve financiare ndërkombëtar sic janë Fondi Monetar Ndërkombetar, Bankës Botërore shprehet ky shqetësim për vendet e Ballaknit Perëndimor sepse kreditë me probleme destimulojnë kreditimin bankar, destimulojnë stabilitetin bankar, destimulojnë stabilitetin financiarë më këtë edhe stabilitetin ekonomik të vendeve të rajonit

Nga ana tjetër, rëndësia e çdo studimi konsiston në aftësinë për të pasuruar dhe shtuar dijet ekzistuese, si dhe në ofrimin e zgjidhjeve për tejkalimin e vështirësive qoftë të aspektit demografik apo atij ekonomik (financiar). Parë nga ky këndvështrim, studimi në fjalë, do të ofrojë një pasqyrë të funksionimit të sistemeve bankare në vendet e Ballkanit Perëndimor, si dhe do t'ju shtohet përpjekjeve të bëra deri më tani - sa i përket krijimit të një sistemi të qëndrueshëm bankar dhe financiarë për Republikën e Maqedonisë dhe vendet e rajonit . Në mes tjerash, nëpërmjet këtij hulumtimi, do të gjenerohen edhe njohuri shtesë të cilat priten të kontribuojnë dhe të jenë sadopak të dobishme për gjithë ata që dëshirojnë të hulumtojnë në lidhje me këtë fushë hulumtuese.

1.7. Kufizimet e studimit

Kredit me probleme, gjegjësisht përmirësimet e protofolit të kredive me probleme, padyshim që zënë një fokus qëndror në diskutet ekonomike kudo në botë. Edhe pse ky studim nuk merr përsipër të mbulojë të gjithë faktorët të aplikuar kudo në botë, prapë se prapë, do mbetet një përpjekje e mirë për të analizuar disa nga ato (në vendet e Ballkanit Perëndimor). Për më tej, studimi do të përqendrohet kryesisht në mënyrën e funksionimit të sistemit bankar të vendeve të Ballkanit Perëndimor, karakteristikat e çdo njërit vendë në veçanti, specifikat e sistemit të kreditimit, ecuria e përcaktuesëve makroekonomik dhe bankar, ndikimin e këtyre përcaktuesve në nivelin e kredive me probleme, shkaqe e rritjes së nivelit të kredive me probleme, duke e përmbyllur me ofrimin mekanizmave (shtesë), sa i përket operimit të sistemit kreditues, masat që duhet ndërmarur për të ndikuar dhe përmisuar këtë gjendje

Po ashtu, përdorimi i modeleve aktuariale lidhur me parametrat makroekonomik dhe bankar, sikurse: shkalla e papunësisë, ritmet e rritjes ekonomike, norma e inflacionit, norma e interesit, totali kredive, totali aktivave, totali i pasivave padyshim që kërkojnë të dhëna të posaçme statistikore. Për rrjedhojë, për këto indikatorë do të mbështetemi me të dhënat e publikuara në: Bankën Botërore, në Entin statistikor, Minsitrinë e financave, Bankën Popullore, FMN - në, etj.

KAPITULLI I:

SHQYRTIMI I LITERATURËS TEORIKE DHE EMPIRIKE MBI KONCEPTIN E KREDIVE MË PROBLEME

I. 1. Koncepti i kredive me probleme

1.1.1 Koncepti i kredive me probleme në tregjet financiare të vendeve të zhvilluara

Viteve të funditë më saktë pas krizës ekonomike financiare 2007 interesi i rrethitë akademik për kreditë me probleme është rritur dukshëm. Shqyrtimi i literaturës siguron informacion të vlefshëm për faktorët që ndikojnë në kreditë me probleme, por përkufizimi i tyre ndryshon në vende të ndryshme, kështu që këto studime janë të vështira për t'u krahasuar dhe duhet të trajtohen më shumë kujdes.

Megjithëse nuk ka ende një përkufizim universal të kredive me probleme, më së shpeshti përdoret definimi nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (*International Monetary Fund* ,FMN), Komiteti i Baselit për Mbikëqyrjen Bankare (*Basel Committee on Banking Supervision* ,BCBS), Instituti për Financat Ndërkombëtare (*Institute for International Finance IIF*), Koordinimit Bankar Evropian iniciativa "Vjena" (*European Banking Coordination "Vienna" Initiative*) dhe Autoriteti Bankar Evropian (*European Banking Authority – EBA*).

Sipas përkufizimit të Fondit Monetar Ndërkombëtar, një kredi është jofunksionale në qoftë se detyrimet në bazë të interesit dhe pagesat e principalit janë të papaguar 90 ditë ose më shumë se 90 ditë, apo kur pagesat e interesit janë kapitalizuar, refinancuara ose vonuar sipas kontratës së paktën 90 ditë, ose kur pagesat janë vonuar më pak se 90 ditë, por ka arsye të tjera të mira për të dyshuar se nuk do të jetë plotësisht e paguar.

Komiteti i Bazelit për Mbikëqyrjen e Bankave rekomandon rrespektimin e rregullit "90 ditë", d.m.th thuhet se "ka ndodhur mosmbushja e obligimeve nëse huamarrësi është vonuar për më shumë se 90 ditë me shlyerjen e detyrimeve ndaj bankës" (BIS, 2006).

Një përkufizim i thjeshtë i kredive me probleme:

Një kredi e cila nuk siguron më të ardhura dhe:

- a. pagesa e plotë e principalit dhe e interesit nuk është paguar,
- b. pagesa e tyre është 90 ose më shumë ditë me vonesë,
- c. data e maturimit ka kaluar dhe pagesa nuk ka përfunduar.

Nga ky përkufizim kredia konsiderohet me probleme kur personi ose subjekti i cili e ka marrë atë në banke bëhet një problem për shlyerjen e saj. Në fillim ka vonesa me dite, të cilat kalojnë në vonesa me jave e pastaj me muaj. Në raste të tilla bankat janë të detyruara të dërgojnë njoftime klienteve për të informuar në lidhje me detyrimet shumë herë. Gjithashtu bankat vënë "gjoka" të cilat i shtohen shumës mujore që huamarrësit duhet të paguajnë në bazë të përqindjes së caktuar të penalitetit në kontratën e huase.

Sipas përkufizimit **Basel II**, një kredi konsiderohet me probleme kur pagesat e interesit dhe principalit kanë vonesë prej 90 ditësh apo më shumë. Kreditë klasifikohen në:

1. Kredi standarte
2. Kredi në ndjekje
3. Kredi nenstandarte
4. Kredi të dyshimta
5. Kredi të humbura

Kredi standarte quhen kreditë e rregullta, dhe që nuk kanë asnjë problematike në afatin dhe shumen e shlyerjes.

Kredi në ndjekje quhen kreditë që paraqesin shenjat e para të vonesave në shlyerje dhe janë nën mbikqyrje nga ana e bankës, por që nuk janë klasifikuar ende si kredi problematike.

Kredi nënstandarte quhen kreditë të cilat nuk klasifikohen si kredi standarte, për shkak të vonesave në shlyerjen e tyre dhe *klasifikohen si kredi problematike*.

Kredi të dyshimta quhen kreditë të cilat kanë vonesa të theksuara në shlyerjen e tyre, por banka ka akoma shpresë në mbledhjen e tyre dhe ato *klasifikohen si kredi problematike*.

Kredi të humbura quhen kreditë të cilat nuk mund të mbliidhen me nga ana e bankes dhe *klasifikohen si kredi problematike*.

Nga sa shpjeguam më lart, kredi me probleme klasifikohen në 3 kategori:

1. Kredi nënstandarde,
2. Kredi të dyshimta,
3. Kredi të humbura.

Një numër i madh i rregullatorëve ndërkombëtarë ndjekin udhëzimet për të përcaktuar kreditë me probleme të siguruara nga Instituti për Financat Ndërkombëtare. Në të vërtetë, Instituti për Financat Ndërkombëtare klasifikon të gjitha kreditë në pesë kategori: standarde, nën vëzhgim, kredi nën standard, të dyshimta dhe të pariparueshme. Sipas tyre, kreditë e këqija janë kredi nga tre grupet e fundit: kreditë nën standard (pagesat e interesit dhe / ose të principalit janë vonuar për më shumë se 90 ditë), kredi të dyshimta (interes dhe / ose pagesa me vonesë më shumë se 180 ditë me vonesë) dhe kredi të pakthyeshme (konsiderohet se kredia kurrë nuk do t'i kthehet kreditorit, d.m.th. kreditori kurrë nuk do të ngarkojë pretendimet e tij, domethënë, debitori me pagesën e principalit dhe / ose interesit është vonuar për më shumë se një vit) (IIF, 1999).

Edhe pse këto përkufizime zbatohen në një numër të madh vendesh, në disa vende konsiderohet se kreditë me probleme janë ato në të cilat huamarrësi është vonë me një shlyerje prej 31 ose më shumë, ose 61 ditë ose më shumë. Megjithatë, numri i vonesave të debitorëve për të shlyer detyrimet e tyre nuk është kriteri i vetëm me të cilin përkufizimet e kredive me probleme ndryshojnë në vende të ndryshme. Kriteret e tjera të klasifikimit përfshijnë kriterin e aftësisë

financiare të debitorit, faktin nëse është filluar një procedim gjyqësor kundër debitorit, nëse një kredi me probleme shfaqet në shumën bruto ose neto dhe shpesh përdoren kriteret e garancisë dhe kolateralit. Meqenëse ka kritere të ndryshme për klasifikimin e kredive me probleme, kriteret për klasifikimin e kredive të shumëfishta të klientit të njëjtë janë të ndryshme. Në disa vende, nëse një kredi klasifikohet si jo-performuese, atëherë të gjitha kreditë e tjera të atij klienti klasifikohen si jo-performuese. Numri i ditëve në borxhe nuk është kriteri i vetëm për përkufizime të ndryshme të NPL-ve ndërmjet vendeve. Ndër elementë të tjerë, ne duhet të veçojmë, për shembull, Rumaninë, e cila për klasifikimin e kredisë përdor kriterin e aftësisë financiare të huamarrësit dhe faktin nëse është iniciuar procesi i ekzekutimit gjyqësor. Gjithashtu, një element i rëndësishëm i përcaktimit të NPL-ve është nëse ato paraqiten në shumën bruto, e cila është standardi i pranuar ndërkombëtarisht ose është një shumë neto. Një çështje tjetër është se si të klasifikohen kreditë e shumëfishta të të njëjtit klient. Në disa vende, nëse një kredi klasifikohet si NPL, atëherë të gjitha kreditë e tjera të të njëjtit klient klasifikohen në të njëjtën mënyrë. Një çështje interesante është çështja e trajtimit dhe roli i kolateralit dhe garancive në procesin e klasifikimit. Disa juridiksione nuk e konsiderojnë kolateralin dhe garancitë për qëllimet e klasifikimit të një kredie në portofol të rregullt ose NPL (Barisitz, 2011).

Andaj, për tu arritur një stabilitet në sektorin financiar dhe sigurimi i kushteve të rregullta të kredisë në Evropën në zhvillim dhe për të shmangur çrregullimet e problemeve financiare në Evropën në zhvillim u mbajtë takimi i grupit punues në Forumin e Iniciativës së Vjenës në vitin 2012. Marrëveshja ka për qëllim koordinimin më të mirë në rregullimin e industrisë bankare dhe të mbikëqyrjes, si dhe të ndalojë përhapjen e ngjarjeve negative mes eurozonës dhe Evropës në zhvillim (Iniciativa e Vjenës, 2012). Iniciativa synon nxitjen e koordinimit mes pritësve dhe vendeve me veprimtari bankare ndërkufitare. Iniciativa e Vjenës¹ ishte nisur fillimisht në 2009, në kulmin e krizës financiare globale, për të ndihmuar në ruajtjen e

¹ Nisma e Vjenës u krijua në përgjigje të krizës globale financiare dhe bashkoi ekspertë nga Fondi Monetar Ndërkombëtar, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, Banka Evropiane e Investimeve, Banka Botërore, Institucioni Evropian (Komisioni Evropian dhe Banka Qendrore Evropiane), autoritete rregullatore dhe fiskale të vendit dhe vendet pritëse të grupeve të mëdha bankare ndërkombëtare dhe të grupit më të madh të bankave që vepron në Evropën Qendrore, Lindore dhe Jug-Lindore (CESEE).

stabilitet të sektorit financiar në Evropën në zhvillim, duke përfshirë dhe duke inkurajuar grupet bankare ndërkufitare për të mbajtur ekspozimin e tyre ndaj rajonit dhe nivelet e duhura të aftësisë paguese për filialet e tyre. Faza e dytë e aktiviteteve të saj është një përgjigje ndaj risqeve të përtërira në rajon, që rrjedhin nga mjedisi ndërkombëtar. Grupet bankare aktive në rajon dhe ato kombëtare, si dhe autoritetet evropiane, duhet të bashkëpunojnë ngushtë në përpjekjet për të ruajtur kushtet e kreditimit që përputhen me rritje të qëndrueshme ekonomike. Bankat nuk kanë rezultuar të jenë tregtare të mira apo menaxhere të kredive me probleme, por situata ka motivuar menaxhimin më të mirë të kredive të këqija. Është e kushtueshme për bankat për të mbajtur kreditë joperformuese (NPL-të), të cilat do të duhet që, gradualisht, të plotësojnë kërkesat e reja minimale ndërkombëtare të kapitalit sipas Bazel-it III. Diskutimi i ndikimit të rregullave të Bazel-it III në Evropën në zhvillim dhe të zgjidhjes së problemeve të NPL-ve është vënë në agjendën aktuale të rregullatorëve dhe bankierëve (Houbenova-Delisivkova, 2014).

Mungesa e një përkufizimi uniform të kredive me probleme, e cila do të mundësonte një krahasim më të besueshme të cilësisë së aseteve bankare në vende të ndryshme, është theksuar edhe në kuadër të Nismës për koordinimin e bankave evropiane, të ashtu-quajtur iniciativa e "Vienës". Në raportin e grupit të punës së iniciativës së "Vienës", e titulluar "Grupi Punues për kreditë me probleme në Evropën Qendrore, Lindore dhe Juglindore " (titulli origjinal: *Ėorking Group on NPLs in Central, Eastern and Southeastern Europe*) është deklaruar se në përcaktimin e kredive me probleme është përdorur rregulla me vonesë prej 90 ditë apo më shumë, kurse raportimi mbulon shumën totale të kredive me një vonesë të tillë (European Banking Coordination "Vienna" Initiative, 2012). Megjithatë, përveç kriterit të vonesave, përdoren edhe kritere tjera për përcaktimin e kredive me probleme (trajtimi i kolateralit, ristrukturimi i kredisë, rinovimi dhe zgjatja e periudhës së shlyerjes së kredisë dhe trajtimin e kredive të tjera të dhëna për të njëjtin huamarrës) dhe janë pikërisht këto që paraqesin problem në përcaktimin e kredive me cilësi të dobët (jokualitative).

Në kuadër të hulumtimit të kryer nga Grupi Punues i Iniciativës së „Vjenës,,, jepen përkufizimet e kredive me probleme në trembëdhjetë vende të Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore. Këto përkufizime kombëtare janë dhënë në tabelë nr.1

Tabela 1. Përkufizimet e kredive me probleme (NPL) në vende të ndryshme

Vendi	Përkufizimet
Bosnja dhe Hercegovina	NPL kreditë janë ato që nuk gjenerojnë të ardhura.NPL-kredit janë ato që plotësojnë kriteret e mëposhtme: 1) principi dhe / ose interesi është i detyrueshëm dhe nuk paguhet për më shumë se 90 ditë (është më shumë se 90 ditë nga data e maturimit fillestar), pas së cilës kërkesa klasifikohet si "nën standard" ", "dyshimta" ose " humbje ") dhe 2)) Kërkesa ndaj debitorit në bazë të interesit që është shkak më shumë se 90 ditë nga data fillestare e maturimit, e cila është kapitalizuar.
Bullgaria	Kreditë standarde janë përcaktuar si kredi që janë në vonesë më pak se 30 ditë. Kreditë që duhet të monitorohen janë huatë në vonesë prej 30 deri në 90 ditë ose kreditë e dhëna debitorit, gjendja financiare e të cilave është e tillë që mund të përkeqësohet dhe të vë në dyshim shlyerjen e huasë në tërësi. NPL-të përcaktohen si kredi që vonohen nga 91 deri në 180 ditë ose kreditë e debitorit gjendja financiare e të cilave është e tillë që mund të përkeqësohet ndjeshëm dhe të rezultojë në pamundësinë për të shlyer kredinë. Kreditë e klasifikuara si "humbje" kanë ardhur për më shumë se 180 ditë ose një debitor kredie, gjendja financiare e të cilës karakterizohet nga një mungesë e përhershme e aktiveve likuide ose rrethana të tjera që përbëjnë bazën që ekspozimi, në bazë të të cilit ka ndodhur rreziku i kredisë, konsiderohet i padobishëm.
Kroacia	NPL-të janë: 1) vendosjet në të cilat është identifikuar një dëmtim i

	pjesshëm (p.sh. vendosjet pjesërisht të rikuperueshme të kategorive të rrezikut B1, B2, B3) dhe 2) vendosjet në të cilat identifikimi i zhvlerësimit është i barabartë me shumën e mbetur të vlerës kontabël të vendosjeve (p.sh. vendosje krejtësisht të pakthyeshme). Vendosjet përfshijnë aktivet financiare në formën e kredive të miratuara, instrumenteve të borxhit dhe të arkëtueshmeve të tjera të klasifikuara si instrumente financiare në kategorinë e instrumenteve financiare - "hua dhe të arkëtueshme" dhe "investime të mbajtura deri në maturim".
Estonia	Kreditë në bazë të të cilave huamarrësi është në vonesë prej 90 ditësh ose kreditë e klasifikuara nga banka si "default" në bazë të informatave të tjera.
Hungaria	NPL-të janë vendosje me një vonesë prej më shumë se 90 ditë. Në rastin e klasifikimit të vendosjeve për klientët e korporatave aplikohet parimi i "klasifikimit sipas debitorit", ndërsa klasifikimi i vendosjeve ndaj personave fizikë zbaton parimin e "klasifikimit të debitorit" dhe parimin e "klasifikimit sipas kontratës".
Kosova	NPL-të përcaktohen si kredi që janë në vonesë për më shumë se 90 ditë dhe përfshijnë kategori të klasifikuara të "dyshimta" dhe "humbje të pakthyeshme (humbje)". Sipas Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, përkufizimet e kredive të dyshimta përfshijnë kreditë me një periudhë shlyerjeje prej 91 deri në 180 ditë, dhe kategoria e humbjes së kredisë përfshin kreditë me një periudhë shlyerjeje më të gjatë se 180 ditë.
Letonia	Termi NPL nuk është definuar. Për qëllime të analizës në raportimin e Grupit të Punës, NPL-të përfshijnë kreditë të cilat janë vonuar për më shumë se 90 ditë.
Lituanian	NPL = kredi me afat maturimi mbi 61 ditë që nuk janë të zhvlerësuara + kreditë të zhvlerësuara + provizione speciale individuale + dispozita të veçanta të grupit

Maqedonia e Veriut	Të gjitha të arkëtueshmet (kreditë, interesat, tarifat) që nuk mblidhen për një periudhë më të gjatë se 90 ditë nga data e maturimit, të cilat banka duhet t'i klasifikojë në llogari të veçanta për kredi me probleme, kreditë, interesat dhe të arkëtueshmet e tjera. Kërkesa mund të përjashtohet nga kategoria e jo-performuese vetëm nëse shuma e arkëtueshmërisë së papaguar trajtohet si jo-performuese në natyrë.
Molldavia	Angazhimet e aktiveve të klasifikuara si "nën standard", "të dyshimta" dhe "të pariparueshme" konsiderohen të cilësisë së dobët.
Mali i zi	Kreditë nën të cilat huamarrësi është në vonesë për më shumë se 90 ditë, dhe ky nuk është kriteri i vetëm. Kreditë e klasifikuara nga banka në kategoritë "nën standard", "dyshimtë" dhe "humbura".
Rumunia	Kreditë në bazë të së cilës huamarrësi është në vonesë për më shumë se 90 ditë dhe / ose kredi në të cilat janë filluar procedurat ligjore të faturimit. $NPL \text{ ratio} = \frac{\text{kredi dhe interesa në borxhe më të gjata se 90 ditë dhe / ose kredi për të cilat janë filluar procedurat ligjore të faturimit}}{\text{shuma bruto e angazhimit bazuar në kreditë dhe interesat e klasifikuar}}$
Slovenija	NPL nënkupton kërkesa të klasifikuara në një vonesë më të gjatë se 90 ditë. Të arkëtueshmet e klasifikuara përfshijnë aktivet financiare me koston e amortizuar dhe disa zëra jashtë bilancit në bazë të të cilave banka është potencialisht e ekspozuar ndaj rrezikut dhe nga e cila mund të lindë detyrimi për të paguar. NPL përfshin shumën totale të kërkesave të klasifikuara (në rast se shuma e detyrimeve të debitorit ndaj bankës tejkalon 1,000 euro, ekspozimi i përgjithshëm i bankës ndaj debitorit kategorizohet si jo-performuese dhe jo vetëm shuma e të arkëtueshmeve të duhura).

Burimi:(European Banking Coordination "Vienna" Initiative, 2012, fq. 15)

Siç mund të shihet në tabelë, dhe sipas këtij hulumtimi, jepen përkufizimet kombëtare të kredive me cilësi të ulët në trembëdhjetë vende të Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore. Bazuar në

analizën e përkufizimeve kombëtare të lartpërmendura, konstatohet se për shumicën e sistemeve bankare në rajon, ekonomitë e tranzitit dhe ekonomitë me performanca të ngjashme, përcaktuesi kyç për kategorizimin e kredive me probleme është numri i vonesave bazuar në balancin e kërkesave kreditore - vonesa më të gjata se 90 ditë. Gjithashtu, baza për llogaritjen e kredive me probleme është shuma bruto e kërkesave për kredi për të cilat huamarrësi është vonuar me pagimin e detyrimit prej 90 apo më shumë ditëve. Gjithashtu, baza për llogaritjen e kredive me probleme është shuma bruto e kredive të arkëtueshme për të cilat huamarrësi vonon të paguajë detyrimin 90 ditë ose më shumë.

Në disa vende, përkufizimi i kredive me probleme bazohet në klasifikimin e kërkesave të kredisë, dhe më pas kreditë me probleme përfshijnë kërkesat e klasifikuara në kredi “nën standarde”, kredi “të dyshimta” dhe kredi të “pakthyeshme (humbje)”, ose kategori më pak kufizuese, “të dyshimta” dhe “kredi të pariparueshme (humbje) ”.

Ndërsa, Autoriteti Bankar Evropian (European Banking Authority – EBA) propozoi harmonizimin e përkufizimeve dhe kriterëve për vlerësimin e kredive me probleme të aktiveve bankare. Bazuar në një analizë gjithëpërfshirëse të cilësisë së aktiveve të bankave në Evropë (analiza është bërë në vitin 2014 dhe ka mbuluar 130 banka në Eurozonë, ose 82% të totalit të aktiveve bankare), EBA krijoi një standard për përcaktimin dhe matjen e ekspozimeve jokualitative (eng. non-performing exposures – NPE) si një qasje më e gjerë sesa kreditë me probleme dhe huatë e ristrukturuar.

Sipas EBA, ekspozimet jo cilësore janë ato që përmbushin njërin ose të dy kriteret e mëposhtme:

- ekspozimi i rëndësishëm material që ka arritur mbi 90 ditë,
- vlerësohet se nuk ka gjasa që huamarrësi të paguajë detyrimet e tij të kredisë në tërësi, pa marrë parasysh realizimin e kolateralit dhe pavarësisht pranisë së ndonjë detyrimi të detyruar ndaj bankës ose numrit të ditëve të vonesës (EBA, 2014, f. 13).

EBA shprehet se ekspozimi duhet të kategorizohet si jokualitative për sasinë e tij totale, pavarësisht nëse ka ndonjë kolateral. Gjithashtu, thuhet se ekspozimi mbulon të gjitha instrumentet e borxhit: kredi, paradhënie, letra me vlerë të borxhit dhe ekspozime jashtë bilancit, por jo ato të mbajtura për tregti. Ekspozimet jashtë bilancit "përbëhen nga zëra të anulueshëm dhe të paanulueshëm: angazhimet për kredi të dhëna, detyrime për garanci financiare të lëshuara dhe detyrime të tjera të dhëna" (EBA, 2014, f. 13). Zbatimi i përkufizimit siguron që të gjitha institucionet financiare të identifikojnë qartë ekspozimet me cilësi të dobët dhe të krahasojnë cilësinë e aktiveve në një mënyrë homogjene dhe të krahasueshme.

Sistemin e klasifikimit të aktiveve bankat e përcaktojnë në mënyrë të pavarur, por duhet të respektojnë standardet e përcaktuara nga institucioni mbikëqyrës. Në sistemet bankare të zhvilluara, bankat kanë disa nën-kategori brenda kredive standarde dhe të mira. Qëllimi i kësaj praktike është të përmirësojë cilësinë e analizës së portofolit dhe të përmirësojë kuptimin e marrëdhënieve midis përfitimit dhe kategorive të rrezikut. Vlera e aktiveve duhet të vlerësohet sistematikisht gjatë periudhës dhe në bazë të kriterëve objektive, dhe e gjithë kjo duhet të shoqërohet me dokumentacion adekuat. Megjithatë, vlerësimi i nivelit të provizionit për humbjet e kreditit përfshijnë një shkallë të caktuar të subjektivitetit, por e drejta diskrecionale e menaxhimit duhet të bazohet në politika dhe procedura të vlefshme.

Siç u përmend tashmë, në disa vende, përkufizimi i kredive me probleme lidhet me klasifikimin e aktiveve të bankave në nivelin e rrezikut. Praktika ndërkombëtare parasheh një sistem të kategorizimit të aktiveve në pesë grupe, gjë që gjithashtu përcakton cilësinë e vendosjeve të kreditit të bankave. Cilësia e portofolit të kredisë të një banke matet nëpërmjet klasifikimit të aktiveve dhe provizioneve për humbje, me qëllim që të vlerësohet probabiliteti nëse huamarrësi do të kthejë kredinë dhe nëse është bërë një klasifikim adekuat i vendosjeve individuale. Vendosjet monitorohen disa herë në vit dhe të paktën sa herë që është në përputhje me kërkesat rregullatore të bankave qendrore të vendeve të veçanta. Natyrisht, banka gjithashtu mund të përshkruajë nëpërmjet akteve të saj të brendshme monitorimin më të shpeshtë të vendosjeve dhe objektivi i monitorimit është të shohë performancën dhe aftësinë e ripagimit të huamarrësit.

Në tabelën 2 paraqiten klasifikimin e kredive sipas standardeve ndërkombëtare që janë në përputhje me klasifikimin e aktiveve bankare.

Tabela 2: Klasifikimi i kredive në përputhje me klasifikimin e aktiveve sipas standardeve ndërkombëtare

Kategorit	Karakteristikat
Asete standarde ose të mira	Kreditë për të cilat nuk janë identifikuar probleme të ripagimit dhe për të cilat rreziku nuk pritet të materializohet gjatë periudhës së ripagimit
Asetet, që kërkon vëmendje të veçantë	Kreditë me dobësi faktike, por për të cilat, megjithatë, asnjë humbje apo klasifikim nuk pritet në një kategori nën standard.
Asetet me cilësis më të ulët se standardi (i rëndomtë)	Kreditë në të cilat pozita financiare e debitorit, si dhe kolaterat e vendosura, nuk i siguron bankës mbrojtje të besueshme ndaj humbjeve.
Kërkesat e dyshimta dhe të diskutueshme	Kreditë e papërshtatshme me rreziqe shtesë dhe për të cilat përpjekjet e bankës për të mbledhur të ardhmësit janë të pasigurta deri në shkallën e kompensimit të kapitalit të saj.
Humbje	Kreditë që konsiderohen si jo të rikuperueshme, për të cilat debitorët nuk kanë vullnet dhe aftësi për të shlyer, dhe instrumentet për sigurimin e vendosjeve të tilla kanë humbur vlerën e tyre origjinale ose nuk ekzistojnë fare. Për kreditë e tilla mund të ketë ende një mundësi faturimi, por përpjekjet shtesë për të realizuar mundësi të tilla konsiderohen të paarsyeshme ose të pajustificuara. Bilanci i kredive në këtë kategori shlyhet nga bilanci i bankës.

Burimi: (IFC Corporation Advisory Services, access to Finance, 2011, fq. 3)

1.1.2 Koncepti i kredive me probleme në vendet e Ballkanit Perëndimor

Në lidhje me definicionin se çfarë janë kredite me probleme, duhet të theksohet se jo të gjitha vendet përdorin të njëjtin përkufizim, mund të ndodhë që dallime mund të gjenden brenda një vendi, të cilat ju referohen sektorëve të ndryshëm. Sidoqoftë, tendenca e përgjithshme në vendet është të zbatohet rregulli 90-ditor Freeman (2007). Ndërkombëtarisht, sipas IMF's Compilation Guide on Financial Soundness Indicators një kredi është jo performuese nëse interesat dhe kryegjeja janë të papaguar për 90 ditë ose më shumë se 90 ditë, ose kur pagesat e interesit kapitalizohen, rifinancohen ose shtyhen me kontratë të paktën 90 ditë, ose kur pagesat janë më pak se 90 ditë të papaguara, por ka edhe arsye të tjera të mira për të dyshuar se nuk do të paguhet plotësisht.

Trajtimi i kredive me probleme dhe administrimi i përgjithshëm i rrezikut të kredisë të bankave në Maqedoni rregullohet me Vendimin për menaxhimin e rrezikut të kredisë të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë Nr. 50/13). Sipas Vendimit, rreziku i kredisë është një rrezik i humbjes për bankën për shkak të paafësisë së klientit të saj për të shlyer detyrimet ndaj saj, në shumën e rënë dakord dhe / ose brenda afateve të dakorduara. Për qëllim të përcaktimit më të qartë të pamundësisë së shlyerjes së detyrimeve, këto janë kategoritë e ndryshme të ekspozimit të kredisë bankare:

1. Rreziku i kategorisë "A", duke përfshirë kushtet e mëposhtme:

- pjesa e ekspozimit të kredisë të siguar me kolateral të shkallës së parë nëse instrumenti aktivizohet brenda 60 ditëve nga maturimi i atij ekspozimi;
- pozicioni financiar dhe flukset e parave të klientit mundësojnë funksionimin e tij të mëtejshëm dhe mundësinë e shlyerjes së detyrimeve rrjedhëse dhe të ardhshme ndaj bankës;

- detyrimet në bazë të ekspozimit të kredisë ekzekutohen në maturim ose me vonesë deri në 31 ditë; ose

- nuk është bërë asnjë ristrukturim i kërkesave të klientit në dymbëdhjetë muajt e fundit.

2. Kategoria e rrezikut "B", në të cilën përfshihen kriteret e mëposhtme:

- klienti tregon dobësi financiare, por hyrjet e parave të tij janë të mjaftueshme për shlyerjen e rregullt të detyrimeve të detyruara;

- detyrimet e ekspozimit të kredisë zakonisht shlyhen me vonesë deri në 60 ditë, ose me përjashtim deri në 90 ditë, nëse vonesa është vetëm herë pas here në intervalin prej 61 deri 90 ditë; ose asnjë ristrukturim i ekspozimit të kredisë nuk ka ndodhur në gjashtë muajt e fundit,

3. Kategoria e rrezikut "V" e cila përfshin kriteret e mëposhtme:

- hyrjet e parave të klientit janë të pamjaftueshme për shlyerjen e rregullt të detyrimeve;

- ekziston një strukturë e papërshtatshme kohore midis burimeve të financimit të programit / projektit për të cilën kërkohet mbështetje financiare nga banka dhe prurjet e programit / projektit

- banka nuk ka informacionin e nevojshëm dhe të azhurnuar për të vlerësuar aftësinë e klientit;

- ekspozimi i kredisë është ristrukturuar;

- detyrimet e ekspozimit të kredisë zakonisht shlyhen me vonesë deri në 120 ditë, ose me përjashtim 180 ditëve, nëse vonesa është vetëm e rastit në intervalin prej 121 deri në 180 ditë;

- klienti - një entitet jo financiar ka kërkesa për një kredi financiare nga një person me një vlerësim kredie të barabartë ose më të ulët se CCC + (sipas vlerësimit të „Standard & Poor's ose Fitch,,) ose Caa1 (sipas vlerësimit të Moody's) ose nga një person me një vlerësim më të lartë kredie, por me seli në një vend, vlerësimi i kredisë i të cilit është i barabartë ose më i ulët se CCC + (sipas vlerësimit të Standard & Poor's ose Fitch) ose Caa1 (sipas Moody's), ose

- klienti - një entitet jo-financiar ka kërkesa për një kredi financiare nga një person për të cilin nuk është vendosur vlerësim krediti, por është i vendosur në një vend, vlerësimi i kredisë i të cilit është i barabartë ose më i ulët se B- (sipas vlerësimit të Standard & Poor's ose " Fitch ") ose B3 (sipas vlerësimit të Moody's) ose është i vendosur në një vend për të cilin nuk është vendosur vlerësim krediti;

4. Kategoria e rrezikut "G" e cila përfshin kriteret e mëposhtme:

- klienti është jolikuid;
- pagesa e ekspozimit të kredisë varet nga aktivizimi i kolateralit;
- detyrimet e ekspozimit të kredisë zakonisht ekzekutohen me vonesë deri në 240 ditë, ose me përjashtim deri në 300 ditë, nëse vonesa është vetëm rastësore në intervalin 241 deri 300 ditë, përveç detyrimeve të caktuara specifike të përcaktuara në Vendim;
- klient (përfshirë qeveritë dhe bankat qendrore) me vlerësim krediti të barabartë ose më të ulët se CCC + (sipas vlerësimit të Standard & Poor's ose Fitch) ose Caa1 (sipas vlerësimit të Moody's);
- klienti ka një vlerësim kredie më të lartë se vlerësimi i deklaruar, por është i vendosur në një vend, vlerësimi i kredisë i të cilit është i barabartë ose më i ulët se CCC + (sipas vlerësimit të Standard & Poor's ose Fitch) ose Caa1 (sipas " Moody 's); ose
- klienti nuk ka një vlerësim krediti, por është i bazuar në një vend, vlerësimi i kredisë i të cilit është i barabartë ose më i ulët se B- (sipas vlerësimit të Standard & Poor's ose Fitch) ose B3 (sipas Moody's) ose me seli në një vend për të cilin nuk është vendosur vlerësim krediti;

5. Kategoria e rrezikut "D" e cila përfshin kriteret e mëposhtme:

- detyrimet e ekspozimit të kredisë zakonisht shlyhen me një vonesë më shumë se 241 ditë, përveç detyrimeve të caktuara specifike të përcaktuara në vendim;
 - ka filluar procedura e falimentimit ose e likuidimit ndaj klientit;
 - klienti kundërshton ekzistencën e ekspozimit të kredisë (në gjykatë ose në procedurë jashtë gjykatës), ose
 - banka pret që të arkëtojë vetëm një pjesë të vogël të ekspozimit të kredisë ndaj klientit.
- Në këtë mënyrë, trajtimi i aktiveve që nuk funksionojnë do të jenë ato që bëjnë pjesë në kategoritë e lartpërmendura të rrezikut "G" dhe "D", si dhe marrëveshje individuale të ekspozimit të kredisë të klasifikuara në kategorinë rreziqeve "V", të cilat për çfarëdo baze (principali, interesi, të ardhura jo-interesi të tjera) nuk tarifohen për më shumë se 90 ditë duke llogaritur nga data e arritjes, me shumën e papaguar mbi 90 ditë më shumë se:

- 1.000 denarë për ekspozimin ndaj personave fizikë,

- 3,000 denarë për ekspozimin ndaj ndërmarrjeve të vogla;

- 10,000 denarë për ekspozimin ndaj personave të tjerë juridikë.

Si një përjashtim, banka mund të konsiderojë që një marrëveshje e ekspozimit të kredisë e klasifikuar si një kategori rreziku "V" si jo-performuese, e cila për çdo bazë nuk arkëtohet më shumë se 90 ditë pas maturimit, por banka është e detyruar ta bëjë këtë. Përdoret për të gjitha ekspozimet, pavarësisht shuma e papaguar, lloji i ekspozimit dhe klienti për ta rregulluar atë me vete aktet e brendshme.

Me këtë rishikim rregullator të kredive jofunksionuese, mund të konkludohet se trajtimi i kredive jofunksionuese në Maqedoni në thelb korrespondon me klasifikimin e përgjithshëm ndërkombëtar të listuar më lart.

Në Republikën e Shqipërisë sipas rregullores “Për administrimin e riskut të kredisë” dhe të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të neneve 57, 58, 61 dhe 68 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" klasifikimi i kredive për bankat dhe degët e bankave të huaja, të licencuara nga Banka e Shqipërisë për të ushtruar veprimtari bankare dhe / ose financiare në Republikën e Shqipërisë, do të bëhet të paktën një herë në 3 muaj në një prej kategorive të mëposhtme duke u bazuar në ditëvonesat në shlyerjen e kredisë dhe gjendjen financiare të kredimarrësit:

1. kredi standarde;
2. kredi në ndjekje;
3. kredi nënstandarde;
4. kredi të dyshimta;
5. kredi të humbura.

Kreditë janë “standarde” kur kryegjëja ose interesi nuk është paguar për një periudhë prej 1 deri 30 ditësh nga data e pagesës së kështit.

Kreditë vlerësohen në kategorinë “*në ndjekje*” kur kryegjëja ose interesi nuk është paguar për një periudhë prej 31 deri 90 ditësh nga data e pagesës së kështit.

Nënstandarde vlerësohen ato kredi për të cilat kryegjëja ose interesi nuk është paguar për një periudhë prej 91 deri 180 ditësh nga data e pagesës së kështit.

Të dyshimta kur kryegjëja ose interesi nuk është paguar për një periudhë prej 181 deri 365 ditësh nga data e pagesës së kështit.

Të humbura kur kryegjëja ose interesi nuk është paguar për një periudhë prej më shumë se 365 ditësh nga data e pagesës së kështit.

Proçesi i vazhdueshëm i shqyrtimit dhe klasifikimit të kredive lejon bankat që të monitorojnë cilësinë e portofoleve të kredive, dhe aty ku është e nevojshme të ndërmarrin veprimet korrigjuese për t’iu kundërpërgjigjur përkeqësimit të cilësisë së kredisë të portofoleve të tyre.

Në sistemin bankar shqiptar bankat vlerësojnë dhe klasifikojnë kredimarrësit në bazë të gjendjes së tyre financiare. Ky vlerësim realizohet sipas kriterëve të brendshme të përcaktuara nga bankat, dhe duke bërë një ndarje të kredimarrësve sipas kategorive të riskut që ata paraqesin. Përkufizimi i kredive me probleme ndryshon shumë në vende të ndryshme dhe një krahasim i tyre duhet bërë me shumë kujdes. Megjithatë sipas përkufizimit më të përdorur në literaturë dhe praktikë, një kredi vlerësohet si kredi me probleme kur kredimarrësi nuk ka mundësi të shlyejë detyrimet pranë bankës ose kur ai paraqet vonesa në shlyerjes së kredisë për më shumë se 90 ditë nga afati. Gjithashtu sipas Institutit Ndërkombëtar të Financave për përafrimin e mënyrës së krahasimit të kredive me probleme midis vendeve të ndryshme për efekt të raportimit tek bankat qëndrore, përdoren pesë kategori kredisë: standarde, në ndjekje, nënstandarde, të dyshimta dhe të humbura. Në pjesën më të madhe të vendeve, ashtu si edhe në Shqipëri, kredi me probleme vlerësohen vetëm 3 kategoritë e fundit.

Në Bosnje dhe Hercegovinë, zbatohet një parim relativisht i ngjashëm i klasifikimit të aseteve bankare, si dhe në sistemet bankare të vendeve të zhvilluara. Po ashtu, për secilën kategori të aktiveve ndahen rezerva të caktuara për humbjet e kredisë. Banka Qendrore e Bosnjës dhe Hercegovinës (CBBH), me "Vendim mbi standardet minimale për administrimin e rrezikut të

kredisë dhe klasifikimin e aktiveve të bankave", përcaktoi standardet dhe kriteret minimale që banka është e detyruar të respektojë gjatë klasifikimit të aktiveve të saj.

Në përputhje me dispozitat e Vendimit, banka është e detyruar të klasifikojë zërat e aktiveve që janë të ekspozuar ndaj rrezikut të kredisë në pesë kategori, së paku njëherë në tremujor, dhe këto kategori janë: A - aktive të mira, B - aktive me shënim të veçantë, C - aktive nënstandarde, D- aktivet e dyshimta dhe E-humbja (CBBH, 2011, fq.10).

Ky Vendim gjithashtu definon aktivet jo-performuese që përfaqësojnë asetet që nuk sjellin të ardhura dhe banka është e detyruar të trajtojë si aktive me probleme çdo aktivë nëse:

- principi dhe / ose interesi janë maturuar dhe nuk paguhet për më shumë se 90 ditë nga data e maturimit të tyre kontraktual të përcaktuar fillimisht, gjegjësisht kur ato klasifikohen në kategoritë C, D, E,
- detyrimet e përdoruesit për interesin, për të cilin huamarrësi ka qenë vonë me pagesën më shumë se 90 ditë nga maturimi i tyre fillestar kontraktual, janë të kapitalizuara (CBBH, 2011, faqe 7).

Është e rëndësishme të theksohet se banka është e detyruar "të krijojë sistemin e vet për klasifikimin e zërave të aktiveve që saktësisht dhe qartë përcaktojnë kriteret për marrjen e një vlerësimi të ri dhe vlerësimin e rrezikut ekzistues të kredisë" (CBBH, 2011, f.6), dhe minimumi i këtyre kriterëve është përcaktuar në vendimin e mësipërm . Përveç kësaj, banka është e detyruar të llogarisë rregullisht rezervat për humbjet e kreditit dhe baza për llogaritjen e rezervave është vlera e llogarisë bruto e të arkëtueshmeve.

Sipas Vendimit për Klasifikimin e Pasurive të Bilancit të Bankës dhe Zërave jashtë bilancit, bankat në Republikën e Serbisë janë të detyruara të klasifikojnë të gjitha kërkesat nga një huamarrës, përveç kërkesave të përjashtuara posaçërisht nga Vendimi, në kategoritë A, B, V, G dhe D — bazuar në kriterin e afatit, pra vonesën në shlyerjen e detyrimeve të këtij huamarrësi ndaj bankës, në bazë të vlerësimit të pozicionit financiar të huamarrësit , gjegjësisht besueshmëria e kredisë, dhe mbi bazën e cilësisë së kolateralit. Kërkesat nga huamarrësit klasifikohen si më poshtë ("Vendimi për klasifikimin e pasurive të bilancit bankar dhe zërave jashtë bilancit"):

(1) Kategoria A:

- (a) Kërkesat nga huamarrësi me të cilin, në bazë të vlerësimit të pozicionit financiar, d.m.th. besueshmëri, nuk priten probleme në mbledhje;
- (b) Kërkesat e siguruara nga kolaterali kryesor;
- (c) Kërkesat për të cilat huamarrësi zgjidh detyrimet në kohë ose është në vonesa jo më të gjatë se 30 ditë;

(2) Kategoria B:

- (a) Kërkesat nga huamarrësi, pozicioni financiar i të cilit, d.m.th. aftësia e kredisë nuk është plotësisht e kënaqshme për shkak të problemeve të caktuara, por nuk tregon përkeqësim të ndjeshëm në të ardhmen;
- b) Kërkesat për të cilat huamarrësi është në vonesë midis 31 dhe 60 ditëve;

(3) Kategoria V:

- (a) Kërkesat nga huamarrësi, pozicioni financiar i të cilit, d.m.th. aftësia e kredisë nuk është e kënaqshme dhe tregon përkeqësimin në të ardhmen;
- (b) Kërkesat për të cilat huamarrësi është në vonesë midis 61 dhe 90 ditëve;

(4) Kategoria G:

- (a) Kërkesat nga huamarrësi, pozicioni financiar i të cilit, d.m.th. aftësia e kreditit tregon probleme të rëndësishme në aftësinë për të mbledhur këto kërkesa, veçanërisht kërkesat nga një huamarrës jolikuid ose falimentues;
- (b) Kërkesat për të cilat huamarrësi është në vonesë midis 91 dhe 180 ditëve;

(5) Kategoria D:

- (a) Kërkesa me bazë ligjore të dyshimtë ose të diskutueshme;
- (b) Kërkesat nga huamarrësi në likuidim ose falimentim;
- (c) Kërkesat nga huamarrësi që nuk veprojnë në përputhje me planin e miratuar të riorganizimit, në drejtim të ligjit që rregullon falimentimin;
- (d) Kërkesat nga huamarrësi, ndërmarrje e re e krijuar, së cilës banka i ka caktuar kërkesa;
- (e) Kërkesat për të cilat huamarrësi është në prapambetje më të gjatë se 180 ditë;
- (f) Kërkesat që nuk janë të pranueshme për klasifikim në kategori të tjera nga kjo pikë;

(g) Kërkesat nga huamarrësi që kishin maturuar në bankë, të cilat ishin caktuar në tre vjetët e fundit.

Kur bëhet fjalë për Republikën e Serbisë, të gjitha kërkesat që rrjedhin nga kreditë mund të klasifikohen në kategoritë V, G, dhe D. Një nga pasojat e dukshme të krizës financiare është paqëndrueshmëria e sektorit financiar, i cili ngadalëson ndjeshëm përpjekjet për rimëkëmbje ekonomike dhe del nga recesioni që filloi në vitin 2008 në shumicën e ekonomive të botës. Një problem shtesë që shfaqet në NPLs është prania e të ashtuquajturit Efekti i kthimit (NPLs → ekonomia), i cili pasqyrohet në përkeqësimin e mëturshëm të aktivitetit ekonomik: Një rritje e NPL-ve dobëson performancën makroekonomike të ekonomisë, duke aktivizuar kështu "rrethin e mbrapshtë", në të cilin problemet e sektorit bankar dhe rënien e ekonomisë aktiviteti reciprokisht përforcon njëri-tjetrin. Është e zakonshme që krizat bankare shoqërohen me një pjesë të lartë të NPL në totalin e aktiveve të sektorit bankar.

Kredia me problem është definuar me Vendimin e Raportimit Bankar ("Gazeta Zyrtare RS", Nr. 125/14 dhe 4/15) - Programi 8 (NPL 1), si bilanci i borxhit të përgjithshëm të një kredie individuale (përfshirë shumën e prapambetjeve):

- në bazë të të cilave debitori është në vonesa (në mënyrën e përcaktuar me vendimin që rregullon klasifikimin e aktiveve të bilancit dhe artikujve jashtë bilancit të bankës) për më shumë se 90 ditë, ose me pagimin e interesit ose të principalit,
- në të cilën interesi në shumë prej tre muajve (ose më shumë) i atribuohet borxhit, kapitalizuar, rrefinancuar ose shtyrë,
- në bazë të së cilës debitori është më pak se 90 ditë me vonesë, por banka ka vlerësuar se aftësia e debitorit për të shlyer borxhin është zhvlerësuar dhe se shlyerja e plotë e borxhit është vënë në dyshim.

Në Kroaci: NPL janë 1) vendosje për të cilat identifikohen prova të dëmtimit të pjesshëm, d.m.th. vendosje pjesërisht të rikuperueshme (kategoritë e rrezikut B-1 / B-2 / B-3), dhe 2) vendosje për të cilat identifikohen prova të dëmtimit, të barabarta me shumën e tyre mbajtëse, gjegjësisht vendosjet plotësisht të pakthyeshme (kategoria e rrezikut C). Vendosjet nënkuptojnë aktivet financiare në një formë të kredive të dhëna, instrumenteve të borxhit dhe arkëtimeve të

tjera, klasifikuar nga një institucion krediti në kategoritë e instrumenteve financiare të përcaktuara si "kredi dhe arkëtime" dhe "investime të mbajtura deri në maturim".

Mali i Zi i përcakton NPL-të si kredi të kaluara më gjatë se 90 ditë, pa interesa, parapagime dhe akruale. Gjegjësishtë, NPL-të konsiderohen si kredi të vonuara më shumë se 90 ditë, por ky nuk është kriteri i vetëm. NPL-të korrespondojnë me kreditë "standarde", "të dyshimta" dhe "humbje".

Është gjithashtu shumë e rëndësishme të krahasohet përkufizimi i kredive me probleme në Maqedoni dhe vendet e rajonit (Shqipëri, Mali i Zi, Bosnje dhe Hercegovinë dhe Serbi). Objektivi kryesor i analizës është të përcaktojë nëse të njëjtat kritere janë përdorur në klasifikimin e kredive me probleme dhe nëse niveli i tyre në këto vende mund të krahasohet. Analiza përdor rregullin e vonesës së "90 ditëve dhe më shumë ditëve" si përcaktues kryesor i kredive me probleme. Rezultatet e analizës janë dhënë në Tabelën nr.3.

Tabela 3: Analiza e definicioneve të kredive me probleme në Maqedoni, Shqipëri, Mali të Zi, Bosnje dhe Hercegovinë, dhe Serbi

Vendi	Burimi	Rregulla "Kryegjeja dhe / ose interes vonën 90 ditë dhe më shumë"
Maqedonia e Veriut	Banka popullore e Republikës së Maqedonisë	Po
Shqipëria	Banka Kombetare	Po
Mali i zi	Banka qendrore e Malit të zi	Po
Bosnja dhe Hercegovina	Banka qendrore e Bosnjes dhe Hercegovines	Po
Serbia	Banka popullore e Serbise	Po

Burimi: Bankat Qendrore të vendeve të listuara përshtatur nga autori.

Bazuar në analizën e përcaktimit të kredive me probleme në Maqedoni dhe katër vendeve në rajon (Mali i Zi, Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë dhe Serbia), mund të konkludohet se kur klasifikohet, përdoret rregulli i pagesës së vonuar të principalit dhe / ose interesit prej 90 ditësh ose më shumë. Për shkak të ngjashmërisë së definicioneve të mësipërme, është e mundur të krahasohet niveli i kredive me probleme në Maqedoni dhe vendet e listuara të rajonit. Objektivi

kryesor i krahasimit është të shikojmë cilësinë e portofolit të kredive të këtyre vendeve të Ballkanit, sepse cilësia e portofolit të kredive është një përcaktues i rëndësishëm në strategjitë e ardhshme të bankave.

Bazuar në të gjitha përkufizimet e mësipërme dhe klasifikimi i kredive me probleme në vende të ndryshme, mund të konkludohet se nuk ekziston një standard uniform dhe përgjithësisht i pranuar për përcaktimin e kësaj kategorie të vendosjes së kredive të bankave. Megjithatë, në shumicën e rasteve, karakteristika kryesore e kredive me probleme është numri i ditëve të vonesës në shlyerjen e detyrimit ndaj bankës. Në shumicën e përkufizimeve kombëtare është vonesa e "90 ditëve ose më shumë". Më tej, mund të konkludohet se bilanci i principalit dhe / ose interesit kryesor kryesisht merret parasysh gjatë llogaritjes së vonesës, ndërsa e gjithë shuma e kredisë, pagesa e së cilës është vonë, kategorizohet si problematike. Për shkak të rreziqeve të kredive me probleme që ndikojnë në performancën e bankave, vëmendje e veçantë i kushtohet vëzhgimit në kohë të debitorëve, vendosjeve dhe kolateralit në sektorin bankar. Bankat formohen nga njësi të veçanta organizative që merren me vendosje me nivele të rritura të rrezikut të identifikuar, sepse vetëm në këtë mënyrë mund të monitorojnë rreziqet dhe të reduktojnë pasojat negative që mund të shkaktojnë.

1.1.3 Koncepti i kredive me probleme në literaturën akademike

Shumica e analistëve ekonomikë besojnë se kreditë me probleme janë një nga shkaqet kryesore të stagnimit ekonomik. Çdo kredi me probleme është një reflektim i drejtpërdrejtë i gjendjes së keqe të klientit të bankës dhe një pasqyrim i tërthortë i gjendjes së keqe në ndërmarrjes. Niveli i kredive me probleme në aktivet e sektorit bankar ndikon në vlerësimin rejtigut të kredisë së vendit. Duke marrë parasysh rëndësinë e kredive me probleme për bankat individuale, por edhe për të gjithë sektorin bankar, madje edhe për ekonomitë e një vendi, shpesh janë një temë në

shumë analiza ekonomike. Shumica e këtyre analizave lidhen me faktorët që ndikojnë në kreditë me cilësi të dobët, dhe vetëm disa autorë e definojnë këtë term.

Caprio dhe Klingebiel përcaktojnë kreditë me probleme si kredi që për një periudhë relativisht më të gjatë nuk krijojnë të ardhura, ku principalit dhe / ose interesat për huatë e tilla nuk janë paguar për një numër të caktuar ditësh (Caprio & Klingebiel, 1996, f.23). Sipas mendimit të tyre, megjithëse nuk ka standarde të njohura ndërkombëtarisht, shpesh përdoren 90 ditë si pikë kthese.

Berge dhe Boye argumentojnë se kreditë me probleme përbëhen nga dy grupe, d.m.th kreditë me probleme dhe kreditë e pa vonuara, por që banka e konsideron të jenë pjesërisht të diskutueshme (të dyshimta). Autorët deklarojnë se nën kreditë me probleme ato janë kreditë në të cilat interesi dhe principalit nuk paguhet me maturim, dhe në kredi të tilla banka duhet të vlerësojë humbjen e mundshme (Berge & Boye, 2007, f. 65-66).

Rottke dhe Gentgen tregojnë problemin e mosekzistimit të një përkufizimi universal të kredive me probleme dhe konsiderojnë se ato mund të shihen në një kuptim më të ngushtë dhe më të gjerë. Vërejtur në kuptimin e ngushtë, kreditë me probleme janë kreditë që janë maturuar dhe nuk janë paguar për më shumë se 90 ditë, ndërsa, vërejtur në kuptimin e gjërë, kreditë me cilësi të dobët janë të gjitha kreditë me performancë më të keqe (Rottke & Gentgen, 2008, f. 63-64).

Guy shprehet se kreditë me probleme janë kryesisht kredi që kanë maturuar 90 ditë ose më shumë, por nuk janë shlyer (Guy, 2011). Bexley dhe Nenninger pajtohen gjithashtu me këtë metodë të përcaktimit, duke deklaruar se ato janë 90 ose më shumë ditë me vonesë në vonesat e interesit dhe / ose të principalit dhe se kredi të tilla konsiderohen si pasuri të këqija në regjistrimet bankare (Bexley & Nenninger, 2012, fq 46).

Saba, Kouser dhe Azeem konsiderojnë se kreditë me probleme janë ato në të cilat huamarrësi nuk e ka shlyer detyrimin e tij kontraktual për të paktën 90 ditë ose ata që dyshohen se do të bëhen të tillë. Autorët besojnë se shanset e një kredie me probleme që paguhet në tërësi janë

shumë më të ulëta se sa në rastin e kredive që nuk janë të klasifikuara në mënyrë të tillë (Saba, Kouser & Azeem, 2012, fq 143).

Barisitz është marrë me analizën e përkufizimit kombëtar të kredive joperformuese në vende të ndryshme. Studimi i parë i kryer në vitin 2011, me titull "Kreditë joperformuese në CESEE - Çfarë përbëjnë ata?" (titulli origjinal: *Nonperforming Lonas in CESEE – What Do They Comprise*), përfshirë një përkufizim kombëtar të dhjetë vendeve të Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore (Bullgaria, Kroacia, Republika Çeke, Hungaria, Polonia, Rumania, Rusia, Serbia, Sllovakia dhe Ukraina) (Barisitz, 2011, f. 46-68). Autori, në këtë studim, vuri në dukje se një krahasim i kredive me probleme shpesh mund të jetë i vështirë, sepse në identifikimin e kredive me probleme përdoren tri qasje. Së pari, ajo fillon nga përkufizimi i pranuar ndërkombëtarisht nga Fondi Monetar Ndërkombëtar, që nënkupton pajtueshmërinë me rregullat e vonesës së "90 dhe më shumë ditëve". Një tjetër qasje ka të bëjë me klasifikimin e kredive, sipas të cilit kreditë me probleme përfshijnë ato nënstandarde, të dyshimta dhe kredi të pariparueshme, e cila është në përputhje me përkufizimin e dhënë nga Instituti i Financave Ndërkombëtare. Qasja e tretë përfshin ekzistencën e "dobësive të një definimi të mirë " të kredisë ose disa faktorë të tjerë. Ky studim arriti në përfundimin se përcaktimi i kredive me probleme në vendet e këtij rajoni kanë një shkallë të lartë të ngjashmërisë dhe që janë të bazuara në kriteret e vonesës së "90 ditë më shumë".

Një tjetër studim që kryen Barisitz 2013 me titull "Kredi me probleme në Evropën Perëndimore - Krahasimi selektiv të vendeve dhe përkufizimet kombëtare" (titulli origjinal: *Nonperforming Lonas in Western Europe – A Selective Comparision of Countries and National Definitions*), përfshirë përkufizimin kombëtar kreditë me probleme në vendet e Evropës perëndimore (Austria, Finlanda, Franca, Gjermania, Irlanda, Italia, Portugalia, Spanja dhe Mbretëria e Bashkuar) (Barisitz, 2013, f. 28-47). Në thelb, kjo paraqet një vazhdim të një studimi të kryer më parë. Autori beson se kredia, e cila është klasifikuar si me probleme, duhet të ketë një nga dy elementet kryesore, domethënë se principali dhe / ose interesi është vonuar më shumë se 90 ditë (sipas FMN), ose se ka dobësi të definimit të mirë të kredive. Më tej, ai beson se ka edhe

elemente dytësore që ndikojnë në klasifikimin e kredive me probleme dhe që janë të rëndësishme për krahasimin e definicioneve, dhe këto elemente janë: nëse kreditë e ristrukturuar klasifikohet si jo-performuese apo jo, nëse garancitë dhe kolaterali ndikimon në klasifikimin e kredive apo jo, nëse kredia e tërë konsiderohet jokualitative ose vetëm pjesa e saj dhe nëse bankat i klasifikojnë të gjitha kreditë e të njëjtit huamarrës si jo-performuese apo jo. Përfundimi i këtij studimi është e ngjashme me përfundimin e mëparshëm, pra, në vendet e analizuara të Evropës Perëndimore në përgjithësi është respektuar vonesa rregulli "90 ditë më shumë", dhe elementet dytësore të kredive janë të ndryshme.

Studimi i tretë, i cili Barisitz kreu gjithashtu në vitin 2013, me titull "Kreditë joperformuese në CESEE - Krahasim edhe më i thellë i përkufizimeve " (titulli origjinal: *Nonperforming Loans in CESEE – An even Deeper Definitional Comparison*), bazohet në dy studime të mëparshme, dhe në këtë analizohen përkufizimet kombëtare të kredive me probleme në vendet e Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore (Bullgaria, Kroacia, Republika Çeke, Hungaria, Polonia, Rumania, Rusia, Serbia, Sllovakia dhe Ukraina) (Barisitz, 2013, f. 67-84). Autori i këtij studimi analizon primaren (vonesa e principalit dhe / ose pagesave të interesit të 90 ditë apo më shumë, apo ekzistenca e dobësive në definimin e mirë të kredive) dhe elemente sekondare (trajtimin e kredive të ristrukturuara, efektin e garancive dhe kolateralit, regjistrimin e totalit të kredisë ose vetëm një pjesë të saj si jokualitative dhe trajtimi i kredive të shumta nga i njëjti huamarrës) në përcaktimin e kredive me probleme. Edhe në këtë rast, analiza tregoi se këto vende respektojnë rregullin e vonesës "90 ditë dhe më shumë", por elementet dytësore të kredive joperformuese ndryshojnë në vendet e Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore.

Autorët të cilët merren me problemin e kredive me cilësi të dobët, nuk i definojnë ato në mënyrë të pavarur, por kryesisht mbështeten në përkufizimet e Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe të Komitetit të Bazelit për Mbikëqyrjen e Bankave. Gjithashtu, në praktikën bankare vendase, në klasifikimin e kredive, përdoret përkufizimi i dhënë nga Instituti për Financat Ndërkombëtare.

I. 2. Shqyrtim i literaturës empirike në lidhje me kredit me probleme

1.2.1. Karakteristikat kryesore të studimeve të kredive me probleme

Trendi i rritjes së kredive me probleme është një problem kyç me të cilin përballen bankat anembanë botës. Rritja e kredive me probleme është një pasojë e drejtpërdrejtë e rritjes së nivelit të rrezikut të kredisë për vendosjet individuale, të cilat sigurisht pasqyrojnë cilësinë e portofolit të kredisë të bankës dhe madje edhe të gjithë sektorin bankar dhe ekonominë e një vendi. Menaxhimi i rrezikut të kredisë nuk është aspak i lehtë, përkundrazi, është një proces shumë kompleks i kushtuar vëmendje, por menaxhimi adekuat i këtij lloji të rrezikut mund të zvogëlojë nivelin e kredive me probleme në banka. Për të gjitha vendet dhe sidomos për ata me pjesëmarrje të lartë të kredive me probleme në totalin e kredive, kuptimi i këtij problemi është i një rëndësie të madhe, kryesisht për shkak të përcaktimit të masave për reduktimin e kredive me probleme gjatë periudhës së ardhshme.

Në vitet e fundit, problemi i rritjes së kredive me probleme ka tërhequr vëmendjen e qarqeve akademike dhe për të qenë në gjendje ta zgjidhë atë, është e nevojshme të shqyrtohen faktorët që ndikojnë në rritjen e tyre dhe në përputhje me këtë të marrin masat adekuate për të zvogëluar kreditë me probleme në aktivet e bankës. Këta faktorë ishin subjekt i hulumtimit në shumë studime që merren me problemin e kredive me cilësi të dobët. Hulumtimet u bënë në mënyra të ndryshme dhe në nivele të ndryshme, por në të gjitha studimet tregohet marrëdhënia teorike midis sektorit financiar dhe ekonomisë reale, ose aktiviteteve ekonomike.

Literatura për kreditë me probleme është relativisht e gjerë dhe jep rezultate të vlefshme për faktorët që ndikojnë në rritjen e tyre, domethënë në faktorët që ndikojnë në përkeqësimin e cilësisë së aktiveve bankare. Disa studime janë kryer në nivel të një vendi dhe ndërsa të tjerat në nivel të disa vendeve. Disa prej tyre janë bërë në nivel të bankave individuale, ndërsa të tjerat janë bërë në nivelin total të sektorit bankar. Ka shumë faktorë që ndikojnë në kreditë me cilësi të

ulët dhe autorët zakonisht i ndajnë ato në dy grupe: faktorë të veçantë bankar dhe faktorë makroekonomikë. Tanasković dhe Jandrić shprehin se, përveç këtyre dy grupeve, "në punimin e fundit mund të shihen edhe përpjekje për të shpjeguar problemin e kredive problematike pjesërisht përmes veprimit të faktorëve institucionalë që përcaktojnë rregullat e sjelljes në sektorin bankar të një vendi të caktuar." (Tanasković & Jandrić 2017 faqe 77). Gjatë përcaktimit të variablave të përdorur në analizë, zakonisht niveli i kredive me probleme është definuar si variabël i varur dhe faktorët makroekonomikë dhe specifikë bankarë si variabël të pavarur.

Faktorët e veçantë bankar janë faktorë të brendshëm që shkaktohen nga funksionet e brendshme dhe aktivitetet e bankës dhe mund të kontrollohen nga menaxherët e saj. Në studimet e kryera, faktorët specifikë bankarë të analizuar më shpesh janë:

- koeficienti i mjaftueshmërisë së kapitalit
- raporti i kredive dhe depozitave
- kthimi i psurisë
- kthimi nga kapitali
- rritja e nivelit të kredisë
- norma e interesit aktiv
- raporti kredi/aktive
- marzhi i ndërmjetësimit.

Faktorët makroekonomikë janë faktorë të jashtëm në lidhje me zbatimin e vendimeve dhe politikave qeveritare dhe si të tilla nuk mund të kontrollohen nga menaxherët e bankës. Faktorët makroekonomikë më shpesh të analizuar janë:

- Rritja e nivelit të PBB-së,
- Borxhi publik si % e PBB-së,
- Norma e inflacionit,
- Norma e papunësisë,
- Norma e interesit të kredisë,

- Kursi i këmbimit.

Hulumtimet në lidhje me studimin e përcaktuesve të rrezikut të kredisë bankare kanë fituar rëndësi në vitet e fundit, veçanërisht pas krizës financiare të viteve 2007-2008 Khemraj dhe Pasha (2009). Por kur bëhet fjalë për mënyrën e modelimit në këtë fushë nuk ekziston asnjë rregull apo parim i pranuar në mënyrë universale që është një mjet themelor i të gjithë hulumtimit.

Në thelb, hulumtimi mbi këtë temë është i ndarë në dy aspekte: së pari, për sa i përket ndryshores së varur që përfaqëson rrezikun e kredisë, dhe së dyti, për sa i përket faktorëve që shpjegojnë lëvizjen e variablës së varur. Në lidhje me ndryshoren e varur, disa literaturë përqendrohen në kredi me probleme (Jimenez dhe Saurina, 2005; Ahmad dhe Ariff, 2007; Fainstein dhe Novikov, 2011; Festic in al. 2011; Pestova dhe Mamonov, 2012; Castro, 2012). autorë të tjerë përdorin provizione për humbjet në kreditë e papaguara (Arpa et al. 2001; Bikker dhe Hu, 2002; Pain, 2003; Pesola, 2005; Quagliarello, 2007; Glogoëski, 2008). Duhet të theksohet se është në rritje literatura që përdor normat e humbjes (default rates) si tregues i cilësisë së portofolit të kredisë (Virolainen, 2004; Trenka dhe Benyovszki, 2008), të cilat konfirmojnë gjithashtu varësinë nga faktorët makroekonomikë.

Për sa i përket aspektit të dytë, hulumtimi është i ndarë midis atyre që hetojnë vetëm përcaktuesit makroekonomikë (Aver, 2008; Ali dhe Daly, 2010; Kattai, 2010; Fainstein and Novikov 2011; Festic in al. 2011; Bofondi and Ropele 2011; Beck at al. 2013) dhe ata që hetojnë efektin e kombinuar të sipërpërmendur me përcaktuesit specifikë të bankës (Berger dhe DeYoung, 1997; Salas and Saurina, 2002; Rajan and Dhal 2003; Ahmad and Ariff, 2007; Quagliarello, 2007; Boudriga at al. 2009; Louzis et al.2010; Dash and Kabra, 2010; Zribi dhe Boujelbène, 2011; Castro, 2012; Otasevic, 2013; Klein, 2013).

Louzis et al (2010) ekzaminojnë ndikimin e përcaktuesve specifikë makroekonomikë dhe bankave në kreditë me probleme në sektorin bankar grek. Studimi i tyre përfshin analizën e nëntë bankave më të mëdha që përdorin të dhëna tremujore për periudhën 2003Q1 deri 2009Q3.

Autorët përdorin një analizë dinamike të panelit, si një teknikë ekonometrike, duke e aplikuar atë veçmas në kreditë joformuese të korporatave, kreditë konsumatore dhe kreditë hipotekare që shërbejnë si variabla të varura. Përcaktuesit e pavarur të përdorur në këtë punim janë ato standarde, përkatësisht: rritja e PBB-së, papunësia, normat e interesit në kredi (për secilin lloj në veçanti) kthimi i mjeteve ROA, kthimi i kapitalit ROE, pjesa e kapitalit neto në aktivet totale- aftësia paguese, raporti i depozitave dhe kredive, shpenzimet operative për sa i përket të ardhurave operative, madhësia e bankës. Gjetjet e tyre tregojnë se rritja e PBB-së ka një ndikim negativ në rritjen e të gjitha llojeve të kredive me probleme, ndërsa papunësia dhe norma bazë e interesit në kredi kanë një ndikim pozitiv. Nga përcaktuesit specifikë të bankës, raporti i kredive ndaj depozitave ka një ndikim statistikisht të rëndësishëm negativ në rritjen e kredive joformuese, ndërsa aftësia paguese ka një efekt pozitiv në rritjen e kredive joformuese ndaj ndërmarrjeve, ndërsa ndikimi i tij në kreditë hipotekare është negativ.

Bofondi dhe Ropele (2011) ekzaminonin se si përcaktuesit makroekonomikë ndikojnë në cilësinë e portofolit të kreditit të sistemit bankar italian gjatë periudhës 1990Q1-2010Q2, duke përdorur të dhëna të agreguara ndërsa aplikojnë një model të thjeshtë regresioni linear. Si një variabël e varur në modelin e tyre, ata përdorin kredi me probleme, të matura me raportin e kredive të reja me probleme dhe kredive të reja të aprovuara në periudhën e kaluar. Duke vepruar kështu, ata analizojnë kredi jofunksionuese në nivelin e ekonomive shtëpiake dhe të ndërmarrjeve. Rezultatet e studimit të tyre tregojnë se nivelet e rritjes së PBB-së reale dhe çmimet e shtëpive kanë një ndikim disproporcional në kreditë jofunksionuese të familjeve, ndërsa papunësia dhe normat nominale të interesit kanë një ndikim pozitiv. Për kompanitë, kreditë joformuese po rriten ndërsa shkalla e papunësisë dhe norma bazë e interesit rriten ndërsa ato ulen me rritjen e konsumit të mallrave të qëndrueshëm. Përcaktuesit e mësipërm makroekonomik ndikojnë në kreditë joformuese me vonesë të ndryshme kohore.

Otasevic (2013) shqyrton ndikimin e përcaktuesve bankarë makroekonomikë dhe specifikë në kreditë jofunksionuese duke përdorur një mostër prej 33 bankave në Republikën e Serbisë për periudhën 2008Q3 deri në 2012Q2. Modelimi ekonometrik kryhet duke përdorur dy panele

metoda ekonometrike: metodën e efekteve fikse dhe metodën e momentit të përgjithësuar. Autori analizon veçmas kreditë me probleme për familjet dhe ndërmarrjet. Variabli i varur nga puna është provizioni për humbje kredie, ndërsa variablat e pavarur makroekonomikë janë: PBB reale, inflacioni, referenca e normës së interesit BELIBOR dhe kursi i këmbimit, ndërsa variablat e levave specifike bankare merren parasysh, aftësia paguese (e matur si raporti i kapitalit neto ndaj aktiveve) dhe likuiditeti (llogaritur si përqindje, d.m.th., aktivet likuide ndaj totalit të aktiveve të bankës). Gjetjet e këtij punimi tregojnë se ato që nuk funksionojnë preken vetëm nga përcaktuesit makroekonomikë, ndërsa përcaktuesit specifikë të bankës janë statistikisht të parëndësishëm. Përkatesisht, rënia e rritjes së PBB-së dhe zhvlerësimi i dinarit ndikojnë në përqësimin e portofolit të kredisë së bankave në Serbi, si në kreditë e korporatave ashtu edhe për ato familjare. Për më tepër, rezultatet e analizës tregojnë se inflacioni ndikon në rritjen e kredive me probleme për familjet dhe ndërmarrjet, ndërsa norma e interesit të referencës prek vetëm kreditë me probleme për familjet.

1.2.2. Studime të kryera për vende të veçantë

Literatura për kreditë me probleme është shumë e gjerë dhe një rishikim kronologjik i hulumtimit që merret me këtë problem, i cili është kryer në vendet individuale, është dhënë më poshtë.

Në Maqedoni, kërkimet empirike për ekzaminimin e përcaktuesve të kredive me probleme janë ende të rralla dhe ato janë në një fazë rudimentare. Për dijen tonë, Ilijevska dhe tjerët (2012) si një ekip i NBRM kanë kryer hulumtime që prekin temën e përcaktuesve të kredive me probleme. Ata përdorin modelin e GMM duke analizuar periudhën nga 2003Q1 në 2011Q4 duke përdorur vetëm përcaktuesit makroekonomikë (rritja e PBB, norma bazë e interesit, kursi real i këmbimit, norma e inflacionit, eksportet, raporti kredi-PBB, norma e punësimit, rritja e pagës neto) ndikojnë në kreditë me probleme. Gjetjet e tyre tregojnë se inflacioni dhe kurset reale të këmbimit kanë ndikimin më pozitiv dhe statistikisht të rëndësishëm në kreditë me probleme. Gjithashtu, ndikim pozitiv në kreditë me probleme ka norma bazë të interesit dhe raporti i

kredive dhe PBB-së. Nga përcaktorët makroekonomikë të zgjedhur, rritja e PBB-së, rritja e pagës neto dhe eksportet kanë një ndikim negativ në rritjen e kredive me probleme.

Pastaj, Kosevski (2015) kryen një studim në lidhje me ndikimin e faktorëve makroekonomik dhe specifik bankar në kredit jofunksionale në Republikën e Maqedonisë ku janë përdorur të dhëna kuartale periudhe 2003Q4-2014Q4.) Punimin e tij me titull: Përcaktuesit specifikë bankarë dhe makroekonomikë të kredive jofunksionuese në Republikën e Maqedonisë: Analizë krahasuese e kredive të ndërmarrjeve dhe amvisërisë,(titulli original:Банкарски специфични и макроекономски детерминанти на нефункционалните кредити во Република Македонија:Компаративна анализа на кредитите на претпријатјата и домаќинствата) si variabël e varurë është marë kreditë jofunksionale në raportë me kreditë gjithsej dhe duke marrë parasysh faktin se qëllimi i këtij punimi ka qenë të analizohen kreditë jofunksionuese për ndërmarrjet dhe amvistrinë veç e veç, janë përdorur dy ndryshore të varura: kredi jofunksionuese të korporatave në raport me totalin e kredive të korporatave dhe kredive jofunksionuese për amvisëtrinë në raporte me totalin e kredive për amvistrinë.Në kuadër të faktorëve specifik bankar janë marë në shqyrtim këto faktorë:kthimi nga aktiva (POA),rritja e totalit të kredisë,likuiditeti dhe aftësia paguese. Kurse nga faktorët makroekonomik janë marë në shqyrtim këto faktorë: rritja reale e GDP, norma e papunësisë, inflacioni, kursi real i këmbimit. Analiza është kryer duke përdorur modelin Autoregressive Distributed Lag Modelling Approach (ARDL) modeli i integritimit duke përdorur seritë tremujore kohore për periudhën 2003Q4 deri 2014Q4.

Rezultatet tregojnë se nga përcaktuesit specifikë të bankës, përfitimi dhe rritja e kredisë së ndërmarrjeve dhe amvistrësë kanë një efekt negativ dhe statistikisht të rëndësishëm në kreditë jofunksionale në të dy specifikimet, ndërsa aftësia paguese ka një efekt pozitiv dhe statistikisht të rëndësishëm në kreditë jofunksionale të ndërmarrjet. Sa i përket përcaktuesve makroekonomikë në të dy specifikimet, rezultatet tregojnë se ekziston një marrëdhënie negative midis rritjes ekonomike dhe rritjes së kredive jofunksionuese. Kjo konfirmoi supozimet teorike se, në kohën e zgjerimit, besueshmëria e korporatave dhe amvisërive po rritet, gjë që ndikon pozitivisht në

servisimin në kohë të borxhit dhe rrjedhimisht nivelin më të ulët të rrezikut të kredisë për bankat. Rezultatet tregojnë se kursit real i këmbimit është një përcaktues statistikisht i rëndësishëm vetëm në modelin e parë, pra në kredi me probleme për ndërmarrjet. Nga përcaktuesit makroekonomikë, vetëm inflacioni nuk ishte statistikisht i rëndësishëm në planin afatgjatë, por ky përcaktues u konstatua se ishte statistikisht domethënës në planin afatshkurtër, vetëm në modelin e dytë, pra kur është përdorur kredi me probleme për amvistrisë si përcaktues i varur. Rezultati tregon se rritja e inflacionit mund të bëjë që servisi i borxhit për shkak të uljes së vlerës së vërtetë të kredive të aprovuara dhe kështu të çojë në një ulje të nivelit të kredive jofunksionuese në afat të shkurtër.

Keeton dhe Morris (1987) kanë kryer një studim me titull; Pse humbjet Kreditore të Bankave ndryshojnë? titulli origjinal: *Why Do Banks' Loan Losses Differ?*) ku janë analizuar mbi 2.470 banka në SHBA për periudhën 1979-1985, për të kuptuar arsyen e ndryshimit të nivelit të humbjeve të kredive nga njëra bankë tek tjetra. Sipas tyre disa banka kanë humbje të larta si pasojë e rastësisë, disa të tjera nga menaxhimi dobët i procesit të kreditimit dhe, disa të tjera, kanë pasur mundësinë e krijimit të portofoleve të mirëdiversifikuara, të cilët i kanë lejuar bankat të lehtësojnë standartet e kreditimit dhe të mbajnë një risk tërësor të ulët.

Një tjetër shpjegim i humbjeve të larta të kredive është ndodhja e bankave në zona me kushte të këqija ekonomike.

Por, edhe specializimi në një kategori të caktuar kredidhënie mund të rrisë probabilitetin e humbjes së kredisë. Kështu për shembull, kredia brenda kategorisë mund të ketë një probabilitet mesatar më të lartë dështimi sesa kreditë në kategori të tjera ose duke investuar shumë në një kategori banka zvogëlon shkallën e diversifikimit në tërësi të portofolit.

Ndryshimi i madh i nivelit të humbjeve të kredive midis tregjeve të ndryshme na sugjeron se bankat do të ishin më pak të cënueshme nga fatet e zonave apo industrive individuale nëse ato do të jepnin kredi në një zonë të gjërë gjeografike. Rezultatet e këtij studimi u sugjerojnë politikbërësve të promovojnë një diversifikim më të madh për të frenuar marrjen e një risku të tepruar.

Sinkey dhe Greenawalt zhvilluan një studim mbi kreditë me probleme në bankat komerciale në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me titull "[Eksperiencia huatë-humbjet dhe sjelljet e marjes së rrezikut në bankat e mëdha tregtare" titulli original: : *Loan – loss experience and risk – taking behavior at large commercial banks* (Sinay & Greenawalt , 1991, fq. 43-59). Analiza u krye në periudhën 1984 - 1987 dhe tregoi se faktorët e jashtëm (kushtet e këqija ekonomike) dhe faktorët e brendshëm (vendimet e këqija të kredisë) ndikojnë në kreditë me cilësi të dobët. Autorët konsiderojnë se kreditimi i tepërt dhe normat e larta të interesit janë faktorët kryesorë që ndikojnë në rritjen e kredive me probleme, ndërsa bankat me kapital të mjaftueshëm kanë norma më të ulëta të humbjes së kredisë.

Arpa, Giulini, Ittner dhe Paner zhvilluan një anketë në sektorin bankar të Austrisë, me titull "Ndikimi i lëvizjeve makroekonomike mbi bankat në Austri: implikimet për mbikëqyrësit bankar" (titulli i origjinalit: *The influence of macroeconomic developments on Austrian banks: implications for banking supervision*) Arpa, Giulini, Ittner, & Pauer, 2001, f. 91 - 116). Qëllimi i këtij studimi është vlerësimi i ndikimit të tendencave makroekonomike mbi rreziqet në bankat austriake gjatë një periudhe dhjetëvjeçare, përkatësisht në periudhën 1990-1999. Sipas rezultateve, provizioni për kreditë me rrezik, në raport me totalin e kredive të miratuara, ndryshon varësisht nga tendenca në normën e rritjes së PBB-së reale, normat e inflacionit, çmimet e pasurive të paluajtshme dhe normat reale të interesit.

Salas dhe Saurina, në një studim të titulluar "Rreziku i kredisë në dy regjime institucionale: bankat komerciale spanjolle dhe bankat e kursimit" (titulli i origjinalit: *Credit Risk in Two Institutional Regimes: Spanish Commercial and Savings Banks*), siç e thotë titulli, krahason faktorët e kredive me probleme në bankat komerciale spanjolle dhe bankat e kursimeve (Salas & Saurina, 2002). Autorët analizuan ndikimin e faktorëve makroekonomikë dhe specifikë bankar në kredi me cilësi të dobët, nga 1985 në 1997. Rezultatet e anketës tregojnë se norma reale e rritjes së PBB-së, fuqia e tregut, zgjerimi i shpejtë i kredisë, borxhi i huamarrësve, madhësia e bankave, struktura e portofolit të kredisë dhe faktorët e mjaftueshmërisë së kapitalit që ndikojnë në kreditë me cilësi të dobët në bankat komerciale dhe bankat e kursimeve në Spanjë.

Ranjan dhe Dhal, në një studim të titulluar "Kreditë jo-performuese dhe kushtet e kredisë për sektorin bankar publik në Indi: vlerësim empirik (titulli origjinal: *Non-Performing Loans and Terms of Credit of Public Sector Banks in India: An Empirical Assessment*) analizuan faktorët e kredive me probleme në sektorin bankar të Indisë, në periudhën 1993-2003 (Ranjan & Dhal, 2003, f. 81 - 121). Ata zbulojnë se huatë me cilësi të ulët preken nga faktorët makroekonomikë dhe financiarë, d.m.th., rritja e normave të interesit, dhe pjekuria dhe kushtet e favorshme makroekonomike dhe të biznesit (siç matet nga rritja e PBB-së) ndikojnë në rënien e kredive me cilësi të dobët në sektorin bankar të Indisë.

Jimenez dhe Saurina analizuan kredi të dobëta në sektorin bankar të Spanjës në periudhën 1984-2002 (Jimenez & Co.), në një studim të titulluar "Cikli i kredisë, rreziku i kredisë dhe rregullimi i kujdesshëm" (titulli i origjinalit: *Credit Cycles, Credit Risk, and Prudential Regulation*) Saurina, 2006, f. 65-98). Rezultatet tregojnë se ekziston një lidhje e fortë midis rritjes së kredisë dhe kredive me probleme, d.m.th. rritja e kredisë ka një ndikim të rëndësishëm statistikor në kreditë me cilësi të ulët. Ata theksojnë se standardet më të ulëta të kreditit janë pasojë e rritjes së shpejtë të kredisë që çon në një rritje të nivelit të kredive me probleme në të ardhmen dhe se rritja e PBB-së dhe rënia e normave reale të interesit çojnë në një rënie të nivelit të kredive me probleme në sektorin bankar në Spanjë.

Khemraj dhe Pasha (2005) në studimin e tij "Përcaktuesit e kredive me probleme: një studim empirik në Guajana" (titulli origjinal: *The determinants of non-performing loans: an econometric case study of Guyana*) analizoi faktorët që ndikojnë në kredi me probleme në gjashtë bankat komerciale në Guajana, dhe të dhënat e përdorura i referohen periudhës 1994 - 2004 (Khemaj & Pasha, 2005). Hulumtimi i përfshirë faktorët makroekonomik (norma e rritjes së PBB-së, norma e inflacionit dhe kursit real efektiv i këmbimit) dhe faktorëve të veçantë bankare (normës efektive të interesit, madhësinë e bankave, rritja e kredisë dhe marrëdhënien e kredive në totalin e aktiveve).

Me anën e një modeli regresioni autorët marrin si variabël të varur kreditë me probleme, dhe si variabël të pavaruar faktorët makroekonomikë dhe bankarë si vijon: rritja vjetore e PBB, norma reale e interesit, norma e inflacionit, kursi real efektiv i këmbimit, raporti midis kredisë dhe aktiveve gjithsej, pjesa në treg e bankës i , përqindja e shtimit të kredisë së bankës i .

Rezultatet e studimit të tyre tregojnë se lidhja midis raportit kredi / aktive dhe kredive me probleme është e drejtë duke pohuar që bankat me “oreks” të lartë për të mbartur risk hasin në nivele më të larta të kredive me probleme. Norma reale e interesit ka lidhje të drejtë me kreditë me probleme, por lidhja është e dobët. Rritja e nivelit të kredisë ka lidhje të fortë të zhdrejtë me kreditë me probleme dhe është e rëndësishme në kohën t , në $t-1$ dhe $t-2$. Kursi real efektiv i këmbimit ka lidhje të fortë të drejtë me kreditë me probleme duke sugjeruar se konkurrenca ndërkombëtare e ekonomisë vendase është përcaktues i rëndësishëm i riskut të kredisë. Lidhja midis rritjes së PBB dhe kredive me probleme është e zhdrejtë ndërsa ka një lidhje të paqartë midis inflacionit dhe kredive me probleme pasi koeficientët janë negativë në kohën t dhe pozitivë në kohën $t-1$. Lidhja midis madhësisë së bankës dhe kredive me probleme nuk është e rëndësishme duke treguar se bankat e mëdha nuk janë domosdoshmërisht më eficiente në shqyrtimin e kredimarrësve në krahasim me bankat më të vogla.

Louzis, Vouldis dhe Metaxas kanë kryer një hulumtim mbi kreditë me probleme në Greqi, dhe rezultatet janë paraqitur në studimin "Përcaktuesit makroekonomikë dhe të veçantë bankarë të kredive joperformuese në Greqi: Një studim krahasues i portofolit të kredisë hipotekare, komerciale dhe kredisë konsumatore" (titulli origjinal: *Macroeconomic and Bank-Specific Determinants of Non-Performing Loans in Greece: A Comparative Study of Mortgage, Business and Consumer Loan Portfolios*) (Louzis, Vouldis, dhe Metaxas, 2010). Studimi është i bazuar në hipotezën se të dy grupet e faktorëve, përkatësisht faktorët makroekonomikë dhe bankarë të veçanta kanë një ndikim mbi cilësinë e kredive, dhe se ky ndikim ndryshon në varësi të llojit të kredisë. Anketa përfshiu nëntë bankat më të mëdha greke, të cilat përbëjnë rreth 90% të sektorit bankar grek, në periudhën nga viti 2003 deri në vitin 2009. Autorët në mënyrë specifike kanë analizuar faktorët makroekonomikë dhe bankarë specifikë që ndikojnë në tre grupe të kredive

(hipotekare, komerciale dhe të konsumit), dhe pastaj ata i kanë krahasuar reciprokisht. Rezultatet tregojnë se faktorët makroekonomikë, veçanërisht shkalla e rritjes së PBB-së, papunësisë dhe normat e interesit, kanë një ndikim të fuqishëm në kreditë jokualitative të të gjitha kategorive. Megjithatë, rezultatet treguan se këta faktorë makroekonomikë kanë ndikim më të vogël në kreditë hipotekare. Për më tepër, autorët vërtetuan se, përveç faktorëve makroekonomike, kreditë me cilësi të dobët ndikohen edhe nga faktorë specifikë bankarë, d.m.th., niveli i kredive me cilësi të dobët varet nga cilësia e menaxhimit në bankë.

Baza e të dhënave historike të Moody's gjithashtu përfshin të dhëna nga kompani që falimentuan ndër vite, dhe është treguar shumë e dobishme. Në thelb, përdorimi i një baze të të dhënave të tillë konsiderohet një avantazh kryesor i modelit. Nga ana tjetër, mundësia e mospagimit, dhe kështu vlerësimi i rrezikut të kredisë, bazohet në vlerën e kapitalit neto dhe detyrimeve të ndërmarrjes, si tregues individualë të pozicionit aktual financiar të secilës firmë, gjë që nuk lejon konsideratë të përgjithshme dhe krahasuese. karakteristikat e kompanive të shumta në një kategori. Sidoqoftë, modeli monitoron në mënyrë aktive vlerën e tregut të kompanive dhe përfshin ndryshime në vlerën e kapitalit neto në secilën matje, kështu që mund të përdoret gjithashtu si një mjet efektiv për monitorimin e portofolit të kredisë.

Në çdo rast, duhet të meret parasysh se baza e të dhënave e përdorur nga modeli përfshin kompanitë kryesisht nga tregu amerikan, që do të thotë se është shumë e kufizuar. Sidoqoftë, në përgjithësi, modeli është praktik, dhe popullariteti i tij mund të shihet në statistikën që edhe pse bazohet në një bazë të dhënash të tregut amerikan, pothuajse gjysma e përdoruesve të tij janë jashtë SH.B.A. I motivuar nga suksesi i këtij modeli, sot Moody's po punon për të zgjeruar bazën e të dhënave të saj ndërkombëtarisht.

3.3.10 Krahasimi midis metodave tradicionale dhe të reja të matjes dhe vlerësimit të riskut të kredisë.

Në këtë studim kryhet një analizë e metodave të matjes dhe të vlerësimit të riskut të kredisë sipas modeleve tradicionale dhe modeleve të reja. Nëse krahasojmë këto lloje modelesh secili prej tyre ka avantazhet dhe disavantazhet e veta.

Avantazhet kryesore që paraqesin modelet tradicionale i paraqesim si më poshtë:

- Analiza themelore e riskut të kredisë është e thjeshtë për tu kuptuar dhe implementuar nga analistët e kredisë. Analistit këtu i kërkohet vetëm të ketë njohuri të nevojshme për analizën e situatës financiare të shoqërisë nëpërmjet shqyrtimit të pasqyrave: të bilancit, të ardhurave dhe shpenzimeve, flukseve financiare si dhe situatës të përgjithshme makroekonomike.
- Në sistemet e vendimmarrjes me ekspertë vendimi për dhënien e kredisë i besohet oficerit të kredisë apo menaxherit të degës së bankës. Ky model paraqitet i thjeshtë për tu aplikuar pasi për dhënien apo jo të kredisë analizohen vetëm këta pesë faktorë kyç: karakteri, kapitali, kapaciteti, kolaterali dhe kushtet e ciklit ekonomik;
- Rrjetet neurale janë sisteme vendimmarrjeje kompjuterike të cilat karakterizohen nga tre elementë: inputet, peshat e inputeve dhe njësitë e fshehura. Këto sisteme janë shumë efikente pasi ato shmangin problemet e subjektivitetit në vendimmarrje;
- Sistemet e brendshme të vlerësimit ndajnë kreditë në 10 kategori të emërtuara me shkronja nga AAA deri tek D. Sipas klasifikimit nivelin e riskut minimal e shënojmë me AAA ndërsa në kategorinë D kemi të bëjmë me riskun maksimal. Ky sistem paraqitet i thjeshtë për tu kuptuar si dhe efikent në lidhje me klasifikimin e kredisë duke qenë se sot agjencitë më të rëndësishme financiare ndërkombëtare janë duke aplikuar këtë lloj sistemi;
- Sistemet e pikëzimit të kredisë përdoren në vendimmarrje duke analizuar disa faktorë kyç që përcaktojnë probabilitetin e dështimit dhe në kombinimin e këtyre faktorëve në

mënyrë të tillë që të japin një pikëzim sasior. Janë të thjeshtë për tu aplikuar pasi vendimi për kredidhënien lidhet vetëm me interpretimin e vlerës së funksionit final.

Disvantazhet kryesore që paraqesin modelet tradicionale i paraqesim si më poshtë:

- Marrja e vendimeve në këto modele kryhet zakonisht duke marrë parasysh të dhëna historike si për shembull: pasqyrat financiare, raportet e ndryshme financiare të cilat ndikohen nga politikat kontabël që ndjekin shoqëritë e ndryshme;
- Numri i faktorëve që merret si bazë për vendimmarrje është i kufizuar kryesisht në nivel mikroekonomik dhe nuk integrohet me faktorë të tjerë makroekonomikë si për shembull kushtet e përgjithshme ekonomike të vendit ku po shqyrtohet kredia;
- Subjektiviteti në përcaktimin e peshave të zbatuara për faktorë të ndryshëm e bën të vështirë monitorimin e vendimmarrjes edhe pse në shumë raste prania e komiteteve të kredisë përpiqet të shmangë këto lloj problemesh.

Avantazhet kryesore që paraqesin modelet e rinj i paraqesim si më poshtë:

- Metrika e kredisë është një metodë për vlerësimin e riskut të portofolit të kredisë si pasojë e ndryshimit të vlerës së borxhit për shkak të ndryshimeve në cilësinë e kredisë së huamarrësit. Kjo metodë ka risi sepse përfshin jo vetëm ngjarjen ekstreme të dështimit të shoqërisë por edhe përmirësimin ose përkeqësimin e cilësisë së kredisë. Risku këtu vlerësohet brenda kontekstit të portofolit bashkë me korrelacionet e ndryshimeve të cilësisë së kredisë midis huamarrësve të ndryshëm. Sipas kësaj logjike llogarisim efektet e diversifikimit dhe mbipërqëndrimit në nivel portofoli.
- Modeli Kamakura vlerëson probabilitetin e dështimit për afate kohore të cilat shkojnë nga 1 muaj deri në 5 vjet. E veçanta e këtij modeli qëndron në faktin se ai përfshin jo vetëm të dhëna të posaçme për shoqëritë, por edhe të dhëna për industrinë ku vepron shoqëria, për mjedisin ekonomik si dhe për faktorët kyç makroekonomikë.
- Modeli KMV i Moody's përdor teorinë e vlerësimit të opsioneve për vlerësimin e kredive. Duke qenë se funksioni i fitimit në procesin e huadhënies së një banke është i njëjtë me nënshkrimin e një opsioni për shitje mbi aktivet e shoqërisë huamarrëse, për vlerësimin e kredisë do të përdoren të njëjtët parametra si për vlerësimin e një opsioni për

shitje sipas modelit Black & Scholes. Risia modelit qëndron që ne mund të llogarisim një frekuencë të pritshme dështimi për çdo kredimarrës.

Disavantazhet kryesore që paraqesin modelet e rinj i japim si më poshtë:

- Nivel kompleksiteti të lartë, analistët që do ti përdorin këto modele duhet të jenë shumë të trajnuar pasi keqpërdorimi i tyre mund të jepte efekte negative dhe mund të shkaktonte humbje të larta për institucionin financiar;
- Vështirësi në përcaktimin e peshave që do ti caktohet secilit prej faktorëve, të cilët përdoren për vlerësimin e riskut të kredisë;

Në lidhje me krahasimin midis modeleve të reja dhe tradicionale mund të themi se këto të fundit janë më të thjeshta për tu aplikuar ndërsa ato të rejat janë më ndërlikuara, por në të njëjtën kohë edhe më të sakta në rezultatet e tyre.

Në sistemin bankar mund të themi se bankat e nivelit të dytë aplikojnë modele të ndryshme për vlerësimin e riskut të kredisë.

Megjithatë bankat në varësi të llojit të klientit përdorin modelet e vlerësimit të riskut të kredisë kështu:

- Për bizneset bankat përdorin kryesisht modelet themelore të vlerësimit të riskut të kredisë;
- Për individët bankat përdorin kryesisht modelet e pikëzimit të vlerësimit të riskut të kredisë.

Përdorimi i modeleve të reja të vlerësimit të riskut të kredisë në bankat e vendit tonë akoma nuk është bërë i mundur kryesisht për mungesën e një baze të gjërë të dhënash që janë të nevojshme për ndërtimin e këtyre modeleve si dhe kompleksiteti që paraqesin ato.

Gjithashtu nëse kërkojmë të gjejmë një lidhje midis llojit të modelit të përdorur për vlerësimin e riskut të kredisë dhe nivelit të kredive me probleme në sistemin bankar kjo do të ishte praktikisht e pamundur pasi bankat nuk i bëjnë publike modelet e tyre sepse i konsiderojnë ato konfidenciale. Megjithatë mund të themi se bankat herë pas here kryejnë rishikime të ndryshme në lidhje me modelet e vlerësimit të riskut të kredisë duke i përshtatur ato sipas kushteve të ndryshme specifike të bizneseve si dhe kushteve makroekonomike të përgjithshme.

KAPITULLI IV

ANALIZË E KREDITIMIT TË SISTEMIT BANKAR TË VENDEVE TË BALLKANIT PERËNDIMOR

IV. 1. Vështrim shkurtë i sistemit bankar të vendeve të Ballkanit Perëndimor

Sistemi bankar në vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor ka kaluar në disa faza përgjatë rrugës së zhvillimit të tij, të cilat lidhen ngushtë me zhvillimet politike dhe sistemin e qeverisjes në këto vende.

Në mjedisin e ekonomisë së planifikuar, sektorët financiarë nuk kishin ndonjë rol të rëndësishëm në shpërndarjen e burimeve. Si rrjedhojë, përpara viteve 1990 nuk kishte nevojë për mbikëqyrje dhe rregullim bankar ose për një kuadër të duhur ligjor lidhur me këto çështje (Mehl, Vespro, & Winkler, 2006).

Transformimi i industrisë bankare në vendet në tranzicion ka qenë një ndër proceset më dramatike dhe më me ndikim në procesin e tranzicionit në tërësi (Kraft, 2005). Pavarësisht përpjekjeve të shumta për hartimin dhe zbatimin e reformave në këtë sektor, në përgjithësi rezultoi një dështim i reformave të dëshiruara. Faktorët kryesorë që ndikuan në këtë dështim sipas (Mehl, et al., 2006) ishin:

a) Mjedisi i dobët institucional dhe ligjor – Mospërputhja e legjislacionit të vjetër me legjislacionin e ri të miratuar, solli zvogëlimin e efektivitetit të zbatimit të këtij të fundit, sidomos në fushën e likuidimit, falimentimit dhe kolateralit. Sipas (Bonin, Hasan, & Wachtel, 2008) ristrukturimi dhe privatizimi në sektorin financiar varet nga krijimi i një kuadri rregullator ligjor dhe institucional, si dhe ligjet për falimentimin dhe standartet kontabël të përshtatshme.

b) Mbikëqyrje bankare jo e përshtatshme - Duke qenë se rregullimi dhe mbikëqyrja bankare duhet të krijohet duke nisur nga niveli zero, pjesa më e madhe e departamenteve të mbikëqyrjes nuk ishin në gjendje që të përcaktonin dhe të zbatonin standardet ndërkombëtare që garantonin një sistem të shëndoshë financiar, në veçanti në lidhje me provizionimin e humbjeve nga huatë, kufijtë ndaj ekspozimit dhe huave të lidhura. Përsa i takon burimeve njerëzore, stafi ishte i kufizuar në numër, shpesh pa eksperiencën e duhur ose të patrajnuar, dhe nuk ishin në gjendje që të përballeshin me rritjen e numrit të bankave. Duke qenë se lojtarët kryesorë ishin bankat e zotëruara nga shteti, qeveritë ngurrnin që mbikëqyrësit të vepronin me vendosmëri për të likuiduar bankat me probleme, gjë që dobësoi akoma më shumë mbikëqyrjen bankare.

Duke paturë parasyshë së sistemi bankar është sektori më i rëndësishëm i sistemit financiar në vendet e Ballkanit Perëndimor, sistemi bankar në rajonin e Ballkanit Perëndimor është i organizuar në dy nivele: Banka Qëndrore dhe Bankat Tregtare.

Vendet e Ballkanit, konsiderohen “bank based system” (sistem bazuar në banka), ku bankat luajnë një rol të rëndësishëm në tregun financiar dhe të cilat zënë pjesën më të madhe të vëllimit të veprimtarisë së tregut financiar. Liçencimi, funksionimi, mbikëqyrja e bankave të nivelit të dytë është e rregulluar me ligj të veçantë, i cili në thelb është i ndërtuar mbi parime të ngjashme, por sigurisht që ka edhe dallime, për shkak të specifikave që kanë vendet që kemi marrë në studim.

Diferencat në zhvillimin e tregut bankar, në vendet e rajonit janë rrjedhojë jo vetëm e zhvillimeve ekonomike, por edhe zhvillimeve politike. Aktualisht në secilin prej shteteve që janë në fokus të këtij studimi operojnë një numër relativisht i madh bankash të nivelit të dytë duke konsideruar dhe popullatat përkatëse të vendeve. Aktualisht për vitin 2018, operojnë 16 banka në Shqipëri, në Maqedoni 15 banka. Në Serbi operojnë një maksimum prej 26 bankash dhe në

Malin e Zi vetëm 13 banka duke reflektuar edhe një popullatë dhe sipërfaqe më të vogël, në Bosnje dhe Hercegovinë 24 banka.

4.1.1. Sistemi bankar në Republikën e Maqedonisë

Banka Popullore e Maqedonisë u themelua më 17 nëntor të vitit 1991, dhe më 26 prill të vitit 1992 ajo aprovoi aktin e pavarësisë monetare. Kjo ishte periudha e shkëputjes së Maqedonisë nga ish federata jugosllave dhe formimi i sistemit të pavarur monetar.

Sistemi bankar në Republikën e Maqedonisë përbëhet nga 15 banka në vitin 2018 dhe 2 Shoqëri Kursim Krediti.

Në sistemin bankar të Republikës së Maqedonisë së Veriut, bankat zotërohen kryesisht nga aksionarët e huaj, në të gjitha pozicionet e rëndësishme të bilancit.

Dominimi i tyre ishte më i theksuar në aktivitetin kreditor (80.0%) dhe rezultatin financiar (76.5%). Në vitin 2018, pjesa e aksionarëve të huaj në kapitalin e përgjithshëm dhe rezervat u ul me 3.9 pikë përqindje, kryesisht për shkak të ndryshimeve në strukturën e pronësisë së një banke, ku aksionarët e huaj (kryesisht fondet e investimeve) shitën aksione disave korporatave vendase jo-financiare. Prandaj, pjesa e institucioneve financiare në strukturën e pronësisë së sistemit bankar u ul me 4 pikë përqindje, që është afërsisht e barabartë me rritjen e pjesës së kompanive jo-financiare. Sipas vendit të origjinës së aksionarëve të huaj, pjesën më të madhe e mbajnë aksionarët nga Greqia dhe Sllovenia, pjesa e të cilëve në kapitalin e përgjithshëm dhe rezervat është 19.5% dhe 14.8%.

Aktivet e sektorit bankar, në fund të vitit 2018 ishin 503.469 milion denarë. Në aktivet, pjesa e kredive për sektorin jofinanciar është më e larta (59.6%). Në kushte të rritjes gjithnjë e më të shpejtë të kredive për familje, krahasuar me kreditë e korporatës jofinanciare, për herë të parë këtë vit, pjesa e kredive për familje (29.6%) tejkaloi pjesën e kredive të korporatës jo-financiare (29.2%) në gjithsej aktivet.

4.1.2. Sistemi bankar në Shqipëri

Sistemi bankar në Shqipëri është karakterizuar nga ndryshime të vazhdueshme gjatë dy dekadave të fundit. Sfidat e para nisin pas viteve '90 me ndryshimin e sistemin bankar në një sistem bankar me dy nivele, ku Banka Qendrore do të luajë rolin e mbikqyrësit në sistemin e ri. Kalimi në sistemin bankar me dy nivele në vitin 1992 e gjen Shqipërinë me gjashtë banka të nivelit të dytë, katër prej të cilave janë me pronësi shtetërore dhe dy të tjerat me pronësi të përzier. Zhvillimet e reja janë karakterizuar nga ristrukturimi dhe privatizimi i disa bankave shtetërore. Ky proces përfundoi në vitin 2003, me privatizimin e Bankës së Kursimeve, që zinte një pjesë të konsiderueshme në sistemin bankar të asaj periudhe.

Faza e dytë e zhvillimit të sistemit bankar vijon me ndryshime në numrin e bankave dhe me krijimin e një mjedisi me konkures. Kështu, numri i bankave u rrit, si edhe u zgjerua gjeografikisht në të gjithë territorin. Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve bankare, si edhe eksperiencia e menaxhimit të bankave që kryesisht ishin me kapital të huaj, ndikoi në rritjen e treguesve financiarë për to.

Megjithatë, ecuria e tregut ka pasur luhatje të vazhdueshme. Ndikimi i faktorëve të ardhur nga ndryshimet në tregjet globale, ka reflektuar paqëndrueshmëri në tregun bankar shqipëtar. Përfshirja e Bankës Qendrore për të ruajtur qëndrueshmërinë financiare, është një aspekt i rëndësishëm në zhvillimin e sektorit bankar në Shqipëri.

Sektori bankar, i cili mbulon mbi 90% të aktiveve të sistemit financiar, e përmbylli vitin 2018 me një rezultat financiar pozitiv, në nivele të mira kapitalizimi dhe likuiditet të tepërt, duke shënuar nivele më të larta krahasuar me kërkesat e parashtruara në rregulloren përkatëse, dhe një cilësi më të mirë të kredisë krahasuar me një vit më parë. (Burimi: Banka e Shqipërisë: Raporti vjetor 2018, faqe 59)

Struktura e sistemit bankar dhe financiar, në fund të vitit 2018, përbëhet nga 14 banka, 30 subjekte financiare jobanka, 463 zyra të këmbimit valutor, 13 shoqëri të kursim-kreditit dhe 1

union të shoqërive të kursim-kreditit. Banka e Shqipërisë, bazuar në ligjin për bankat në Republikën e Shqipërisë, ka autoritetin të licencojë dhe mbikëqyrë bankat, subjektet financiare jobanka, shoqëritë e kursim-kreditit e unionet e tyre, zyrat e këmbimit valutor dhe zyrat e përfaqësimit të bankave të huaja.

Aktivitet e sektorit bankar, në fund të vitit 2018 ishin 1.453 miliarde lekë, duke pësuar në këtë mënyrë një rritje vjetore 0.5% nga 4.1% në vitin paraardhës. Zgjerimi i portofolit të investimeve ndërbankare dhe tkurrja e fondeve rezervë për mbulimin e humbjeve nga aktiviteti në vijim të procesit të largimit të kredive të humbura nga bilancet e bankave, kanë dhënë kontributin kryesor në zgjerimin e aktiveve të sektorit. Peshën më të madhe në aktivet e zënë depozitat me 81%.

4.1.3. Sistemi bankar në Mal të Zi

Lëvizja e parë në drejtim të pavarësisë monetare ka filluar që në fund të viteve '90 me emetimin e markës gjermane në Nëntor të vitit 1999. Ajo kishte për qëllim të zvogëlonte ndikimin politik të Serbisë. Midis Janar 2002 dhe Mars 2002, marka gjermane u zëvendësua me euron, dhe sot ajo përfaqëson një instrument të pagesës. Me themelimin e Bankës Qendrore të Malit të Zi (BQM), e cila filloi të operojë më 15 Mars 2001, mund të thuhet se reformat bankare në Malin e Zi kanë filluar në vitin 2001 me riorganizimin e Montenegrobanka, e cila ishte një bankë lider në atë kohë.

Sistemi bankar në Mal të Zi është përballur me shumë sfida gjatë dhjetëvjeçarëve të fundit, por në ditët e sotme ai karakterizohet nga: siguria, stabiliteti dhe besueshmëria.

Aktualisht, në Malin e Zi funksionojnë 13 banka dhe shumica e tyre janë bija të bankave mëmë që veprojnë në shtetet anëtare të BE-së. Të gjitha bankat janë anëtare të Shoqatës së Bankave të Malit të Zi. Në nivel sistemi, sektori bankar në Mal të Zi regjistroi prirje pozitive, ku të gjithë treguesit kyç të bilancit shënuan rritje, si: totali i aktiveve u rrit me 5.52% në fund të tremujorit të tretë të 2018-ës, krahasuar me fundin e vitit të kaluar, ndërsa portofoli i huave gjithsej u rrit me 10.70%, totali i depozitave u rrit me 5.88% dhe totali i kapitalit u rrit me 0.83 %. Raporti i

aftësisë totale paguese, si një tregues relativ i mjaftueshmërisë së kapitalit të bankave, ishte 17.15%, në fund të tremujorit të dytë të vitit 2018, duke qenë shumë më lart se minimumi ligjor prej 10%. Përveç kësaj, aktivet likuide tejkaluan nivelin prej 1,037.9 milionë euro në fund të shtatorit 2018, duke zënë mbi 23.52% të totalit të aktiveve të bankave, ose gati një e katërta e totalit të aktiveve bankare.

4.1.4. Sistemi bankar në Bosnje dhe Hercegovinë

Spektori bankar i BH përbëhet nga sektori bankar i Republikës Srpska dhe sektori bankar i Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës. Në nivelin shtetëror, sektori bankar rregullohet me Ligjin për Bankën Qendrore të BH (Ligji për Bankën Qendrore të Bosnjës dhe Hercegovinës, 1997) dhe Ligji për Sigurimin e Depozitave (Ligji për Sigurimin e Depozitave, 2002). Sektori bankar i RS mbikëqyret nga Agjensia Bankare e Republikës Srpska dhe sektori bankar i FBH mbikëqyret nga Agjensia Bankare e Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës. Është e rëndësishme të përmendet fakti që rregulloret e entiteteve në lidhje me operacionet bankare janë të harmonizuara dhe mbikëqyrja kryhet me të njëjtat standarde. Sistemet bankare funksionojnë si transaksione pagese brendabankare dhe ndërbankare dhe luajnë një rol të rëndësishëm në parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Bankat tregtare nga të dy sektorët operojnë pa kufizime në të gjithë BH dhe përmirësojnë dhe modernizojnë vazhdimisht operacionet e tyre në mënyrë që të adaptojnë produktet dhe shërbimet me nevojat e klientëve.

Banka Qendrore e Bosnjës dhe Hercegovinës (CBBH), e cila u krijua në mesin e 1997, filloi operimet në 11 gusht 1997. Që atëherë, ajo ka luajtur një rol kryesor në sistemin bankar të BH. CBBH është krijuesi i sistemit monetar dhe është përgjegjës për zbatimin efektiv të politikës monetare në vend. Detyra e saj kryesore është të ruajë stabilitetin monetar në përputhje me marrëveshjen e bordit valutor. Duke parë biznesin CBBH, mund të konkludohet se ka arritur rezultate të rëndësishme. Kozarić beson se CBBH ka përmbushur plotësisht një nga funksionet e saj themelore sepse arriti dhe ruajti stabilitetin e brendshëm të monedhës vendase, ndërsa

stabiliteti i jashtëm u sigurua duke mbajtur me sukses një kurs të këmbimit fiks dhe shërbim të rregullt të borxhit të jashtëm të BH të cilin CBBH e ka kryer si agjent fiskal "(Kozarić, 2007, f.13).

Sektori bankar i BeH është zhvilluar me shpejtësi gjatë pesë viteve të ardhshme, numri i bankave është zvogëluar si rezultat i konsolidimit, dhe asetet totale janë rritur. Raporti vjetor për vitin 2005 thotë se sektori bankar përbën 81% të totalit të aktiveve të sektorit financiar dhe "udhëheq rrugën në modernizimin e sektorit, menaxhimin e përparuar, mbulimin e territorit dhe futjen e produkteve të reja" (CBBH, 2006, f. 66). Në fund të vitit 2015, gjithsej 26 banka tregtare vepruan në sektorin bankar të BH.

Tabela 7. Numri i bankave tregëtare në Bosnje dhe Hercegovinë (2006-2018)

Tabela 10: Broj komercijalnih banaka u BeH (2006 – 2015)

ENTITETI	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Republika Srpska	9	10	10	10	10	10	10	10	9	9	8	8	8
Federacion BH	23	22	20	20	19	19	18	17	17	17	15	15	15
Totali BH	32	32	30	30	29	29	28	27	26	26	23	23	23

Burimi: (Agencija za bankarstvo RS), (Agencija za bankarstvo FBiH)

Një analizë e strukturës së sektorit bankar të BH gjatë një periudhe trembedhjet vjeçare ka treguar një rënie të numrit të bankave tregtare. Në fillim të periudhës së analizuar, në vitin 2010, operuan 32 banka tregtare (9 banka në RS dhe 23 banka në FBH), dhe në vitin 2018, funksionuan gjithsej 23 (8 banka në RS dhe 15 banka në FBH). Gjatë periudhës së analizuar, disa banka u bashkuan kurse disa u larguan dhe banka të reja hynë në tregun e BH.

4.1.5. Sistemi bankar në Sërbë

Ristrukturimi i sektorit bankar filloi më vonë krahasuar me vendet e tjera të Ish Republikës Federale të Jugosllavisë. Arsyja kryesore ishte problematika me Malin e Zi, i cili nuk mund të mos ndikohej nga çështjet e shkëputjes territoriale. Në fillim të viteve 2002, autoritet vendosën që të likujdonin katër bankat më të mëdha (Jugobanka, Beobanka, Beogradska banka dhe Investbanka) kryesisht për shkak se humbjet ishin shumë më të mëdha sesa ato të parashikuarat, nuk kishte asnjë opinion pozitiv për të ardhmen, kishte një pakësim të theksuar në depozita, dhe njerëzit nuk kishin besim në bankat dhe veprimtaritë e tyre. Kjo ishte një lëvizje e rëndësishme që duhej bërë dhe këto katër bankat më të mëdha përfaqësonin 57% të totalit të aktiveve totale në sistemin bankar të vendit, me kosto të likuidimit rreth 1% të PBB-së ose rreth 90 milionë dollarë (Mehl, et al., 2006).

Aktualisht sektori bankar në Serbi përbëhet nga 27 banka tregtare nga 88 që ekzistonin në fillim të viteve 2000. Rreth 21 prej tyre janë me pronësi të huaj (ose shumicë të huaj). Në vitin 2013, Serbia ndryshoi Ligjin për Eksportin e Kredive dhe Agjencisë së Sigurimeve, duke e shndërruar këtë në një agjenci financiare biznesi, e cila do të ketë role të reja, duke përfshirë menaxhimin e një fondi të tranzicionit dhe investimet në fondet e kapitaleve. Ajo gjithashtu do të mbulojë kompanitë që iu janë nënshtruar procedurave të ristrukturimit, privatizimit dhe falimentimit. Duke përdorur asetet e fondit të tranzicionit dhe fonde të tjera që gjenden në treg, agjencia do të marrë masa për rimëkëmbjen e kompanive dhe për të siguruar ristrukturimin e tyre me qëllim që të përmbushin në mënyrë më efikente pretendimet e kreditorëve, si dhe me qëllim të përgatitjes së kompanive në fjalë për të vepruar pa subvencione nga shteti nga 2015 e tutje.

Sistemi bankar në Serbi përbëhet nga 27 banka, ku 5 bankat kryesore (Banca Intesa A.D.- Beograd, Komercijalna banka A.D.- Beograd, Unicredit Bank Srbija A.D.- Beograd, Societe Generale banka Srbija A.D.- Beograd, Raiffeisen Banka A.D.- Beograd) zotërojnë 54.2 % të aktiveve, 52.70% të kredive dhe 53.60 % të depozitave.

Sipas totalit të bilancit, banka kryesore në Serbi është ende Banca Intesa A.D. Beograd, me një rënie të pjesës së tregut (me 1.0 pikë përqindjeje) krahasuar me tremujorin e kaluar, por gjithashtu një rënie në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë (me 1.7 pp). Përveç

kësaj banke, pjesë të tregut me mbi 10% deri më 31 dhjetor 2018 kanë regjistruar : Unicredit Bank Srbija A.D. Beograd (11.6%) dhe Komercijalna banka A.D. Beograd (10.6%).


Mbizotërojnë bankat me origjinë kapitali nga Itali, Austri, Francë dhe Hungari (gjithsej tetë banka) mbizotërojnë sektorin bankar të Serbisë me një pjesëmarrje në totalin e bilancit prej 56,7%.

IV.2. Treguesit kryesor të sistemit bankar

Në këtë pjesë do të bëhet një analizë përshkruese e sistemit bankar të pesë vendeve të përfshira në këtë studim. Kjo me qëllimin që të prezantohet ecuria e treguesve kryesorë në nivelë të sistemit të bankave që operojnë në këto vende. Treguesit të cilit iu referohemi janë: totali i aktiveve, kredive dhe depozitave.

Aktivitet e sektorit bankar, në Republikën e Maqedonisë së Veriut në fund të vitit 2018 ishin rreth 504 milion denar, duke pësuar në këtë mënyrë një rritje vjetore 9 % nga viti 2017 ne vitin 2018, ndërkohë që rritja në vitin 2017 ishte 3.89%. Paraqitja në mënyrë grafike e rritjes së totalit të aktiveve, kredisë dhe depozitave në sistemin bankar në nëntë vitet e fundit paraqitet në vijim.

Grafiku 1. Totali i aktiveve, kredive dhe depozitave në sistemin bankar të Republikës së Maqedonisë



Burimi: Banka Qëndrore e Republikës së Maqedonisë

Rënia e rritjes së aktiveve fillon nga viti 2011 dhe ka vazhduar në vitet pasardhëse, duke shënuar në vitin 2013 rënien më të ulët në terma absolute dhe relativë që nga viti 2001. Rritja e ngadaltë e aktiveve është shkaktuar nga rritja në nivele të ulëta të depozitave nga insitucionet jo-financiare. Rritje më të theksuar mund të vërejmë nga vitit 2017 në 2018 edhe atë 9%.

Kreditimi i subjekteve jofinanciare, shihet se ka një trend rritje pas vitit 2010, por pikun e rritjes e ka në vitin 2012, me 34 milion denarë ose 20%, ndjekur në vitet në vazhdim me një rritje të lehtë. Edhe pse në terma absolut rritja në vitin 2018 është më e madhe se në vitin 2017, 22.50 milion denarë dhe 16.61 milion denarë respektivisht, në përqindje rritja në vitin 2018 është vetëm 7.6% krahasuar me 5.9% në vitin 2017. Rritja e kredive është më shumë e dukshme në sektorin e individëve krahasuar me kredinë ndaj bizneseve, ku kjo e fundit është rritur me ritme më të ngadalëta. Duhet vënë në dukje që në Maqedoni mbizotëron kreditimi në monedhën vendase e cila ka pësuar një rritje nga 41.50% (2009) në 73.5% (2018). Përsa i takon afatit të

kredive, mbizotërojnë kreditë afatgjata të cilat kanë thuhetse një stabilitet, nga 68.85% (2011) në 73.39% (2018).

Në lidhje me depozitat, ato vlerësohen rreth 371 milion denarë në fund të vitit 2018 me një rritje 9.4 % krahasuar me vitin 2017. Trendi i depozitave ka qenë rritës, edhe pse ritmi i rritjes së tyre ka qenë në rënie, me përjashtim të viti 2014 dhe të vitit 2018.


Rënia e ritmit të rritjes së depozitave i dedikohet kryesisht zhvillimeve politike brenda vendit si dhe zhvillimet me shtetit fshinjë. Pavarësisht kësaj, depozitat mbeten burimi kryesor i fondeve, ato përbëjnë 73.75% të totalit të aktiveve. Individët mbeten kontribuesit kryesor (69.22% të totalit të depozitave), edhe pse norma e rritjes së tyre vjetore në vitin 2016 është më e vogla në dekadën fundit. Mbizotërojnë depozitat në monedhën vendase të cilat përbëjnë rreth 57.50% të totalit të depozitave.

Këto zhvillime tregojnë për një stabilizim gradual të perceptimit të bankave në lidhje me rrezikun, e ndikuar kjo edhe nga performanca pozitive e ekonomisë vendase.

Pavarësisht rimëkëmbjes ekonomike, bankat janë ende të kujdesshme në lidhje me kreditimin e biznesit, e cila reflekton strategjitë konservative të grupeve më të mëdha të bankave në Maqedoni. Bankat ende shfaqin interes të investojnë në instrumenta likuidë me rrezik të ulët, siç janë për shembull bonot e thesarit.

Situata e Shqipërisë gjatë periudhës së analizuar është e atillë që aktivet e sektorit bankar janë zgjeruar me 1.9%, dhe struktura e bilancit nuk ka shfaqur ndryshime të rëndësishme. Vlera e raportuar e aktiveve u rrit me 27 miliardë lekë gjatë periudhës, duke arritur në 1,453 miliardë lekë, dhe kontributin më të madh në këtë rritje e ka dhënë zgjerimi me rreth 17 miliardë lekë në zërin e investimeve në tituj dhe rënia me rreth 9 miliardë lekë në fondin e provigjioneve për rrezikun e kredisë. Ngadalësimi në rritjen e kredisë është reflektuar në një kontribut të vogël dhe negativ të zërit “veprime me klientët” në ndryshimin gjashtëmujor dhe vjetor të totalit të aktiveve të sektorit bankar. Ritmi vjetor i rritjes së aktiveve u ngadalësua në 0.6%, nga 2.7% një vit më parë. Paraqitja në mënyrë grafike e rritjes së totalit të aktiveve në sistemin bankar në tetë vitet e fundit paraqitet në grafikun nr.2

Grafiku 2. Totali i aktiveve, depozitave dhe kredive në sistemin bankar të Shqipërisë



Burimi: Shoqata Shqiptare e Bankave, Buletinet mujor Dhjetor 2010-Dhjetor 2018

Siç duket qartë edhe në grafikun 2, aktivet janë rritur ndjeshëm nga viti në vit, duke patur parasysh edhe periudhën jo të favorshme nga pikëpamja e zhvillimit të ekonomisë për shkak të pasojave të krizës financiare. Për periudhën kohore prej 9 vitesh (që nga 2010), aktivet janë rritur me më shumë sesa 50 përqind e vlerës në fillim të kësaj periudhe, duke treguar për një fuqizim të sektorit bankar në ekonominë shqiptare.

Depozitat dhe fondet e veta përbëjnë burimet kryesore të financimit të veprimtarisë së sektorit bankar, ndërkohë që varësia ndaj burimeve të huaja të financimit mbetet e kufizuar. Pavarësisht kësaj, gjatë periudhës është vërejtur zgjerim i detyrimeve ndaj jorezidentëve, në formën e llogarive rrjedhëse të institucioneve financiare jorezidente dhe depozitave të vendosura nga subjekte jorezidentë pranë bankave vendase. Këto zhvillime kanë rezultuar në ngushtim të pozicionit kreditor neto të sektorit bankar.

Në fund të vitit 2018, teprica e kredisë ishte 581 miliardë lekë, duke qenë 1.6 miliardë lekë ose 0.3% më e ulët sesa ajo e regjistruar në fund të gjashtëmujorit të parë dhe rreth 20 miliardë lekë ose 3.4% më pak se një vit më parë. Edhe pse kredia e re ishte më e lartë në krahasim me atë të


dhënë gjatë gjysmës së parë të vitit, ecuria e tepricës së kredisë ka reflektuar nivelin e lartë të shlyerjeve, të cilat, gjatë periudhës, arritën në rreth 120 miliardë lekë. Gjatë periudhës, bankat kanë fshirë nga bilancet e tyre një total prej rreth 5 miliardë lekësh kredi të humbura. Nëse portofoli i kredisë bankare do të përmbante edhe kreditë e fshira, teprica e kredisë do të ishte rritur me 0.5% gjatë periudhës.

Pavarësisht përpjekjeve të Bankës së Shqipërisë për nxitjen e kreditimit të ekonomisë duke ulur disa herë normën bazë të interesit (Janar dhe Nëntor të vitit 2015) madje duke shkuar në nivelet shumë të ulëta 1.75%, nuk u arrit të përcillej në bankat e nivelit të dytë.

Sistemi bankar në Serbi përbëhet nga 27 banka, ku 5 bankat kryesore (Banca Intesa A.D.- Beograd, Komercijalna banka A.D.- Beograd, Unicredit Bank Srbija A.D.- Beograd, Societe Generale banka Srbija A.D.- Beograd, Raiffeisen Banka A.D.- Beograd) zotërojnë 54.2 % të aktiveve, 52.70% të kredive dhe 53.60 % të depozitave. Bankat e huaja kanë pozicion dominues në tregun bankar duke zotëruar pjesën më të madhe të aktiveve (76.10%) dhe kapitalit (77.50%). Mbizotërojnë bankat me origjinë kapitali nga Greqia, Italia, France dhe Austria.

Paraqitja në mënyrë grafike e ndryshimit të totalit të aktiveve, kredisë dhe depozitave në sistemin bankar në tetë vitet e fundit paraqitet në grafikun nr.3 si më poshtë.

Grafiku 3. Totali i aktiveve, kredive dhe depozitave në sistemin bankar të Serbisë
(në miliard dinar Serb)



Burimi: Banka Qëndrore e Serbisë (2018)

Rritja e aktiveve në sektorin bankar ka qenë e vazhdueshme dhe e qëndrueshme që nga viti 2010 deri në vitin 2018 me përjashtim të vitit 2013 ku vihet re një rënie e këtij treguesi.

Aktivet e sektorit bankar, në fund të vitit 2018 ishin rreth 3,774 miliard dinar Serb, duke pësuar në këtë mënyrë një rritje vjetore 12 %, ndërkohë që rritja në vitin 2017 ishte 4%. Kontribuesi kryesor në rritjen e aktiveve janë Kreditë të ndjekura nga Investimet në Letrat me Vlerë.

Prirja e ndryshimit të nivelit të kredive është kryesisht rritës, me përjashtim të viti 2011 dhe 2013 ku konstatohet e kundërta. Rënia në nivelin e kredive në vitin 2013 me rreth 136 miliard Dinar Serb është shkaktuar nga zvogëlimi i kredive ndaj kompanive si dhe kredive ndaj individëve të huaj dhe bankave të huaja, rënie e cila është kompesuar pjesërisht nga rritja më e rëndësishme e kredive, ajo në lidhje me sektorin Financiar dhe Sigurimit. Arsyeja kryesore e nxitjes së kreditimit ndaj Institucioneve Financiare dhe të Sigurimit ishte ngurrimi i bankave nga kreditimi i sektorit real dhe investimet e tyre dhe fokusimi në letrat me vlerë me risk të ulët. Rritja e kreditimit gjatë viteve në vijim, vjen si rezultat i politikave lehtësuese si për kreditë ndaj individëve ashtu edhe për bizneset, të tilla si ulja e marzheve në normat e interesit, komisionet

dhe tarifat. Arsye të tjera mund të përmendim burime fondesh me çmim të lirë, rritje e konkurrencës midis bankave, politika monetare ekspansioniste e Bankës Kombëtare të Serbisë.

Ne fund të vitit 2018 kreditë ishin 2.267 miliardë Dinar Sërb që në krahasim me fundin e vitit 2017 rritja nominale e kredive arriti në 213.5 miliardë Dinar Sërb ose 10.4%.


Në lidhje me monedhën e kredive, mbizotëron kredia në valutë të huaj 68.80%, si për bizneset ashtu dhe për individët, kryesisht në Euro 65.50 %. Përsa i takon maturimit, mbizotërojnë kreditë afat gjata, të cilat përbëjnë 76% të totalit të kredive neto.

E ndryshme paraqitet situata në lidhje me nivelin e depozitave, të cilat kanë shënuar një rritje të vazhdueshme që nga viti 2010. Në fund të vitit 2018 depozitat ishin rreth 2.732 miliard dinar Sërbë me një rritje 15.7 %, ndërkohë që rritja në vitin 2017 shënonte 4.8 %. Edhe në rastin e depozitave, mbizotërojnë depozitat në valutë të huaj 68.5%, ku peshën më të madhe (89.90% e portofolit) e zënë depozitat në Euro. Pjesa tjetër e valutës së huaj dhe monedhës indeksuara depozitat e huaja kryesisht i referohen depozitat në dollarë amerikanë (6.5%) dhe franga zvicerane (2.7%).

Në lidhje me afatin e depozitave, peshën më të madhe e kanë depozitat pa afat (63.7 % të totalit të depozitave) si dhe depozitat afatshkurtër, deri në një vit (24.30% të totalit të depozitave), ndërsa 12.0% të të gjitha depozitave janë kontraktuar, për një periudhë më të gjatë se një vit.

Sistemi bankar në Malin e Zi përbëhet nga 15 banka. Aktivët e sektorit bankar, në fund të vitit 2018 ishin rreth 4,407 milion Euro, duke pësuar në këtë mënyrë një rritje vjetore 5.40 % por krahasuar me vitin 2017 ishte më e vogël sepse rritja në 2017 ishte 10,33%. Paraqitja në mënyrë grafike e rritjes së totalit të aktiveve, kredisë dhe depozitave në sistemin bankar në nëntë viteve të fundit paraqitet në grafikun nr.4 si më poshtë.

Grafiku 4. Totali i aktiveve, kredive dhe depozitave në sistemin bankar të Republikës së Malit të Zi



Burimi: Banka Qëndrore e Republikës së Malit të Zi

Siç mund të vihet re edhe nga grafiku, totali i aktiveve në sistemin bankar në Malin e Zi ka pësuar një rënie të vazhdueshme që nga viti 2010 deri në vitin 2012. Vetëm pas vitit 2013, ka filluar të paraqesë një prirje pozitive e cila ka vazhduar edhe në vitet pasardhëse. Kjo rënie vjen si rezultat i rënies së vazhdueshme të kredive, duke qenë se kreditë zënë peshën më të madhe në aktivet e sistemit bankar.


Në vijim të mendimit, edhe tek kreditë vihet re e njëjta sjellje si tek aktivet, pra një zvogëlim i vazhdueshëm i tyre deri në vitin 2012. Aktiviteti i kredidhënies është rigjallëruar në vitin 2013, duke vazhduar të rritet edhe në vitet pasardhëse. Në fund të vitit 2018 totali i kredive është afër tri miliard Euro, duke shënuar një rritje vjetore prej 8.5% e cila krahasuar me vitin 2017 ishte me e vogël, ku rritja në 2017 ishte 18.76%. Kjo rritje kaq e vogël vjen si rezultat i politikave shtrënguese të kredidhënies. Rritja në nivelin e kredive i dedikohet rritjes së nivelit të

kredidhënies ndaj kompanive si dhe ndaj individëve vendas. Përsa i takon afatit të maturimit, mbizotërojnë kreditë afat gjata (78.11%) dhe afatshkurtra me 21,89%.

Në rastin e depozitave, vihet re që nuk është trendi i njëjtë si me atë të aktiveve dhe kredive. Niveli i depozitave ka ardhur në rritje nga viti 2010 deri në vitin 2018. Në fund të vitit 2018 depozitat ishin rreth 3.5 miliardë Euro duke shënuar një rritje 5,88 %, ndërsa në vitin 2017 rritja ishte 13,77%. Kjo tregon rritjen e besimit që kanë individët në sistemin bankar. Kontributin më të madh në rritjen e depozitave e kanë individët me 53.44% të totalit të depozitave, dhe më pak kompanitë të cilat përbëjnë thuajse gjysmën e depozitave të individëve, me vetëm 31.78% . Ndërsa përsa i përket afatit të maturimit në vitin 2018, depozitat pa afat 64.21% dhe depozitat me afat 33.81% . Në lidhje me strukturën e monedhës, mbizotërojnë depozitat në monedhën vendase Euro, me 93.10% të totalit të depozitave, ndërsa depozitat në monedha të tjera zënë 6.9 % të depozitave totale.

Një analizë e strukturës së sektorit bankar të BeH gjatë një periudhe trembedhjet vjeçare ka treguar një rënie të numrit të bankave tregtare. Në fillim të periudhës së analizuar, në vitin 2010, operuan 32 banka tregtare (9 banka në RS dhe 23 banka në FBH), dhe në vitin 2018, funksionuan gjithsej 23 (8 banka në RS dhe 15 banka në FBH). Gjatë periudhës së analizuar, disa banka u bashkuan dhe përfunduan, dhe banka të reja hynë në tregun e BeH. Paraqitja në mënyrë grafike e rritjes së totalit të aktiveve, kredisë dhe depozitave në sistemin bankar në nëntë viteve të fundit paraqitet në grafikun nr.5 si më poshtë.

Grafiku 5. Totali i aktiveve, kredive dhe depozitave në sistemin bankar të Republikës së BeH



Analiza e aktiveve të sistemit bankar në BeH përcaktoi rritjen e saj të vazhdueshme. Që nga viti 2010, aktivet e bankave tregtare në BeH janë në rritje të vazhdueshme, kështu që në fund të vitit 2010 ato arritën në 20.84 miliardë KM, që është 0.7% më shumë se në vitin e kaluar. Në vitin 2011, aktivet e sektorit bankar u rritën me 3.41%, në vitin 2012 me 2.03%, ndërsa në vitin 2013 u rritën me 5.21% në krahasim me një vit më parë. Në vitin 2014, aktivet u rritën me 4.28%. Trendi i rritjes së aktiveve të sektorit bankar, i cili filloi në vitin 2010, vazhdoi, kështu që në fund të vitit 2018, aktivet e sektorit bankar të BeH arritën në 33.41 miliardë KM.

Të dhënat e paraqitura tregojnë se depozitat totale të sektorit bankar të BeH kishin një prirje rritjeje në periudhën nga 2010 deri në fund të 2018. Në fund të vitit 2018, depozitat totale arritën në 21.74 miliardë KM, 10.58% më shumë sesa në vitin 2017, kur ato arritën në 19.67 miliardë KM. Kjo rritje e konsiderueshme e depozitave tregon faktin se besimi në bankat tregtare që operojnë në BeH është rikthyer.

Depozitat totale të sektorit bankar të BeH përbëhen nga depozitat në monedhën vendase dhe depozitat në valutë të huaj. Depozitat në valutë të huaj kryesisht përbëhen nga depozitat në euro, ndërsa një pjesë më e vogël i referohet depozitave në monedha të tjera të huaja.

Një tregues shumë i rëndësishëm i vëllimit të biznesit të secilës bankë, por edhe i sektorit bankar në tërësi, është niveli i gjithsej kredive. Huatë janë gjeneruesi më i madh i rrezikut potencial në

banking. Nga ana tjetër, klientët të cilët duhet të financojnë aktivitetet e tyre, por nuk kanë burime të mjaftueshme financiare, mbështeten në kreditë bankare.

Të dhënat tregojnë se gjithsej kreditë patën një prirje rritjeje gjatë periudhës së analizuar, në fund të vitit 2018, totali i huave të sektorit bankar arriti në 19.48 miliardë KM dhe ishte më i lartë për 1.06 miliardë KM ose 5.77% sesa në vitin 2017, kur ato arritën në 18.42 miliardë KM.

IV.3. Sistemi kreditimit bankar në vendet e Ballkanit Perindimor

Zhvillimet në ekonominë globale dhe veçanërisht kriza ekonomike botërore po ushtrojnë ndikim negativ mbi tregun e vendeve të Ballkanit Perindimor, dhe po shkaktojnë tkurrjen e tregut të kredive.

Vitet e fundit, shtimi i kredisë në sistemin bankar është ngadalësuar në mënyrë progresive duke filluar nga tremujori i katërt i vitit 2008 nga +5.02% në -1.86% në tremujorin e tretë të vitit 2013. Sipas vërtetimeve të kryera nga Bankat Qendrore të këtyre vendeve rezulton se tek bankat e nivelit të dytë, ka disa arsye që i kanë detyruar të shtrëngojnë standartet e kredisë sidomos këto tre vitet e fundit dhe veçanërisht në sektorin e ndërmarrjeve të vogla e të mesme, por edhe në sektorin e ndërmarrjeve të mëdha.

a. Kjo prirje lidhet me problemet që karakterizojnë sektorin ku zhvillon veprimtarinë ndërmarrja. Aktualisht ka disa sektorë që vitet e fundit janë në vështirësi financiare si për shembull: sektori ndërtimit, industria përpunuese dhe tregtia, riparimi automjeteve dhe i artikujve shtëpiakë. Këta sektorë paraqesin peshën më të madhe të shpërndarjes së kredisë sipas degëve të ekonomisë dhe detyrimisht kanë ndikuar negativisht edhe në rritjen e kredive me probleme në sistemin bankar të vendeve të Ballkanit Perindimor.

b. Gjendja e kredive me probleme në tërë sistemin bankar, e cila ka filluar të përkeqësohet duke filluar nga tremujori katërt i vitit 2008 dhe deri në ditët e sotme.

c. Situata e përgjithshme makroekonomike, e cila vitet e fundit pavarësisht se ka pësuar një rritje pozitive, nuk ka mundur të mbështesë prirjen rritëse të nivelit të kredive.

Sipas Raportit të Rregullt Ekonomik (RRrE) i cili mbulon zhvillimet, perspektivat dhe politikat ekonomike në gjashtë vende të Evropës Juglindore në Ballkanin Perëndimor: Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë, IRJ të Maqedonisë, Malin e Zi dhe Serbi. Raporti i Rregullt Ekonomik nr.12 dhe nr.14 për Ballkanin Perëndimor në lidhje me sistemin e kreditimit bankar në vendet e Ballkanit Perëndimor kanë këtë qëndrim: Rritja e kreditimit filloi të rimëkëmbet, e nxitur kryesisht nga kreditë për individë. Pas nivelit të ulët në vitin 2016, kreditimi në Mal të Zi u rrit me më shumë se 6 përqind në Qershor 2017, për shkak të përmirësimit të treguesve të besimit dhe rritjes së qëndrueshme të depozitave, të cilat përbëjnë burimin kryesor të financimit për bankat vendase. Poashtu në vitin 2018 në Malin e Zi, rritja e shpejtë e kredisë për sektorin privat tejkaloi 9 përqind, pasi cilësia e aktiveve vazhdoi të përmirësohej dhe depozitat, një burim kryesor i financimit për bankat vendase, u rritën ndjeshëm. Pas një periudhe me pasiguri politike në Bosnjë-Hercegovinë, Serbi dhe IRJ të Maqedonisë, kredia për ekonominë vijoi të rritet me ritme të qëndrueshme, midis 4 dhe 6 përqind, në vitin 2018 shkon në 7 përqind. Megjithatë të dhënat për Shqipërinë flasin për një rënie të kreditimit, duke marrë parasysh fshirjen e një numri të konsiderueshëm të kredive me probleme, ecuria e kredive të reja ishte pozitive dhe nxiti rritjen ekonomike. Rritja e kreditimit është nxitur kryesisht nga kreditë për individët; kreditë për bizneset kanë pasur trende të ndryshme, pjesërisht për shkak të rritjes së vogël të kredive të reja dhe fshirjes së kredive me probleme (KJPve). Pavarësisht progresit të përgjithshëm në zgjerimin e tregut të kredive në të gjithë Ballkanin Perëndimor, kredia e brendshme për sektorin privat vazhdon të mbetet shumë prapa niveleve të Bashkimit Evropian.

Rritja e huadhënies në monedhë vendase ndihmoi në menaxhimin e rreziqeve lidhur me valutën në portofolet e sektorit privat. Bankat qendrore në Shqipëri, IRJ të Maqedonisë dhe Serbi kanë paraqitur masa që synojnë të de-euroizojnë bilanci si dhe kanë rritur normën e rezervave të detyruara për depozitat në valutë të huaj dhe koeficientin e riskut për huamarrësit e pambrojtur.

Progresi në këtë drejtim ka qenë i ngadaltë; stoku i kredive në valutë të huaj është ende i lartë dhe varion nga rreth 45 përqind e totalit të kredive në IRJ të Maqedonisë në rreth 70 përqind në Serbi. Në Shqipëri, niveli i huadhënies në valutë të huaj ka pësuar rënie të lehtë nga 60 për qind në 2016 në 57 përqind në 2017 dhe në vitin 2018 në 50%; gjithashtu Serbia kishte rënie nga 70.2 në 67.7 përqind, në vitin 2018 në 60%.

Bankat në Ballkanin Perëndimor janë të kapitalizuara mire dhe likuide, me mundësi për konsolidim të mëtijshëm. Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit të sistemit bankar arriti mesatarisht në 17.4 për qind në tremujorin e dytë 2017 dhe norma e likuiditetit ndaj totalit të aktiveve ishte rreth 28 përqind. Rentabiliteti ka pasë rritje të lehtë dhe norma e kthimit nga aktivet në rajon është mesatarisht 1.8 përqind, duke pasur rritje krahasuar me nivelin 1.1 përqind në fund të 2016. Megjithatë, ekspozimi i bankave vendase ndaj rreziqeve të jashtme ka rizgjuar shqetësimet lidhur me cilësinë e aktiveve dhe shëndetin e disa bankave të caktuara, veçanërisht në Bosnjë-Herzegovinë dhe Mal të Zi. Me shumë mundësi, do të ketë ndryshime të tjera strukturore që do të vijnë nga shitja e planifikuar e disa filialeve të huaja, pasi disa banka mëmë kanë vendosur të rishikojnë prezencën e tyre në vende të tjera, si dhe nga bashkimi apo shkrirja e disa institucioneve të vogla në Bosnjë-Herzegovinë. Zvoglimi i levës financiare (deleveraging) nga bankat e huaja solli rritje të depozitave vendase dhe zvoglim të raportit mesatar kredi-depozita nga 119 përqind në 2008 në rreth 88 përqind në mes të vitit 2017.

Ndërmjetësimi financiar në vendet e Ballkanit Perëndimor është minimal dhe përmirësimet kanë qenë të ngadalta. Thellësia e sektorit financiar e matur si raporti i kreditimit të sektorit privat ndaj BPV-së ishte mesatarisht 45 përqind në vitin 2016, ku nivelet më të ulëta u regjistruan në Shqipëri në 35 përqind të BPV-së, në krahasim me nivelin prej rreth 93 përqind në eurozonë. Ky nivel nuk është i krahasueshëm as me vende të tjera në Europën Qendrore dhe Juglindore. Thellimi i sektorit financiar ka pësuar rënie të lehtë prej 3 përqind të BPV-së që prej vitit 2008. Ndonëse bankat po i zhvendosin modelet e tyre të financimit drejt mobilizimit të më shumë depozitave, diversifikimi i burimeve të financimit dhe evolimi i cekëtësisë së sektorit financiar jo-bankar do të jenë thelbësor për të garantuar financime afatgjata që stimulojnë investimet dhe rrjedhimisht edhe rritjen ekonomike. Në veçanti, konsolidimi i tregjeve të kapitalit mund të

ndihmojë në lehtësimin e vështirësive që mund të hasen gjatë diversifikimit të burimeve të nevojshme të financimit.

Gandrud dhe Hallerberg (2017) identifikojnë tre elementë të domosdoshëm për adresimin e suksesshëm të problematikës së kredive të këqija: (i) së pari, sistemi bankar duhet të ketë disa banka të kapitalizuara që janë në gjendje të përballojnë humbjet që do të shkaktohen nga reduktimi i kredive me probleme; (ii) së dyti, përfshirja në sistem e një institucioni të pavarur rregullator i cili duhet të identifikojë problemin dhe të jetë në gjendje të kushtëzojë zbatimin e një plani; (iii) së treti, garantimi i instrumentave dhe mjeteve që sigurojnë një proces të rregullt të reduktimit të kredive me probleme. Plotësimi i këtyre parakushteve është një domosdoshmëri për të përballuar

riskun, pavarësisht reformave që do të zgjidhen për t'u zbatuar. Bazuar në karakterin e tyre, këto reforma klasifikohen në dy grupe: reforma strukturore dhe reforma operacionale.

Sidoqoftë, kreditë me probleme janë bërë një burim i rrezikut sistemik dhe autoritetet shtetërore të të vendeve të marra në hulumtim e kanë njohur nevojën për të zgjidhur kreditë me probleme si një detyrë me rëndësi të lartë që kërkon një strategji gjithëpërfshirëse që përfshin të gjitha institucionet përkatëse. Qeverit e këtyre vendeve kanë formuar Grupe Punuese të përbërë nga përfaqësues të të gjitha institucioneve përkatëse për të hartuar Strategji për zgjidhjen e kredive me probleme, e cila përfshin: (1) identifikimin e barrierave rregullatore, tatimore, institucionale dhe të tjera për zgjidhjen e kredive me probleme, (2) objektin e aktiviteteve specifike (politikat dhe masat) që duhet të ndërmerren nga të gjitha institucionet për të arritur qëllimin themelor dhe

për të arritur përparësitë kryesore të Strategjisë, (3) planin e veprimit të Qeverisë që përcakton veprimtaritë e të gjitha institucioneve shtetërore dhe planin e veprimit të Bankeve Kombëtare, një rishikim të të gjitha aktiviteteve që duhet të ndërmerren nga BK gjatë zbatimit të Strategjisë dhe (4) detyrimet e monitorimit të zbatimit për Grupin e Punës dhe institucionet përgjegjëse për ndërmarrjen e aktiviteteve në përputhje me Strategjinë.

Në përputhje me Strategjinë, institucionet kompetente do të ndërmarrin një numër aktivitetsesh, të cilat duhet të kryhen me qëllim që: (1) të vlerësohet aftësia e bankave për të zgjidhur kreditë me probleme, (2) të krijojë kushte për zhvillimin e tregjeve të kredive me probleme, (3) promovimin dhe inkurajimin e ristrukturimit jashtë gjykatës; (4) të përmirësojë mekanizmat për zgjidhjen e borxhit të korporatave përmes gjykatave dhe kornizës rregullatore për hipotekat.

Menaxhimi i kredive me probleme nuk do të ishte i realizueshëm në qoftë se nuk ka stabilitet makroekonomik dhe politika të shëndosha që janë baza për një mjedis të përgjithshëm të qëndrueshëm dhe të parashikueshëm për funksionimin e bankave dhe subjekteve të tjera ekonomike. Përveç parakushteve makroekonomike, arritjet e sektorit të korporatave, cilësia e menaxhimit të kompanive, por edhe mënyra se si bankat vlerësojnë aftësinë e kreditit të klientëve të tyre kanë një rol veçanërisht të rëndësishëm. Prandaj, çdo reformë në sistemin ligjor ose tatimor, ose në kornizën më të gjerë rregullatore në përgjithësi, nuk do të jepte në vetvete rezultate pozitive në trajtimin e kredive me probleme, nëse ka dobësi në procesin e kredisë dhe menaxhimin joadekuat të rrezikut nga bankat dhe gjithashtu nëse ato dobësi nuk zbulohen me kohë dhe në mënyrë efektive nga autoriteti kompetent mbikëqyrës. Pajtueshmëria e kornizës së përgjithshme ligjore dhe rregullatore, funksionalitetin e sistemit juridik, rregullimin e qartë të rregullores tatimore dhe shkallën e zhvillit dhe dhe funksionalitetit të segmenteve të tregut janë fusha që mund të kontribuojnë në përmirësimin e menaxhimit të kredive me probleme. Sidoqoftë, ato nuk mund të jenë zëvendësues për menaxhimin dhe operimin cilësor dhe rritjen e kapacitetit të institucioneve financiare, por edhe debitorëve në sektorin e korporatave.

Prandaj, një segment veçanërisht i rëndësishëm është siguria juridike dhe besimi në sistemin juridik, të cilat janë më të theksuara përmes gjyqësorit efikas dhe ekzekutimit efikas të vendimeve gjyqësore. Premisa themelore për punë të suksesshme afariste është pritja që palët në

marrëdhëniet kontraktuale të përmbushin detyrimet e marra. Në këtë mënyrë, subjektet afariste mund të rregullojnë pritjet dhe planet e tyre në aktivitetet e tyre të investimit në të ardhmen. Prandaj, ekziston nevoja për një proces të vazhdueshëm të përmirësimit të efikasitetit të punës së gjykatave, si dhe harmonizim të vazhdueshëm të legjislacionit me praktikën, i cili do të përcaktojë dhe zvogëlojë fërkimet e tregut.

Aktivitetet dhe masat e propozuara për të përmirësuar menaxhimin e kredive me probleme të bankave, pavarësisht nëse ato lidhen me aktivitete specifike ose nisma për bashkëpunim të ardhshëm midis institucioneve kompetente, bazohen në parimin e mos-përdorimit të burimeve financiare publike, d.m.th. fondeve nga buxheti i shtetit të Maqedonisë së Veriut, për një qëllim të tillë. Të gjitha aktivitetet dhe masat e marra në të kaluarën dhe ato që do të merreshin si pasojë e këtij dokumenti, nuk zëvendësojnë faktin se gjithmonë përgjegjësia dhe pasojat përfundimtare të shfaqjes, vëllimit dhe ndryshimit të kredive me probleme duhet të bien mbi ato subjekte që kanë miratuar vendimin për miratimin e kredisë, d.m.th. bankat. Republika e Maqedonisë së Veriut, pas pavarësisë së saj, mundësoi privatizimin e sektorit bankar dhe parakushtet për hyrjen e lirë të kapitalit të huaj në sistemin bankar, pa ndërhyrje në pronësinë, menaxhimin dhe vendimmarrjen për huadhënien. Përfshirja e saj në marrjen në dorë të portofolit të kredisë "të keqe" të bankave do të inkurajonte të ashtuquajturën rënia të moralit të institucioneve financiare dhe do të krijonte një bazë për formimin e strukturave të bankave, për ndërhyrje të mëtutjeshme shtetërore për socializimin e humbjeve private.²⁷

²⁷ НБРМ, Стратегија за поттикнување на справување на управувањето и подобрувањето со нефункционалните кредити, Декември, 2018, fq. 18-19

KAPITULLI V

METODOLOGJIA E HULUMTIMIT DHE TË DHËNAT

Metodologjia hulumtuese e këtij disertacioni të doktoratës konsiston në modelet e avansuara ekonometrike të natyrës statike dhe dinamike. Më konkretisht, për analizën e hipotezave të ngritura në këtë studim përdoren modeli Pooled OLS, Fixed Effects, Random Effects, Two Stage Least Square (2SLS), si dhe metoda dinamike që është më e avansuar krahasuar me ato statike, pra GMM (Generalized Method of Moments). Modeli Pooled OLS, është forma më e thjeshtë e përdorimit të të dhënave dhe informacioneve në formën gjatësore, që realizohet duke injoruar strukturën panel të të dhënave, ndërsa, analiza e të dhënave të panelit mundëson kontrollin e heterogjenitetit individual për të shmangur paragjykimet në vlerësimet që rezultojnë. Heterogjeniteti midis vendeve është një aspekt kryesor i analizës së të dhënave në panel, që në fakt është edhe fokusi kryesor i analizës (Green, 2002 ctp.283).

Dallimi midis modeleve Fixed dhe Random Effects qëndron në faktin se modeli me efekte fikse (Fixed Effects) është një model statistikor që përfaqëson sasitë e vëzhguara në drejtim të variablave shpjeguese që trajtohen sikur sasitë të ishin jo të rastit. Kjo është në kontrast me modelet e efekteve të rastit (Random Effects) dhe modelet e përziera në të cilat ose të gjithë ose disa nga variablat shpjeguese trajtohen sikur të lindin nga shkaqe të rastësishme. Stock dhe Watson (2003) theksojnë se nëse variabla e pa vrojtuar nuk ndryshon me kalimin e kohës, atëherë çdo ndryshim në variablin e varur duhet të jetë për shkak të ndikimeve të ndryshme nga karakteristikat fikse. Përdorimi i “Fixed Effects” bëhet sa herë që jemi të interesuar të bëjmë një

analizë sa i përket ndikimit të variablave që mund të ndryshojnë me kalimin e kohës. Efektet fikse trajtojnë marrëdhëniet në mes parametrave të parashikuara, dhe rezultateve të variablave brenda një entiteti të caktuar, që mund të përfshijë (vend, person, kompani, shtet etj). Ndërsa modeli “Random Effects”, gjithashtu i njohur si modeli i komponentëve të ndryshimit, është një lloj modeli hierarkik linear. Ky model supozon se të dhënat po analizohen në koordinim me një hierarki të mostrave të ndryshme, dallimet e të cilave lidhen me atë hierarki. Për të testuar dhe argumentuar se cila nga këto dy metoda paraqet rezultate më të besueshme do të përdorim testin Hausman.

Nga ana tjetër, endogjeniteti është një nga problemet kryesore që karakterizon modelet me të dhëna panel. Sfidë kryesore është tejkalimi dhe zgjidhja e këtij problemi në mënyrë që të sigurohen vlerësues të paanshëm. Në kontekstin e modeleve të paneleve, shumica e studimeve përdorin metodat me variabla instrumentale (IV), pra qasjen 2SLS, për t'u marrë me çështjen e anshmërisë dhe njëkohësisë. Vlerësuesi 2SLS korrigjon problemin e endogjenitetit madje edhe për variablat e shumta shpjeguese endogjene.

Sa i përket metodës së përgjithësuar të momenteve (GMM) si metodë më e avansuar ekonometrike, kombinon të dhënat e vëzhguara ekonomike me informacionin në kushtet e momentit për të prodhuar vlerësime të parametrave të panjohura brenda një modeli ekonometrik (Hansen, 1982). Në vazhdim do të paraqitet detajisht korniza teorike e secilës nga metodat e lartpërmendura të përdorura për sigurimin e rezultateve empirike dhe konstatimeve të ngritura në këtë disertacion.

5.1.1 Modeli Pooled OLS

Rasti më i thjeshtë i përdorimit të të dhënave dhe informacioneve në formën gjatësore realizohet duke injoruar strukturën panel. Pasi të dhënat janë të organizuara nga njësitë vendimmarrëse, atëherë modeli mund të paraqitet si vijon:

$$Y = X\beta + \varepsilon$$

Në këtë rast, për një variabël ‘X’ të dhënë, nuk ka asnjë korrelacion midis observimeve. Me fjalë të tjera, supozohet që observimet individuale me kalimin e kohës janë observime nga individ të ndryshëm. Një qasje e tillë mund të jetë e arsyeshme, për shembull në rastet kur madhësia e mostrave ndër-sektoriale (cross-sectional) është e vogël. Gjithsesi, duke mos e integruar strukturën panel të të dhënave, ky proces në të shumtën e rasteve shpie në rezultate që nuk janë të qëndrueshme. Mirëpo, pavarësisht të metave të kësaj metode, vlerësuesi Pooled OLS do të aplikohet në këtë studim, si një fillim për analizat empirike, ku rezultatet e tij do të krahason me rezultatet e modeleve tjera.

5.1.2 Modelet Fixed dhe Random Effects

Korniza bazë e modelit të regresionit për të dhëna panel përbëhet nga ekuacioni i mëposhtëm²⁸:

$$Y_{it} = X_{it}\beta + Z_i\pi + \varepsilon_{it}$$

Ku X ka k kolona dhe nuk përfshin konstantë. Heterogjeniteti ose efekti individual ekzaminohet përmes komponentit $Z_i\pi$, ku Z përmban një konstantë dhe një grup të variabla specifikë individuale ose grupe. Dy raste lindin nga kjo:

Fixed Effects (FE): Nëse Z_i është i pa vrojtuar por ka lidhje me X_{it} , atëherë vlerësuesit OLS të β janë të njëanshëm. Megjithatë, në këtë rast $\alpha_i = Z_i\pi$ ngërthen të gjitha efektet e vrojtura dhe paraqet ekuacionin e vlerësuar, në të cilin $\alpha_i = \alpha_1, \dots, \alpha_n$ trajtohen si intercepte (intercepts) të panjohura që duhet vlerësuar, një për secilin vend, si në ekuacionin vijues.

$$Y_{it} = X'_{it}\beta + \alpha_i + \varepsilon_{it}$$

²⁸ Aspekti teorik i këtij hulumtimi bazohet ekskluzivisht në teorinë e modeleve me të dhëna panel të zhvilluar nga William, H. Green (2002), Analiza Ekonometrike, botimi i pestë.

Random Effects (RE): Nëse egziston heterogjenitet individual i pavrojtuar, megjithatë i formuluar, mund të supozohet se është në korelacion me variablat e përfshira, pra në këtë rast modeli mund të formulohet si:

$$Y_{it} = X_{it}\beta + E[Z_{it}] + \{Z_{it} - E[Z_{it}]\} + \varepsilon_{it}$$

$$= X_{it}\beta + \alpha + u_i + \varepsilon_{it}$$

i cili është një model i regresionit linear me çrregullime të përbëra që mund të jetë konzistent, por joefikas i cili vlerësohet me metodën e katrorëve të vegjël (OLS). Qasja e efekteve të rastësishme precizon se u_i është një element grupor specifik i rastit (për të gjitha vendet), i ngjashëm me ε_{it} , përveç atij për secilin grup (vend), ekziston vetëm një barazim që hyn në regresion në mënyrë identike në secilën periudhë.

Pra, dallimi kryesor midis këtyre dy rasteve është nëse efekti individual i pavrojtuar ndërthet elemente që lidhen me regresorët në model, jo nëse këto efekte janë stokastike apo jo. Ne do të shqyrtojmë këtë formulim bazë dhe më pas do të konsiderojmë zgjerimin në një model dinamik.

Testi i specifikimeve i prezantuar nga Hausmann (1978) përdoret për të provuar nëse efektet e rastit janë të pavarura nga variablat në anën e djathtë. Ky është një test i përgjithshëm për të krahasuar dy vlerësuesit. Testi bazohet në hipotezën zero se nuk ka korelacion midis variablave në anën e djathtë dhe efekteve të rastit, dhe se të dy efektet fikse dhe të rastit janë vlerësues të qëndrueshëm, por efektet fikse janë joefektive (ky është supozimi i efekteve të rastit). Ndërsa sipas hipotezës alternative, efektet e rastit supozohet se janë joefektive. Testi bazohet në Wald statistikën e mëposhtme:

$$W = [\beta_{FE} - \beta_{RE}]' \Psi^{-1} [\beta_{FE} - \beta_{RE}], \quad \text{ku}$$

$$Var[\beta_{FE} - \beta_{RE}] = Var[\beta_{FE}] - Var[\beta_{RE}] = \Psi$$

Ku W është me shpërndarje χ^2 dhe $K-1$ shkallë lirie, ndërsa K është numri i parametrave në model. Nëse W është më e madhe se vlera kritike e marrë nga tabela, atëherë ne hedhim poshtë

hipotezën zero se të dy vlerësuesit janë të qëndrueshëm, dmth nuk ka asnjë lidhje midis variablave në të djathtë dhe efekteve të rastit, në këtë rast modeli i efekteve fikse është më efikas.

5.1.3 Modeli me variabla instrumentale

Metodat me variabla instrumentale (IV) njihen gjerësisht si një zgjidhje për endogjenitetin e regresorëve (Wooldrige, 2012). Këto metoda megjithatë mundësojnë të fitohen vlerësime konzistente të parametrave për variablat shpjeguese që në fakt janë të lidhura me termin e gabimit²⁹. Forma e përgjithshme e modelit është si në vijim:

$$Y_{it1} = \alpha_1 Y_{it2} + z_{it1} \delta_1 + c_{i1} + u_{it} \equiv X_{it1} \beta_1 + c_{i1} + u_{it1}$$

ku, $E(u_{it1} | z_{it1}, c_{i1}) = 0$

Efektet fikse (FEIV) të vlerësuesit 2SLS janë të rëndomta. Variablat devijojnë nga koha mesatare për të hequr anëtarin c_{i1} , pastaj aplikohet IV.

Fillimisht vlerësohet ekuacioni vijues:

$$\begin{aligned} \check{Y}_{it} &= \check{X}_{it1} \beta_1 + \check{u}_{it1} \\ \check{z}_{it} &= z_{it} - \bar{z}_i \end{aligned}$$

Si pasojë, është e lehtë të bëhet një inferencë robuste për korrelacionin serial dhe heteroskedasticitetin e $\{u_{it1}\}$ dhe të testohet egzogjeniteti i $\{Y_{it1}\}$. Fillimisht vlerësohet forma e reduktuar me efektet e rëndomta fikse:

$$Y_{it2} = z_{it} \delta_1 + c_{i2} + u_{it2}$$

²⁹ Për më shumë detaje mbi këto modele shihni: Wooldrige, J. (2012). Panel Data Models with Heterogeneity and Endogeneity. Programme Evaluation for Policy Analysis Institute for Fiscal Studies.

Fitohen rezidualet $\hat{u}_{it2} = \hat{y}_{it2} - \hat{z}_{it}\hat{\delta}_1$, dhe pastaj vlerësohet ekuacioni i zgjeruar mëposhtë përmes efekteve fikse duke përdorur testin robust të klasterëve $H_0: \rho_1 = 0$.

$$Y_{it1} = \alpha_1 Y_{it2} + z_{it1} \delta_1 + \rho_1 \hat{u}_{it2} + c_{i1} + error_{it}$$

Ndërsa modeli i *efekteve të rastësishme* (REIV) supozon që c_{i1} është në korelacion me z_i dhe imponon pavarësi serike të komponentit $\{u_{it1}\}$. Thjeshtë testohet hipoteza zero nëse REIV është i mjaftueshëm. Domethënë njëjtë përdoret testi Hausman për të përcaktuar midis modeleve FEIV dhe REIV cili është më i përshtatshëm. Vlerësohet modeli REIV duke përdorur instrumentet $(1, z_{it}, \bar{z}_i)$ si në vazhdim:

$$Y_{it1} = \eta_1 + X_{it1} \beta_1 + \bar{z}_i \xi_1 + c_{i1} + u_{it1}$$

Vlerësuesi i β_1 është vlerësuesi i FEIV. Në fakt testohet $H_0: \xi_1 = 0$ dhe huthja e hipotezës zero domethënë se duhet të përdoret modeli FEIV.

5.1.4 Metoda e përgjithshme e momenteve (GMM)

Metoda e përgjithshme e momenteve (GMM) është një metodë statistikore ekonometrike që kombinon të dhënat e vrojtura ekonomike me informacionin në kushtet e momentit, për të prodhuar vlerësime të parametrave të panjohura brenda një modeli ekonometrik (Hansen, 1982). Metoda kërkon që një numër i caktuar i kushteve të momentit të specifikohen në modelin ekonometrik, këto kushte janë funksione të parametrave të modelit dhe të dhënave, të tilla që pritja e tyre është zero. Metoda GMM pastaj minimizon një normë të caktuar të mesatareve të mostrave të kushteve të momentit.

GMM u zhvillua nga Lars Peter Hansen në vitin 1982 duke e përcaktuar si metodën e “Përgjithshme të Momenteve”, e cila ishte prezantuar për herë të parë nga Karl Pearson në vitin 1894.

Të dhënat e panelit janë të përshtatshme për të shqyrtuar efektet dinamike të paraqitura në modelin e rendit të parë si në vijim:

$$Y_{it} = X'_{it}\beta + \gamma_i Y_{i,t-1} + \alpha_i + \varepsilon_{it}$$

$$w'_{it}\delta + \alpha_i + \varepsilon_{it}$$

ku bashkësia e variablove në të djathtë paraqitet nga w_{it} dhe tani përfshin edhe variablin e varur me një vonesë kohore $Y_{i,t-1}$. Shtimi i komponentit dinamik në model ndryshon interpretimin e ekuacionit. Pa ndryshoren e vonesës kohore, "ndryshoret e pavarura" paraqesin një tërësi informacioni që prodhon një rezultat të vërtetuar të Y_{it} . Ndërsa me ndryshoren e vonesës kohore që kemi tani në ekuacion do të thotë që e gjithë historia e variablove në të djathtë, d.m.th. çdo ndikim i matur kushtëzohet nga kjo histori; në këtë rast, çdo ndikim nga X_{it} është një efekt i informacionit të ri.

Qasja e përgjithshme, e cila është zhvilluar në disa faza në literaturë, mbështetet në vlerësuesit instrumental të variablove, dhe së fundmi në vlerësuesin e GMM (Arellano and Bond, 1991 dhe Arellano and Bover, 1995). Për shembull, pavarësisht nëse janë efekte fikse apo të rastit, heterogjeniteti mund të eliminohet nga modeli duke përdorur ndryshimet e rendit të parë të variablës së varur dhe të pavarur, duke rezultuar në ekuacionin e mëposhtëm:

$$Y_{it} - Y_{i,t-1} = \delta(Y_{it-1} - Y_{i,t-2}) + (X_{it} - X_{i,t-1})'\beta + (\varepsilon_{it} - \varepsilon_{i,t-1})$$

Procedurat e GMM, megjithatë, fitojnë efikasitet duke përfitur nga kufizimet shitesë për momentin. Ata përdorin të gjitha vlerat e mundshme të mbetjeve të variablove të varura plus vlerat e mbetura të regresorëve ekzogjenë si instrumente (Anderson-Hsiao, 1982).

5.1.5 Të dhënat e përdorura në analizën empirike

Në këtë disertacion të doktoratës do të përdoren të dhëna vjetore për periudhën 2000-2019 për pesë vende të Ballkanit Perëndimor, respektivisht për Shqipërinë, Bosnjë dhe Hercegovinën, Republikën e Maqedonisë së Veriut, Malin e Zi dhe Serbinë, ndërsa Kosova nuk përfshihet në

mostër për shkak të padisponueshmërisë së të dhënave para vitit 2007. Shumica e të dhënave u mbledhën nga baza e të dhënave e Bankës Botërore (World Development Indicators), ndërsa të dhënat e kthimit nga kapitali (ROE) dhe kthimit nga asetet (ROA) u siguruan nga Bankat popullore të vendeve të përfshira në analizë. Korniza kohore e analizës është e kufizuar për shkak të mungesës së të dhënave të kredive me probleme dhe indikatorëve të tjerë bankar për dekadën e parë të tranzicionit. Përshkrimi dhe burimi i të dhënave të përdorura në hulumtimin empirik është paraqitur në (Tabelën 17).

Tabela 17. Përshkrimi i të dhënave dhe burimet

Variabla	Shkurtesa	Përshkrimi	Burimi
Rritja ekonomike	GDPCG	Rritja e GDP-së për kokë banori	Banka Botërore
GDP real	RGDPC	GDP për kokë banori me çmime të vitit bazë (2010=100)	Banka Botërore
Inflacioni	INFL	Rritja e nivelit të përgjithshëm të çmimeve në %, deflatori i GDP-së	Banka Botërore
Norma e papunësisë	UNEMP	Papunësia, gjithsej (% e forcës totale të punës) (vlerësimi i modeluar i ILO-së)	Banka Botërore
Kreditë me probleme	NPL	Raporti midis kredive me probleme ndaj kredive totale	Banka Botërore
Kthimi mesatar nga asetet	ROA	Raporti midis të ardhurave neto dhe aseteve totale (mesatare)	Banka Popullore, përkatëse
Kthimi mesatar nga kapitali	ROE	Raporti midis të ardhurave neto dhe mesatares së kapitalit aksionar	Banka Popullore, përkatëse

Norma reale e interesit	INTEREST	Norma e interesit e huasë e rregulluar për inflacionin, matur nga deflatori i GDP-së.	Banka Botërore
Kreditet	KREDIT	Gjithsej kreditë (në % të GDP-së)	Banka Botërore

Pra për të testuar hipotezat e parashtruara janë analizuar të dhëna të indikatorëve kryesorë makroekonomikë për të kapur efektin e mjedisit makroekonomik në stabilitetin e sektorit bankar, me theks të veçantë ndikimin në kreditë me probleme si dhe indikatorë të sektorit bankar si përcaktues të profitabilitetit të sektorit bankar. Nga parametrat makroekonomik janë përdorur rritja ekonomike për kokë banori, GDP real për kokë banori, inflacioni, norma e papunësisë, norma reale e interesit; ndërsa nga indikatorët e sektorit bankar analizohen kreditë me probleme, kreditë totale si dhe kthimi mesatar në asete (angl. Return on Average Asset: ROAA); kthimi mesatar në kapital (angl. Return on Average Equity: ROAE), si dy tregues kryesorë të profitabilitetit.

Statistika deskriptive për të dhënat e lartpërmendura paraqitet në tabelën në vazhdim, nga e cila mund të vërehet se mesatarja e kredive me probleme për vendet e Ballkanit Perëndimor për periudhën 2000-2019 është 12.38% nga totali i kredive.

Tabela 18. Statistika deskriptive e të dhënave

Variabla	Mesatarja	Devijimi standard	Min	Max	Observime
Rritja ekonomike për kokë banori	3.681977	2.7017	-5.996974	9.311124	100
GDP real për	4964.155	1340.247	2244.625	8545.478	100

kokë banori					
Inflacioni	5.981159	12.19092	-2.757553	86.82626	99
Norma e papunësisë	21.08285	7.200758	10.3948	37.2499	98
Kreditë me probleme	12.38435	5.676051	3.018592	23.49278	77
Kthimi mesatar nga asetet	0.904415	0.700649	-1.8	2.2	77
Kthimi mesatar nga kapitali	7.224156	4.988658	-7	16	77
Norma reale e interesit	4.815392	6.676463	-25.67961	17.25647	87
Kreditet	38.46404	16.14219	4.870879	86.44837	97

Burimi: Kalkulime të autorit

5.1.6 Specifikimi i modelit ekonometrik

Specifikimi i modelit ekonometrik me anë të të cilit shqyrtohen faktorët që mund të kenë ndikim në nivelin e kredive me probleme jepet si në vazhdim:

$$\begin{aligned}
 NPL_{it} = & \alpha_0 + \beta_1(NPL)_{it-1} + \beta_2 \log(RGDPC)_{it} + \beta_3(INFL)_{it} \\
 & + \beta_4(UNEMP)_{it} + \beta_5(INTEREST)_{it} + \beta_6(KREDIT)_{it} + \beta_7(ROA)_{it} \\
 & + \beta_8(ROE)_{it} + \lambda_i + \mu_t + \varepsilon_{it}
 \end{aligned}$$

Ku si variabël e varur është paraqitur kreditë me probleme (NPL) dhe si variabla të pavarura janë konsideruar variablat makroekonomike si: kreditë me probleme të vitit paraprak (me një

vonesë kohore, NPL_{t-1}), logaritmi i GDP-së reale për kokë banori (RGDPC), norma e inflacionit (INFL), norma e papunësisë (UNEMP), norma e interesit (INTEREST), ndërsa si variabla të pavarura nga sektori bankar janë shqyrtuar niveli i kredive (KREDIT), kthimi nga asetet (ROA) dhe kthimi nga kapitali (ROE). λ_t paraqet efektin specifik të pavrojtuar të vendeve, μ_t paraqet efektin specifik të pavrojtuar të periudhës kohore dhe ε_{it} paraqet termin e gabimit. Le të diskutojmë të gjitha variablat e përdorura për vlerësimin e modeleve ekonometrike.

Kreditë me probleme: janë hua që janë të papaguara sa i takon kryegjësë dhe interesit gjatë periudhës së paraparë, gjë që është në kundërshtim me termat dhe kushtet e parashikuara në kontratën e huasë. Pra, paraqet huanë që nuk është e azhurnuar për sa i përket pagimit të kryegjësë dhe interesit në kundërshtim me kushtet e marrëveshjes së huasë. Kështu, madhësia e kredive me probleme shfaq cilësinë e aseteve bankare. Në mënyrë që të testojmë perzistencën e kredive me probleme, përdorim normën e kredive me probleme të vitit paraprak (NPL_{t-1}) si një variabël të pavarur dhe presim një korrelacion pozitiv me variablën e varur.

Rritja e GDP-së: kur rritja reale e GDP-së përkeqësohet gjatë periudhave recesioniste, gjasat që më shumë huamarrës të mos paguajnë borxhin mund të jenë relativisht të larta sepse rritja e ngadaltë e GDP-së shpesh shoqërohet me pritje më të ulëta të fitimeve, pra aftësi e ulët për të gjeneruar flukse të parave për të përmbushur detyrimet ndaj borxhit. Në të kundërt, ka më pak mospagesa të pritura gjatë periudhave ekspansioniste. Pra shenja e pritur për këtë variabël është negative.

Inflacioni: presione të larta inflacioniste rezultojnë në kosto më të larta prodhimi, duke ndikuar kështu në rrjedhën e parave. Për shkak të kësaj tendence, duke pasur fluks më të mirë parash, barra e borxhit e huamarrësve do të zvogëlohet dhe më pas, mund të argumentohet se rritja e inflacionit çon në një ulje të cilësisë së aseteve dhe anasjelltas. Megjithatë, ka rezultate të paqarta në lidhje me marrëdhëniet midis kredive me probleme dhe nivelit të inflacionit. Sipas Farhan et al. (2012), Skarica (2013), Klein (2013) dhe Tomak (2013) egziston një lidhje pozitive midis kredive me probleme dhe nivelit të inflacionit. Derisa, sipas Nkusu (2011) ndikimi i inflacionit në cilësinë e kredisë mund të jetë pozitiv por mund të jetë edhe negativ.

Norma e papunësisë: rritja e normës së papunësisë ndikon në rritjen e nivelit të kredive me probleme. Kur korporatat reduktojnë numrin e të punësuarve për shkak të uljes së kostove, prodhimi zvogëlohet dhe fitimi poashtu, duke krijuar vështirësi që korporatat të paguajnë detyrimet e tyre të borxhit. Pra pritet lidhshmëri pozitive midis normës së papunësisë dhe kredive me probleme. Makri et al. (2014) gjetën korelacion pozitiv midis këtyre dy variablave.

Norma e interesit: paraqet një nga determinanat kryesore të kredive me probleme. Norma e interesit është çmimi që huamarrësi paguan për përdorimin e parave të marra hua nga huadhënësit. Me fjalë tjera, interesi mund të mendohet edhe si 'renta' e parave. Sa i takon shenjës së pritur të këtij variabli, ka evidenca empirike që tregojnë një lidhje pozitive, por ka të tjera që gjejnë lidhshmëri negative midis normës së interesit dhe kredive me probleme. Për shembull, Saba et al. (2012) gjetën lidhje negative midis normës së interesit dhe kredive me probleme ndërsa Farhan et al. (2012) dhe Ranjan dhe Chandra (2003) gjetën se ekziston një lidhje pozitive. Domethënë, rritja e normës së interesit zvogëlon kapacitetin pagues të huamarrësve, që rezulton me rritje të kredive me probleme. Pra, pritet shenjë pozitive.

Profitabiliteti i bankave mund të reflektojë sjelljen ndaj marrjes së rrisht nga ana e menaxhmentit të bankave. Bankat me profitabilitet më të lartë janë më pak të 'stresuara' për krijimin e të ardhurave dhe kështu më pak të detyruara të ofrojnë kredi me rrezik të lartë. Ndërsa, bankat joefikase ka më shumë të ngjarë të përjetojnë nivel të lartë të kredive me probleme meqenëse ata janë të detyruar të japin dhe të angazhohen në kredi më të pasigurta për të mbrojtur profitabilitetin e tyre dhe të përmbushin rregullat e kujdesshme të vendosura nga autoritetet monetare (Boudriga et al. 2009). Le të analizojmë dy indikatorët esencial të profitabilitetit, kthimin nga asetet dhe kthimin nga kapitali.

Kthimi nga asetet (ROA): përfaqëson efikasitetin në përdorimin e pasurisë dhe tregon sa neto të ardhura krijohen nga pasuritë. Kjo tregon aftësinë e menaxhmentit të bankës për të gjeneruar fitime duke shfrytëzuar pasuritë e disponueshme të bankës. Kështu, nëse raporti i ROA është i lartë, kjo tregon se banka ka performancë të mirë për të gjeneruar fitime. Përfitimi i fortë bankar i matur në terma të ROA mund të rezultojë nga norma e lartë e huazimit, tarifat dhe komisionet që çojnë rritjen e bankës në madhësi dhe profitabilitet. Kështu, ROA jep një pasqyrë

se sa efikas është menaxhmenti në përdorimin e aseteve të tij për të gjeneruar fitime. Studiues të ndryshëm gjetën rezultate të ndryshme në lidhje me marrëdhëniet midis ROA dhe kredive me probleme. Për shembull: Makri et al. (2014), shqyrtuan lidhjen midis ROA dhe kredive me probleme dhe gjetën një lidhshmëri pozitive, derisa, Boudriga et al. (2009) dhe Selma dhe Jouini (2013) gjetën një lidhje negative duke mbështetur argumentin se përkeqësimi i raportit të profitabilitetit të matur në terma të ROA çon në aktivitete më të rrezikshme të bankave dhe më pas ngritin nivelin e kredive me probleme. Ata e justifikuan këtë me faktin meqë ROA mat efikasitetin në shfrytëzimin e aseteve, shfrytëzimi i dobët i aseteve shpie në kredi me probleme më të larta për bankat. Rrjedhimisht shenja e pritur është negative.

Kthimi nga kapitali (ROE): paraqet shumën e të ardhurave neto të kthyer si përqindje e kapitalit aksionar. Kthimi nga kapitali mat përfitimin duke zbuluar se sa fitim mund të gjenerojë një bankë me paratë që aksionarët kanë investuar. Studiues të ndryshëm gjetën rezultate të ndryshme midis kredive me probleme dhe profitabilitetit të bankës të matur në terma të ROE. Makri et al. (2014) gjetën lidhje negative midis ROE dhe kredive me probleme. Prandaj, pritet të ketë marrëdhënie negative midis tyre.

Niveli i kredive: rritja e nivelit të kredive si përqindje e GDP-së ka gjasa të rrisi nivelin e kredive me probleme, prandaj shenja e pritur për këtë variabël është pozitive, megjithatë duhet patur parasysh periudhat ekspansioniste dhe recesioniste të ekonomisë, në kuptim të asaj se në periudha me rritje të lartë ekonomike edhe përkundër rritjes së nivelit të përgjithshëm të kredive si rezultat i rritjes së aktivitetit ekonomik, kreditë me probleme mund të ngelen konstante ose edhe të zvogëlohen, sepse rritja ekonomike ndikon në rritjen e të ardhurave dhe kjo mund të rezultojë në rritjen e solventitetit të firmave.

Në pjesën paraprake kemi përshkruar të gjitha qasjet ekonometrike të cilat përdoren gjatë analizës empirike përmes të cilave testohen hipotezat kërkimore në vijim:

HIPOTEZA 1 H_0 : Rritja e GDP-së nuk ka ndikim në nivelin e kredive me probleme.

H_a : Rritja e GDP-së ka ndikim në nivelin e kredive me probleme.

HIPOTEZA 2 H_0 : Norma e inflacionit nuk ka ndikim në nivelin e kredive me probleme.

H_a : Norma e inflacionit ka ndikim në nivelin e kredive me probleme.

HIPOTEZA 3 H_0 : Norma e papunësisë nuk ka ndikim në nivelin e kredive me probleme.

H_a : Norma e papunësisë ka ndikim në nivelin e kredive me probleme.

HIPOTEZA 4 H_0 : Norma e interesit nuk ka ndikim në nivelin e kredive me probleme.

H_a : Norma e interesit ka ndikim në nivelin e kredive me probleme.

HIPOTEZA 5 H_0 : Rritja e nivelit të kredisë nuk ka ndikim në nivelin e kredive me probleme.

H_a : Rritja e nivelit të kredisë ka ndikim në nivelin e kredive me probleme.

HIPOTEZA 6: H_0 : Treguesi ROA nuk ka ndikim në nivelin e kredive me probleme.

H_a : Treguesi ROA ka ndikim në nivelin e kredive me probleme.

HIPOTEZA 7: H_0 : Treguesi ROE nuk ka ndikim në nivelin e kredive me probleme.


H_a : Treguesi ROE ka ndikim në nivelin e kredive me probleme.

5.2. REZULTATET EMPIRIKE

Në këtë kapitull të disertacionit të doktoratës do të paraqesim rezultatet empirike të prodhuara nëpërmjet disa qasjeve ekonometrike të tilla si Pooled OLS, Fixed Effects, Random Effects, 2SLS, si dhe GMM. Arsyeja e përdorimit të më tepër modeleve ekonometrike është bërë me qëllim të krahasimit të rezultateve empirike dhe pasqyrimin sa më të përafërt të ndikimit të faktorëve makroekonomikë dhe bankar në kreditë me probleme. Shumë studiues kanë shqyrtuar faktorët që ndikojnë në kreditë me probleme, mirëpo ka mungesë të punimeve shkencore për këtë temë në kontekst të vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Po të analizojmë mesataren e trendit të kredive me probleme për vendet e Ballkanit Perëndimor, shihet qartë një tendencë uljeje në vitet e fundit, sidomos pas vitit 2013 (shih Figurën 4). Kjo rënie e ndjeshme e kredive me probleme mund të nënkuptojë përmirësim të cilësisë së kredive për këto vende.


Figura 4. Mesatarja e kredive me probleme ndër vite për periudhën 2000-2019



Burimi: Kalkulime të autorit

Ndërsa, nëse krahasojmë mesataret e kredive me probleme midis vendeve për periudhën 2000-2019, mund të vërehet se Maqedonia e Veriut ka nivelin më të ulët, pasuar nga Bosnjë dhe Hercegovina, ndërsa nivelin më të lartë ka Shqipëria pastaj Serbia (shih Figurën 5).

Figura 5. Mesatarja e kredive me probleme për vendet për periudhën 2000-2019




Burimi: Kalkulime të autorit

5.2.1 Lidhja midis kredive me probleme dhe rritjes së GDP-së reale

Rezultatet nga paraqitja grafike të lidhshmërisë midis kredive me probleme dhe rritjes reale të GDP-së, sipas metodës së katrorëve më të vegjël (OLS), sugjerojnë se egziston lidhje negative dhe statistikisht e rëndësishme në nivelin e rëndësisë statistikore prej 1% (shih Figurën 6). Pra, rritja e GDP-së reale ndikon në uljen e kredive me probleme, ashtu siç edhe pritej. Ky rezultat tregon një varësi të fortë të aftësisë së klientëve për të shlyer detyrimet ndaj kredive dhe gjendjes së ekonomisë. Kështu një përmirësim i gjendjes së ekonomisë ka të ngjarë të ndikojë në një ulje të menjëhershme të portofoleve të kredive me probleme në vendet e Ballkanit Perëndimor.

Figura 6. Lidhja midis kredive me probleme dhe rritjes së GDP real.



Burimi: Kalkulime të autorit

5.2 Rezultatet empirike nga regresionet

Rezultatet empirike të modeleve të regresionit të vlerësuara sipas metodave të ndryshme prezentohen në tabelën e mëposhtme ku si variabël e varur është paraqitur kreditë me probleme (NPL) dhe si variabla të pavarura janë konsideruar variablat makroekonomike si: kreditë me probleme të vitit paraprak (me një vonesë kohore NPL_{t-1}), logaritmi i GDP-së reale për kokë

banori (RGDPC), norma e inflacionit (INFL), norma e papunësisë (UNEMP), norma e interesit (INTEREST), ndërsa si variabla të pavarura nga sektori bankar janë shqyrtuar niveli i kredive (KREDIT), kthimi nga asetet (ROA) dhe kthimi nga kapitali (ROE).

Në bazë të rezultateve të fituara, variabla e kredive me probleme me një vonesë kohore (vitit paraprak) në të gjithë modelet rezultojnë me shenjë pozitive dhe statistikisht e rëndësishme. Gjetje të ngjajshme u evidentuan në studimet e Jimenez dhe Saurina (2006); Misra dhe Dhal (2010), duke nxjerr në pah perzistencën (vazhdueshmërinë) e kredive me probleme në vendet e Ballkanit Perëndimor.

Koeficienti i rritjes reale të GDP-së, sikur edhe më parë, është gjetur të jetë me shenjë negative dhe statistikisht i rëndësishëm në të gjitha modelet, përveç në modelin e efekteve fikse që është me shenjë negative, por statistikisht jo i rëndësishëm (shih Tabelën 19). Mirëpo në këtë punim kryesisht do të konsiderohen si më të besueshme rezultatet e fituara nga vlerësuesi GMM, prandaj dhe interpretimi i rezultateve do të bazohet në të. Për më tepër mund të vërejmë se testi Sargan bën të mundur identifikimin e kufizimeve në prani të heteroskedasticitetit me p-vlerën e shoqëruar e cila shqyrton vlefshmërinë e variablave instrumentale që janë pranuar si instrumente të shëndetshme për të gjitha qasjet ekonometrike të vlerësuara. Prandaj, rezultatet nga vlerësuesi i GMM vërtetojnë hipotezën se variablat instrumentale nuk lidhen me grupin e mbetjeve. Si rezultat, testet Arellano - Bond testi AR (1) dhe testi AR (2) me vlera të shoqëruara refuzohen në rendin e parë, mirëpo pranohen në rendin e dytë ku dhe konfirmohet që nuk ka auto korrelacion në rendin e dytë ndërmjet termit të gabimeve. Si rezultat i gjithë kësaj hulumtim poshtë hipotezën zero dhe konfirmojmë atë alternative se rritja e GDP-së ka ndikim në kreditë me probleme. Kjo variabël nxjerr në pah efektin e ciklit të biznesit në cilësinë e kredive. Rezultate të ngjajshme arrihen edhe nga ana e Rinaldi and Sanchis-Arellano (2006).

Lidhja midis inflacionit dhe kredive me probleme është gjetur të jetë pozitive dhe statistikisht e rëndësishme në nivelin e rëndësisë prej 5%, që domethënë se rritja e inflacionit rrit nivelin e kredive me probleme. Pra, nën kushte tjera të pandryshuara nëse norma e inflacionit rritet për një njësi, kreditë me probleme do të rriten për 0.5 njësi, sipas vlerësuesit GMM. Rezultatete të ngjajshme janë evidentuar edhe nga autorë si, Farhan et al. (2012), Skarica (2013), Klein (2013)

dhe Tomak (2013), për dallim të disa autorëve tjerë që kanë evidentuar lidhje negative. Sidoqoftë, ky rezultat konfirmon Hipotezën 2 se norma e inflacionit ka ndikim në nivelin e kredive me probleme në vendet e Ballkanit Perëndimor.

Për dallim nga studimet tjera koeficienti i papunësisë në të gjitha modelet rezulton me shenjë negative dhe statistikisht i rëndësishëm që është në kundërshtim me pritjet tona. Rritja e normës së papunësisë në fakt duhet që të rrisi nivelin e kredive me probleme dhe jo të zvogëlojë atë. Në bazë të literaturës së shtjelluar në këtë disertacion, pothuajse të gjithë autorët gjejnë lidhje pozitive midis këtyre dy variablave. Pra mund të konfirmohet Hipoteza 3 se norma e papunësisë ka ndikim në nivelin e kredive me probleme, mirëpo lidhja e tyre është e paqartë. Një situatë e tillë mund të jetë karakteristike për këtë rajon pasi që në periudha të caktuara, norma e papunësisë nuk ka lëvizur në proporcion me ciklet e biznesit, sidomos në rastin e Maqedonisë së Veriut dhe Bosnjë dhe Hercegovinës.

Norma e interesit është në lidhshmëri pozitive dhe statistikisht të rëndësishme me nivelin e kredive me probleme, me signifikançë në nivelin prej 5%. Pra rritja e normës së interesit rrit kreditë me probleme në këtë rajon, me çka konfirmohet Hipoteza 4. Rezultate të ngjajshme kanë arritur edhe autorë si Ranjan and Chandra (2003) and Farhan et al. (2012), Louzis et al. (2010), Sakiru et al. (2011), Tomak (2012), Konfi (2012), and Daniel and Wandera (2013).

Rritja e nivelit të përgjithshëm të kredive rrit kredit me probleme, pasi që koeficienti i kësaj variable është me shenjë positive, mirëpo statistikisht i rëndësishëm vetëm në modelet Pooled OLS, Fixed Effects dhe Random Effects, ndërsa jo në modelin 2 SLS dhe GMM. Sipas modelit të efekteve fikse koeficienti është statistikisht i rëndësishëm në nivelin prej 1%, duke konfirmuar Hipotezën 5 se rritja e nivelit të kredisë ka ndikim në nivelin e kredive me probleme.

Treguesi i kthimit nga asetet (ROA) është negativisht i lidhur me kreditë me probleme, mirëpo koeficienti i kësaj variable rezulton statistikisht jo i rëndësishëm në të gjitha modelet të vlerësuara sipas metodave të ndryshme. Arsyeja kryesore e mos ndikimit të ROA në nivelet e kredive me probleme vjen si rezultat i joefikasitetit të menaxhmentit të bankave në përdorimin e aseteve dhe gjithashtu cilësi më e dobët e kredive. Kështu, rezultati nënkupton që bankat janë më pak stimuluese për kthimin e fituar nga asetet dhe gjithashtu për të siguruar kredi.

Rrjedhimisht hudhet poshtë Hipoteza 6 se kthimi nga asetet (ROA) ka ndikim në nivelin e kredive me probleme në vendet e Ballkanit Perëndimor.

Koeficienti i kthimit nga kapitali (ROE) është me shenjë negative ashtu siç edhe pritej, mirëpo në nivelin e rëndësisë statistikore prej 10%, pothuajse në të gjitha modelet përveç modelit 2SLS. Ky rezultat, siç pritej, tregon se një përkeqësim i raportit të kthimit nga kapitali çon në një rritje të kredive me probleme, duke konfirmuar paraqitjen e rrezikut të bankave. Kjo marrëdhënie negative është gjithashtu në përputhje me argumentin se menaxhimi i keq çon në aktivitete më të rrezikshme dhe performancë më të dobët. Studimet e Boudriga, Taktak dhe Jellouli (2009a), Cotugno, Stefanelli dhe Torluccio (2010), Louzis, Vouldis dhe Metaxas (2010) që u përqëndruan në banka individuale, gjithashtu kanë identifikuar një korrelacion të rëndësishëm negativ midis kredive me probleme dhe treguesit të kthimit nga kapitali. Rezultati poashtu tregon ekzistencën e një menaxhimi relativisht të mirë të fondeve të investuara nga aksionarët përmes marrëdhënieve të mira të agjencisë me bankat. Hipoteza 7 mund të konfirmohet, megjithëse signifkna statistikore është 10%.

Tabela 19. Rezultatet e regresioneve të ndryshme

Variablat	Pooled OLS Model (1)	Fixed Effects Model (2)	Random Effects Model (3)	2SLS Model (4)	IV GMM Model (5)
<i>NPL_{it-1}</i>	0.8553429 (0.000)***	0.7036833 (0.000)***	0.8553429 (0.000)***	0.8443217 (0.000)***	0.7074933 (0.001)***
<i>Log (RGDPC)</i>	-8.304137 (0.017)**	-10.16757 (0.109)	-8.304137 (0.013)**	-7.814334 (0.115)	-7.97334 (0.046)**

INFL	0.5650788 (0.007)***	0.119594 (0.677)	0.5650788 (0.005)***	0.5708289 (0.035)**	0.5241878 (0.023)**
UNEMP	-0.2920692 (0.000)***	-0.136527 (0.342)	-0.2920692 (0.000)***	-0.289915 (0.030)**	-0.1859058 (0.009)***
INTEREST	0.4930328 (0.004)***	0.336919 (0.211)	0.4930328 (0.002)***	0.521399 (0.022)**	0.50549 (0.024)**
KREDIT	0.1418154 (0.019)	0.3315768 (0.000)***	0.1418154 (0.015)**	0.124655 (0.255)	0.0645855 (0.423)
ROA	-0.0906998 (0.955)	1.528344 (0.335)	-0.0906998 (0.955)	-0.2747157 (0.892)	-2.119187 (0.212)
ROE	-0.3039992 (0.105)*	-0.3790118 (0.069)*	-0.3039992 (0.100)*	-0.2874115 (0.298)	-0.03039992 (0.074)*
Constant	71.18519 (0.014)	77.84618 (0.167)	71.18519 (0.010)*	67.76654 (0.094)*	2.308499 (0.652)
N	76	76	76	76	71
Arellano - Bond test for AR (1)	-	-	-	-	-1.76
Arellano - Bond test for AR (2)	-	-	-	-	-2.62

Shënim: Vlerat në kllapa paraqesin p-vlerat. Ndërsa simbolet *, **, dhe *** paraqesin rëndësinë statistikore prej 10%, 5% dhe 1%, përkatësisht.

Burimi: Kalkulime të autorit

5.2.3 Testi Hausman, testi i homogjenitetit, Breusch-Pagan dhe Arellano-Bond

Testi Hausman është testi i duhur që përdoret për të vendosur nëse modeli i efekteve fikse (Fixed Effects) apo të rastësishme (Random Effects) është më i përshtatshëm. Kështu, testi Hausman identifikon nëse modeli i efekteve fikse apo efekteve të rastësishme është më i përshtatshmi nën hipotezën zero se efektet individuale të pa vëzhgueshme (u_i) nuk janë të lidhura me një ose më tepër variabla shpjeguese (X_i). Sipas Gujaratit (2004) modeli i efekteve fikse është më i përshtatshëm kur hipoteza zero refuzohet ndërsa modeli i efekteve të rastësishme është më i përshtatshëm kur nuk mund të hudhet poshtë hipoteza zero. Pra, bazuar në rezultatet tona të testit të Hausmanit të përzgjedhjes midis modelit të efekteve fikse (Fixed Effects) apo modelit të efekteve të rastësishme (Random Effects), hudhja poshtë e hipotezës zero sugjeron modelin e efekteve fikse si më të përshtatshëm për këtë analizë (shih në Apendiks).

Gjithashtu u performua edhe testi i homogjenitetit (slope homogeneity) për të analizuar nëse koeficientët e vlerësuar nga regresioni i efekteve fikse për vendet e kryqëzuara janë homogjenë apo heterogjenë. Hipoteza zero sugjeron se koeficientët kanë pjerrësi homogjene, mirëpo në studimin tonë hudhet poshtë hipoteza zero dhe pranohet ajo alternative, që domethënë se koeficientët kanë pjerrësi heterogjene midis vendeve (shih në Apendiks testin).

Poashtu në testimin e modeleve statike u përdor testi Breusch-Pagan që teston pavarësinë apo nëse rezidualet midis vendeve të kryqëzuara janë të korreluara apo jo. Mos refuzimi i hipotezës zero sugjeron se rezidualet nuk janë të korreluara. Në rastin tonë p-vlera është 0.3 që tregon se nuk mund të refuzojmë hipotezën zero. Rrjedhimisht, rezidualet midis vendeve të kryqëzuara nuk janë të korreluara.

Testet Arellano - Bond janë testi AR (1) testi AR (2) me vlera të shoqëruara që refuzohen në rendin e parë, mirëpo pranohen në rendin e dytë ku dhe konfirmohet që nuk ka auto korrelacion në rendin e dytë ndërmjet termeve të gabimeve të modeli GMM (Shih në apendiks).

5.2.4 Limitimet e hulumtimit

Në këtë studim është bërë përpjekje që të identifikohen faktorët që ndikojnë në nivelin e kredive me probleme në vendet e Ballkanit Perëndimor, por megjithatë duhet patur parasysh që mostra e këtij studimi është relativisht e vogël dhe duhet patur një dozë rezerve dhe kujdesi të caktuar gjatë interpretimit të rezultateve. Një mostër më e madhe për një periudhë më të gjatë kohore do të përmbledhte më mirë marrëdhëniet midis variablave të shqyrtuara. Mirëpo disponueshmëria e të dhënave dhe mungesa e tyre për vite të caktuara, sidomos për Malin e Zi dhe Serbinë kufizojnë analizën tonë. Pra, modelet e vlerësuara janë në gjendje të shpjegojnë deri në një farë mase lidhjen e faktorëve makroekonomikë dhe bankarë me nivelin e kredive me probleme mirëpo analizë më gjithëpërfshirëse do të sigurohej nëse rrisim mostrën e vendeve më gjerë se vetëm Ballkani Perëndimor.

KAPITULLI VI.

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Sistemi financiar përfaqësohet më së shumti nga sistemi bankar si ndërmjetësi financiar më kryesor në një vend. Sistemin bankar është pjesë e sistemit të përgjithshëm ekonomik, e njëherit segmenti më i rëndësishëm i zhvillimit ekonomik të vendit ngase ky i fundit është njëherit edhe pasqyrë e zhvillimit të sistemit financiar. Duke paturë parasyshë këtë, sistemi bankar është sektori më i rëndësishëm i sistemit financiar në vendet e Ballkanit Perëndimor, sistemi bankar në rajonin e Ballkanit Perëndimor është i organizuar në dy nivele: Banka Qëndrore dhe Bankat Tregtare. Bankat janë institucione financiare, që luajnë rolin e ndërmjetësit në ekonomi nëpërmjet kanalizimit të burimeve financiare nga njësitë ekonomike suficitare drejt atyre deficitare.

Vendet e Ballkanit, konsiderohen “bank based system” (sistem bazuar në banka), ku bankat luajnë një rol të rëndësishëm në tregun financiar dhe të cilat zënë pjesën më të madhe të vëllimit të veprimtarisë së tregut financiar. Liçencimi, funksionimi, mbikëqyrja e bankave të nivelit të dytë është e rregulluar me ligj të veçantë, i cili në thelb është i ndërtuar mbi parime të ngjashme, por sigurisht që ka edhe dallime, për shkak të specifikave që kanë vendet që kemi marrë në studim. Ecuria e treguesve kryesorë siç janë: totali i aktiveve, kredive dhe depozitave në nivelë të sistemit të bankave që operojnë në këto vende është i ndryshëm nvarësisht nga vendi dhe faktorevë tjere që kanë ndikuar që këto tregues herë të shënojnë rritje herë ulje.

Në Maqedoni aktivet e sektorit bankar, në fund të vitit 2018 ishin rreth 504 milion denar, duke pësuar në këtë mënyrë një rritje vjetore 9 % nga viti 2017 në vitin 2018, ndërkohë që rritja në vitin 2017 ishte 3.89%. Kreditimi i subjekteve jofinanciare , shihet se ka një trend rritje pas vitit 2010, por pikun e rritjes e ka në vitin 2012, me 34 milion denarë ose 20%, ndjekur në vitet në vazhdim me një rritje të lehtë, në përqindje rritja në vitin 2018 është vetëm 7.6% krahasuar

me 5.9% në vitin 2017. Rritja e kredive është më shumë e dukshme në sektorin e individëve krahasuar me kredinë ndaj bizneseve, ku kjo e fundit është rritur me ritme më të ngadalëta. Duhet vënë në dukje që në Maqedoni mbizotëron kreditimi në monedhën vendase e cila ka pësuar një rritje nga 41.50% (2009) në 73.5% (2018). Përsa i takon afatit të kredive, mbizotërojnë kreditë afatgjata të cilat kanë thuhet një stabilitet, nga 68.85% (2011) në 73.39% (2018). Në lidhje me depozitat, ato vlerësohen rreth 371 milion denarë në fund të vitit 2018 me një rritje 9.4 % krahasuar me vitin 2017. Trendi i depozitave ka qenë rritës, edhe pse ritmi i rritjes së tyre ka qenë në rënie, me përjashtim të viti 2014 dhe të vitit 2018. Rënia e ritmit të rritjes së depozitave i dedikohet kryesisht zhvillimeve politike brenda vendit si dhe zhvillimet me shtetit fshinjë. Pavarësisht kësaj, depozitat mbeten burimi kryesor i fondeve, ato përbëjnë 73.75% të totalit të aktiveve. Individët mbeten kontribuesit kryesor (69.22% të totalit të depozitave), edhe pse norma e rritjes së tyre vjetore në vitin 2016 është më e vogla në dekadën fundit. Mbizotërojnë depozitat në monedhën vendase të cilat përbëjnë rreth 57.50% të totalit.

Në Shqipëri gjatë periudhës së analizuar, aktivet e sektorit bankar janë zgjeruar me 1.9%, dhe struktura e bilancit nuk ka shfaqur ndryshime të rëndësishme. Ndërsa rritja e aktiveve në sektorin bankar në Serbi ka qenë e vazhdueshme dhe e qëndrueshme që nga viti 2010 deri në vitin 2018 me përjashtim të vitit 2013 ku vihet re një rënie e këtij treguesi. Totali i aktiveve në sistemin bankar në Malin e Zi ka pësuar një rënie të vazhdueshme që nga viti 2010 deri në vitin 2012. Vetëm pas vitit 2013, ka filluar të paraqesë një prirje pozitive e cila ka vazhduar edhe në vitin pasardhës. Kjo rënie vjen si rezultat i rënies së vazhdueshme të kredive, duke qenë se kreditë zënë peshën më të madhe në aktivet e sistemit bankar. Trendi rritës të aktiveve ka patur edhe në Bosnje dhe Hercegovinë për periudhën e analizuar.

Rritja e kreditimit filloi të rimëkëmbet, e nxitur kryesisht nga kreditë për individë. Pas nivelit të ulët në vitin 2016, kreditimi në Mal të Zi u rrit me më shumë se 6 përqind në Qershor 2017, për shkak të përmirësimit të treguesve të besimit dhe rritjes së qëndrueshme të depozitave, të cilat përbëjnë burimin kryesor të financimit për bankat vendase. Poashtu në vitin 2018 në Malin e Zi, rritja e shpejtë e kredisë për sektorin privat tejkaloi 9 përqind, pasi cilësia e aktiveve

vazhdoi të përmirësohej dhe depozitat, një burim kryesor i financimit për bankat vendase, u rritën ndjeshëm. Pas një periudhe me pasiguri politike në Bosnjë-Herzegovinë, Serbi dhe IRJ të Maqedonisë, kredia për ekonominë vijoi të rritet me ritme të qëndrueshme, midis 4 dhe 6 përqind, në vitin 2018 shkon në 7 përqind. Megjithëse të dhënat për Shqipërinë flasin për një rënie të kreditimit, duke marrë parasysh fshirjen e një numri të konsiderueshëm të kredive me probleme, ecuria e kredive të reja ishte pozitive dhe nxiti rritjen ekonomike. Rritja e kreditimit është nxitur kryesisht nga kreditë për individët; kreditë për bizneset kanë pasur trende të ndryshme, pjesërisht për shkak të rritjes së vogël të kredive të reja dhe fshirjes së kredive me probleme (KJPve). Pavarësisht progresit të përgjithshëm në zgjerimin e tregut të kredive në të gjithë Ballkanin Perëndimor, kredia e brendshme për sektorin privat vazhdon të mbetet shumë prapa niveleve të Bashkimit Evropian.

Rritja e huadhënies në monedhë vendase ndihmoi në menaxhimin e rreziqeve lidhur me valutën në portofolet e sektorit privat. Bankat qendrore në Shqipëri, IRJ të Maqedonisë dhe Serbi kanë paraqitur masa që synojnë të de-euroizojnë bilancet si dhe kanë rritur normën e rezervave të detyruara për depozitat në valutë të huaj dhe koeficientin e riskut për huamarrësit e pambrojtur. Progresi në këtë drejtim ka qenë i ngadaltë; stoku i kredive në valutë të huaj është ende i lartë dhe varion nga rreth 45 përqind e totalit të kredive në IRJ të Maqedonisë në rreth 70 përqind në Serbi. Në Shqipëri, niveli i huadhënies në valutë të huaj ka pësuar rënie të lehtë nga 60 për qind në 2016 në 57 përqind në 2017 dhe në vitin 2018 në 50%; gjithashtu Serbia kishte rënie nga 70.2 në 67.7 përqind, në vitin 2018 në 60%.

Lidhur me përkufizimin e asaj se çka paraqet kredive me probleme, duhet të theksohet se jo të gjitha vendet përdorin të njëjtin përkufizim, ku diferencat mund të gjenden edhe brenda një vendi, dhe kanë të bëjnë me sektorë të veçantë. Por, megjithatë, tendenca e përgjithshme në vende është të zbatojnë rregullin 90-ditor. Ndërkombëtarisht, sipas udhëzuesit të FMN-së “të shëndetit” të tregueseve financiarë, një kredi është jofunksionale në qoftë se detyrimet në bazë të interesit dhe pagesat e principalit janë të papaguar 90 ditë ose më shumë se 90 ditë, apo kur pagesat e interesit janë kapitalizuar, refinancuara ose vonuar sipas kontratës së paktën 90 ditë, ose

kur pagesat janë vonuar më pak se 90 ditë, por ka arsye të tjera të mira për të dyshuar se nuk do të jetë plotësisht e paguar.

Huate me probleme kane qene nje shqetesim per sistemin bankar vitet e fundit. Niveli i larte i kredive te pakthyer ne vendet e Ballaknit Perëndimor përbën riskun kryesor për sistemin financiar dhe ekonomine në përgjithesi. Shfaqja dhe dinamika e kredive me probleme dhe administrimi i tyre varen nga një numër i faktorëve dhe rrethanave, ndikimi i të cilave është kompleks dhe shumëdimensional siç janë:

1. Faktorët ekonomikë. Këto janë faktorë makroekonomikë dhe / ose mikroekonomikë që në vetvete nuk mund të zvogëlojnë nivelin e kredive me probleme tek bankat, por pa to është pothuajse e pamundur të zbatohet ndonjë veprimtari për të zvogëluar vëllimin e kredive me probleme për të dhënë rezultate të rëndësishme.
2. Faktorët që lidhen me mosfunksionimin dhe efikasitetin e sistemit juridik. Ekzistenca e një sistemi juridik efikas, të lartësuar nga respektimi i sundimit të së drejtës, është një faktor jashtëzakonisht i rëndësishëm që ndikon në mjedisin e biznesit dhe madhësinë e burimeve që subjektet ekonomike duhet të angazhojnë për mbrojtje juridike, zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe / ose ekzekutimin e vendimeve.
3. Faktorët që lidhen me rregullimin e veprimtarisë së bankave dhe ecurinë e procesit mbikëqyrës: i referohet rregullave të ndryshme rregullatore për bankat, kryesisht në lidhje me procesin e administrimit të rrezikut, dhe veçanërisht me rrezikun e kredisë, politikat e kontabilitetit, përputhjen me kërkesat e zbulimit të informacioneve, teknikat për vlerësimin e kolateralit për ekspozimet, trajtimin e ristrukturimit të kërkesave, nevojën për të respektuar rregulloret për mbrojtjen e të drejtave të huamarrësve, sekretin bankar ose mbrojtjen e të dhënave personale në rastet kur pretendimet transferohen te një person të tretë etj.
4. Faktorët që lidhen me zhvillimin dhe funksionimin e tregut të kredive me probleme. Ky grup mund të përfshijë të gjithë faktorët që kufizojnë drejtpërdrejtë ose indirekt

zhvillimin dhe funksionalitetin e tregut sekondar me të arkëtueshme, kryesisht me kredi me probleme.

5. Faktorët që lidhen me aftësinë e brendshme të bankave për të menaxhuar kredi me probleme. Këta faktorë nuk lidhen vetëm me procesin e menaxhimit të kredisë me probleme, por gjithashtu kanë një shtrirje më të gjerë dhe lidhen me fazat e tjera të ciklit jetësor të ekspozimeve para se të fitojnë statusin jo-performues.

Kreditë me probleme rëndojnë bilancet e bankave, dobësojnë fitimet dhe gërryejnë kapitalin e bankave. Kreditë me probleme të larta e bëjnë më të vështirë për bankat që të përdorin kanalin e kredisë për të mbështetur rritjen ekonomike. Megjithëse në vendet që janë marrë për hulumtim kreditë me probleme po reduktohen, ato janë ende të larta. Një arsye e mundshme që Republika e Maqedonisë së Veriutë i ka NPL-të poshtë nivelit të para-krizës, është se ato kanë qenë më pak të hapura ndaj tregjeve ndërkombëtare para krizës, dhe rrjedhimisht kanë më pak nevojë për reforma.

Poashtu si arsye pse pjesa e kredive me probleme nuk ka treguar rritje të fortë si në shumicën e vendeve në mjedisin e afërt, mund të renditen:

- Konservatorizëm më i madh i bankave në tregun e kredive, pjesërisht për shkak të standardeve më të rrepta mbikëqyrëse për njohjen dhe çregjistrimin e kredive me probleme të bankave në periudhën nga viti 2008 deri në 2013, por edhe për shkak të kërkesave më të rrepta rregullatore për rezervimin e portofolit të kredisë së radhës
- Kujdesi nga bankat në llogaritjen e humbjeve të rrezikut të kredisë,
- Zhvillimet relativisht të mira makroekonomike në këtë periudhë,
- Përdorimi minimal i burimeve të lira të financimit nga entitetet mëmë të huaj në franga zvicerane dhe rrjedhimisht, mungesa pothuajse e huazimit (veçanërisht për popullatën) në franga zvicerane,
- Prirjet e shprehura të bankave për të disponuar një instrument likuid financiar,
- Përmirësimet në treguesit e tregut të punës që kanë kontribuar në përmirësimin e besueshmërisë së popullatës

Analiza empirike konsiston në ndikimin e faktorëve makroekonomik dhe bankar në kreditë me probleme në vendet e Ballkanit Perëndimor, nga parametrat makroekonomik janë përdorur rritja ekonomike për kokë banori, GDP real për kokë banori, inflacioni, norma e papunësisë, norma reale e interesit; ndërsa nga indikatorët e sektorit bankar analizohen kreditë me probleme, kreditë totale si dhe kthimi mesatar në asete (angl. Return on Average Asset: ROAA); kthimi mesatar në kapital (angl. Return on Average Equity: ROAE), si dy tregues kryesorë të profitabilitetit. Ku si variabël e varur është paraqitur kreditë me probleme (NPL) dhe si variabla të pavarura janë konsideruar variablat makroekonomike si: logaritmi i GDP-së reale për kokë banori (RGDP), norma e inflacionit (INFL), norma e papunësisë (UNEMP), norma e interesit (INTEREST), ndërsa si variabla të pavarura nga sektori bankar janë shqyrtuar : kreditë me probleme të vitit paraprak (me një vonesë kohore, NPL_{t-1}) niveli i kredive (KREDIT), kthimi nga asetet (ROA) dhe kthimi nga kapitali (ROE).

Rezultatet e gjeneruara nga analizës empirike tregojnë se:

- Variabla e kredive me probleme me një vonesë kohore (vitit paraprak) në të gjithë modelet rezulton me shenjë pozitive dhe statistikisht e rëndësishme, duke nxjerr në pah perzistencën (vazhdueshmërinë) e kredive me probleme në vendet e Ballkanit Perëndimor.
- Koeficienti i rritjes reale të GDP-së, është gjetur të jetë me shenjë negative dhe statistikisht i rëndësishëm në të gjitha modelet, dhe si rezultat i gjithë testeve të bëra hudhim poshtë hipotezën zero dhe konfirmojmë atë alternative se rritja e GDP-së ka ndikim në kreditë me probleme në vendet e Ballkanit Perëndimor.
- Lidhja midis inflacionit dhe kredive me probleme është gjetur të jetë pozitive dhe statistikisht e rëndësishme në nivelin e rëndësishëm prej 5%, që domethënë se rritja e inflacionit rrit nivelin e kredive me probleme. Pra, nën kushte tjera të pandryshuara nëse norma e inflacionit rritet për një njësi, kreditë me probleme do të rriten për 0.5 njësi, sipas vlerësuesit GMM. Sidoqoftë, ky rezultat konfirmon Hipotezën 2 se norma e inflacionit ka ndikim në nivelin e kredive me probleme në vendet e Ballkanit Perëndimor.

- Për dallim nga studimet tjera koeficienti i papunësisë në të gjitha modelet rezulton me shenjë negative dhe statistikisht i rëndësishëm që është në kundërshtim me pritjet tona. Rritja e normës së papunësisë në fakt duhet që të rrisi nivelin e kredive me probleme dhe jo të zvogëlojë atë. Në bazë të literaturës së shtjelluar në këtë disertacion, pothuajse të gjithë autorët gjejnë lidhje pozitive midis këtyre dy variablave. Pra mund të konfirmohet Hipoteza 3 se norma e papunësisë ka ndikim në nivelin e kredive me probleme, mirëpo lidhja e tyre është e paqartë. Një situatë e tillë mund të jetë karakteristike për këtë rajon pasi që në periudha të caktuara, norma e papunësisë nuk ka lëvizur në proporcion me ciklet e biznesit, sidomos në rastin e Maqedonisë së Veriut dhe Bosnjë dhe Hercegovinës.
- Norma e interesit është në lidhshmëri pozitive dhe statistikisht të rëndësishme me nivelin e kredive me probleme, me signifikançë në nivelin prej 5%. Pra rritja e normës së interesit rrit kreditë me probleme në këtë rajon, me çka konfirmohet Hipoteza 4.
- Rritja e nivelit të përgjithshëm të kredive rrit kredit me probleme, pasi që koeficienti i kësaj variable është me shenjë positive, mirëpo statistikisht i rëndësishëm vetëm në modelet Pooled OLS, Fixed Effects dhe Random Effects, ndërsa jo në modelin 2 SLS dhe GMM. Sipas modelit të efekteve fikse koeficienti është statistikisht i rëndësishëm në nivelin prej 1%, duke konfirmuar Hipotezën 5 se rritja e nivelit të kredisë ka ndikim në nivelin e kredive me probleme.
- Treguesi i kthimit nga asetet (ROA) është negativisht i lidhur me kreditë me probleme, mirëpo koeficienti i kësaj variable rezulton statistikisht jo i rëndësishëm në të gjitha modelet të vlerësuara sipas metodave të ndryshme. Arsyeja kryesore e mos ndikimit të ROA në nivelet e kredive me probleme vjen si rezultat i joefikasitetit të menaxhmentit të bankave në përdorimin e aseteve dhe gjithashtu cilësi më e dobët e kredive. Kështu, rezultati nënkupton që bankat janë më pak stimuluese për kthimin e fituar nga asetet dhe gjithashtu për të siguruar kredi. Rrjedhimisht hudhet poshtë Hipoteza 6 se kthimi nga asetet (ROA) ka ndikim në nivelin e kredive me probleme në vendet e Ballkanit Perëndimor.

- Koeficienti i kthimit nga kapitali (ROE) është me shenjë negative ashtu siç edhe pritej, mirëpo në nivelin e rëndësisë statistikore prej 10%, pothuajse në të gjitha modelet përveç modelit 2SLS. Ky rezultat, siç pritej, tregon se një përkeqësim i raportit të kthimit nga kapitali çon në një rritje të kredive me probleme, duke konfirmuar paraqitjen e rrezikut të bankave. Kjo marrëdhënie negative është gjithashtu në përputhje me argumentin se menaxhimi i keq çon në aktivitete më të rrezikshme dhe performancë më të dobët. Hipoteza 7 mund të konfirmohet, megjithëse signifikanca statistikore është 10%.

Konkluzionet nga punimi mund të ndihmojnë në zhvillimin e një kornizë për vlerësimin dhe matjen e rrezikut të kreditit të bankave, gjë që është veçanërisht e rëndësishme nga aspekti i autoritetit monetar për stabilitetin financiar në vend. Lidhjet ekonometrike të marra në këtë punim mund të përdoren për të parashikuar lëvizjet e ardhshme të kredive jo-performuese, si dhe për testimin e stresit, jo vetëm nga sistemi bankar në tërësi, por edhe në nivelin e bankave funksionuese individuale në vend.

Edhe pse rreziku i kredisë është ndikuar nga cikli ekonomik dhe lidhjet aktuale në mes të prodhimit, të ardhurave dhe kursimeve, ajo mund të jetë në një nivel që mund të menaxhohen përmes dimenzionimit adekuat të kërkesës për kredi dhe strukturës së aktiveve dhe detyrimeve të bankës, i cili gjithashtu kanë një ndikim statistikisht të rëndësishëm në kreditë me probleme. Në këtë drejtim, me rëndësi të madhe është autoriteti monetar ose autoritetet rregullatore, e cila duhet të sigurojë një mjedis të përshtatshëm për ruajtjen e stabilitetit dhe qëndrueshmërinë e sistemit bankar nëpërmjet diagnostikimit në kohë të trazirave të mundshme të tregut dhe marrjen e masave të shpejta për parandalimin e tyre. Në të njëjtën kohë, ata duhet të orientojnë bankat në menaxhimin më të mirë të rrezikut, duke marrë parasysh karakteristikat individuale të bankave individuale. Në këtë drejtim, të kuptuarit e faktorëve kryesorë që nxisin rrezikun e kredisë është vendimtare. Sigurisht, sistemi bankar nuk mund të hequr tërësisht të përballurit me rrezikun e kredisë, duke pasur parasysh se rreziku është pjesë e pandashme e çdo aktiviteti që sjell përfitim, dhe veçanërisht rrezikun si rezultat i kushteve makroekonomike.

Megjithatë, kuptimi i faktorëve specifik bankar që përforcojnë ose reduktojnë efektin e lëvizjeve ekonomike mund të parandalojnë një rritje të mprehtë të rrezikut të kredisë dhe në këtë mënyrë të parandalojnë reagimet negative ndërmjet sektorit financiar dhe ekonomisë reale.

Rekomandimet kryesore që rezultojnë nga ky studim janë:

- Situata makroekonomike është një faktor i rëndësishëm në akumulimin e kredive të reja me probleme.
- Numri në rritje i kredive me probleme është një dëshmi e kushteve të vështira ekonomike që bizneset dhe konsumatorët janë duke kaluar.
- Edhe pse bankat, pasi u shfaq kriza financiare, janë përpjekur për të shtrënguar kreditë nëpërmjet rritjes së normave të interesit për kredi, ato ende kanë një tendencë në rritje.
- Pavarësisht zhvillimeve pozitive në sistemin bankar, bankat duhet të luajnë një rol më të rëndësishëm në zhvillimin e ardhshëm ekonomik.
- Objektivi i bankës duhet të jenë trinomi: mbështetja dhe zhvillimi i ekonomisë, mbështetje dhe respekt për politikën monetare të Bankave Qendrore, zhvillimi i tyre dhe përshtatja me standartet më të mira të industrisë bankare.
- Kujdes i veçantë duhet të merret me kompletimin e dokumenteve, për marje të kredive.
- Menaxhuesit e kredisë duhet të kryejnë kontrolle në të gjitha kompanitë të paktën një herë në vit. Ky kontroll duhet të ndihmojë për të njohur më të mirë situatën në mënyrë që bankat të marrin masa për pagesat e huave.
- Bankat duhet të jenë me konservatore në perzgjedhjen e modeleve të vlerësimit të riskut të kredisë.
- Kujdes i veçantë i duhet kushtuar kredive të reja, sepse po të jenë ato të mira do të rezultojnë në përmirësimin gradual të cilësisë së portofolit të kredisë.
- Pa marrë parasysh situatën aktuale procesi i kreditimit në banka nuk duhet të ndalet, sepse do të ketë efekte negative në kredite me probleme.

- Bankat duhet të përmirësojnë procesin e menaxhimit të riskut të huase,
- Bankat duhet të përmirësojnë mekanizmat për parandalimin dhe zbulimin e mashtrimit.

Menaxhimi i kredive me probleme nuk do të ishte i realizueshëm në qoftë se nuk ka stabilitet makroekonomik dhe politika të shëndosha që janë baza për një mjedis të përgjithshëm të qëndrueshëm dhe të parashikueshëm për funksionimin e bankave dhe subjekteve të tjera ekonomike. Përveç parakushteve makroekonomike, arritjet e sektorit të korporatave, cilësia e menaxhimit të kompanive, por edhe mënyra se si bankat vlerësojnë aftësinë e kreditit të klientëve të tyre kanë një rol veçanërisht të rëndësishëm. Prandaj, çdo reformë në sistemin ligjor ose tatimor, ose në kornizën më të gjerë rregullatore në përgjithësi, nuk do të jepte në vetvete rezultate pozitive në trajtimin e kredive me probleme, nëse ka dobësi në procesin e kredisë dhe menaxhimit joadekuat të rrezikut nga bankat dhe gjithashtu nëse ato dobësi nuk zbulohen me kohë dhe në mënyrë efektive nga autoriteti kompetent mbikëqyrës.

Pajtueshmëria e kornizës së përgjithshme ligjore dhe rregullatore, funksionalitetin e sistemit juridik, rregullimin e qartë të rregullores tatimore dhe shkallën e zhvillimit dhe funksionalitetit të segmenteve të tregut janë fusha që mund të kontribuojnë në përmirësimin e menaxhimit të kredive me probleme. Sidoqoftë, ato nuk mund të jenë zëvendësues për menaxhimin dhe operimin cilësor dhe rritjen e kapacitetit të institucioneve financiare, por edhe debitorëve në sektorin e korporatave.

Prandaj, një segment veçanërisht i rëndësishëm është siguria juridike dhe besimi në sistemin juridik, të cilat janë më të theksuara përmes gjyqësorit efikas dhe ekzekutimit efikas të vendimeve gjyqësore. Premisa themelore për punë të suksesshme afariste është pritja që palët në marrëdhëniet kontraktuale të përmbushin detyrimet e marra. Në këtë mënyrë, subjektet afariste mund të rregullojnë pritjet dhe planet e tyre në aktivitetet e tyre të investimit në të ardhmen. Prandaj, ekziston nevoja për një proces të vazhdueshëm të përmirësimit të efikasitetit të punës së gjykatave, si dhe harmonizim të vazhdueshëm të legjislacionit me praktikën, i cili do të përcaktojë dhe zvogëlojë fërkimet e tregut.

LITERATURA E SHFRYTËZUAR

Adebola, S., Wan Yusoff, S., & Dahalan, J. (2011). *An ARDL Approach to the Determinants of Non-Performing Loans in Islamic Banking System in Malaysia*. Kuĕait Chapter of Arabian Journal of Business and Management Review, 1(2), 20 - 30.

Ahmad , F., & Bashir (a), T. (2013). *Explanatory Power of Macroeconomic Variables as Determinants of Non-Performing Loans: Evidence from Pakistan*. World Applied Sciences Journal, 22(2), 243 - 255.

Ali, A., and Daly, K., (2010) “*Macroeconomic determinants of credit risk: Recent evidence from a cross country study*”, International Review of Financial Analysis 19.

AlihodĒić, A. (2014). *Analiza kretanja nekvalitetnih kredita i profitabilnosti na bankovnom trĒiĒtu u BiH*. Ekonomske teme, 52(3), 341 - 359.

Anderson, T.W., and Cheng Hsiao, (1982), “*Formulation and Estimation of Dynamic Models Using Panel Data*,” Journal of Econometrics, 18, 47-82.

Arellano, M. and Bond, S. (1991), “*Some Tests of Specification for Panel Data: Monte Carlo Evidence and an Application to Employment Equations*,” Review of Economic Studies, 58, 277-297.

Arellano, M., & Bover, O. (1995). *Another Look at the Instrumental-Variable Estimation of Error-Components Models*. Journal of Econometrics, 68(1), 29-51.

Arpa, M. et al., (2001). “*The influence of macroeconomic developments on Austrian banks: implications for banking supervision*”, BIS Papers, 1, 91-116.

Autoriteti Bankar Evropian (European Banking Authority – EBA).

Balgova, M., Michel, N., & Alexander, P. (2016). *The Economic Impact of Reducing Non-Performing Loans*. 6-8.

Bank for International Settlements (BIS 2006)

Bank for International Settlements (BIS 2011)

Barisitz, S. (2011). *Nonperforming loans and CESE—What do they comprise?* Focus on European Economic Integration, Q4/11, Österreichische Nationalbank, Vienna.

Barisitz, S. (2013). Nonperforming Loans in CESEE - An Even Deeper Definitional Comparison. Focus on European Economic Integration Q3/13: https://www.oenb.at/dam/jcr:07a8cd6f-9be6-4472-8ecf-51a5336c5977/fee_i_2013_q3_studies_barisitz_tcm16-257381.pdf

Barisitz, S. (2013). Nonperforming Loans in Western Europe - A Selective Comparison of Countries and National Definitions. Focus on European Economic Integration Q1/13: https://www.oenb.at/dam/jcr:bef7ec58-d7de-4bfl-a39daccf0d339f3e/fee_i_2013_q1_studies_barisitz_tcm16-253775.pdf

Basel Committee on Banking Supervision ,BCBS)

Berge, T., & Boye, K. (2007). *An analysis of bank's problem loan*. Norges Bank Economic Bulletin.

Bernanke, B., Gertler, M., & Gilchrist, S. (1999). *The financial accelerator in a quantitative business cycle framework*. Handbook of macroeconomics, No. 1.

Bexley, J., & Nenninger, S. (2012). *Financial Institutions and the Economy*. Journal of Accounting and Finance, 12(1).

Boudriga Abdelkader, Boulila T. Neila and Jellouli Sana (2009): *Bank Specific, Business and Institutional, Environment Determinants of Nonperforming Loans: Evidence from MENA Countries*, Journal of Financial Economic Policy, Vol. 1 No. 4, Pp. 286-318.

Bozdo, A., & Kripa, E. (2015). *The Impact of Macro-Economic Factors on Non- Performing Loans in Albania*. Academic Journal of Interdisciplinary Studies, 4(3), 540-545.

Cani Sh, (2010), “*Cikel leksionesh – Ekonomi Zhvillimi – Paraja dhe Banka*”,

Caprio, G., & Klingebiel, D. (1996). *Bank Insolvency: Bad Luck, Bad Policy or Bad Banking*. Annual World Bank Conference on Development Economics. The International Bank for Reconstruction and Development.

Castro, V. (2012). *Macroeconomic determinants of the credit risk in the banking system: The case of the GIPSI*. Working papers series NIPE WP 11/2012.

Charalambakis, E., Dendramis, Y., & Elias, T. (2017). *On The Determinants Of NPLS: Lesson From Greece*.

Dr. Evelina Çeliku dhe Dr. Erjon Luçi, 2003, “Ndikimi i qëndrueshmërisë së situatës makroekonomike në nivelin e kredive me probleme”, BSH, fq. 1 – 15.

Dušanić, J. (2003). *Poslovno bankarstvo*. Srpsko Sarajevo i Beograd: Consseco institut.

Espinoza and Prasad 2010, “*Nonperforming Loans in the GCC Banking System and their Macroeconomic Effects*” IMF Working Paper WP/10/224, fq. 1 – 24.

Farhan, M., Sattar Ammara, C. Hussain Abrar, Khalil Fareeha (2012): *Economic Determinants of Non-Performing Loans: Perception of Pakistani Bankers European*; Journal of Business and Management, Vol. 4, No.19, Finance and Challenges of the Future, 7, 118–126.

Ganić, M. (2014). *Bank Specific determinants of Credit Risk - An Empirical Study on the Banking Sector of Bosnia and Herzegovina*. International Journal of Economic Practices and Theories, 4(4), 428 - 436.

Greuning, H., & Brajović Bratanović, S. (2006). *Analiza i upravljanje bankovnim rizicima*. Zagreb: Mate.

Guy, K. (2011). *Non - performing Loans*. The Central Bank of Barbados Economic Review, XXXVII(1).

Hansen, B. E. (1999). *Threshold effects in non-dynamic panels: estimation, testing, and inference*, Journal of Econometrics, 93, 334-368.

Hempel, GH, Simonson, DG and Coleman, AB 1994, *Bank Management*, 4th ed.,

Horne, V., & Wachoëicz, J. (2002). *Osnove financijskog menadžmenta*. Zagreb: Mate.

<http://www.finance.gov.mk/>

<http://www.instat.gov.al/>

<http://www.stat.gov.mk/>

<http://www.worldbank.org>

<https://www.bankofalbania.org/>

Instituti për Financat Ndërkombëtare (Institute for International Finance IIF),

Investopedia, “*Definition of Credit Risk*” www.investopedia.com/terms/c/creditrisk.asp

Jakubík, P., & Reininger, T. (2013). Determinants of nonperforming loans in central, eastern and southeastern Europe. Focus on European Economic Integration, Oesterreichische Nationalbank, 2013(3), 48–66.

Jednak, J. (1999). *Osnovi ekonomije*. Beograd: PA.

Jimenez, G., & Saurina, J. (2006). Credit Cycles, Credit Risk and Prudential Regulation. International Journal of Central Banking, 2(2), 65 - 98. John Wiley & Sons: Neë York.

Jordan Kjosevski & Mihail Petkovski (2017) *Non-performing loans in Baltic States: determinants and macroeconomic effects*, Baltic Journal of Economics, <http://ëëë.tandfonline.com/loi/rbec20>

Keeton, W., & Morris, C. (1987). *Why Do Banks' Loan Losses Differ*. Economic Reviewë: <http://www.kansascityfed.org/PUBLICAT/ECONREV/EconRevArchive/1987/2q87keet.pdf>

Khemaj, T., & Pasha, S. (2009). *The determinants of non-performing loans: an econometric case study of Guyana*. Munich Personal RePEc Archive, Paper No. 53128.

Kiyotaki, N., & Moore, J. (1995). *Credit cycle*. NBER Working Paper Series, No. 5083, 211 - 248.

Klein N. (2013) *Nonperforming loan in CESEE: Determinants and Impact on Macroeconomic Performance*, IMF working Papers 13(72).

Koordinimit Bankar Evropian iniciativa "Vjena" (European Banking Coordination "Vienna" Initiative) : Working Group on NPLs in Central, Eastern and Southeastern Europe)

Louzis, Dimitrios, Aggelos T. Vouldis, and Vasilios L. Metaxas. 2010. "Macroeconomic and Bank-Specific Determinants of Non-Performing Loans in Greece: A Comparative Study of Mortgage, Business and Consumer Loan Portfolios." Bank of Greece Working Paper 118.

Madžar, L., & Jovanović, A. (1990). *Osnovi teorije razvoja i planiranja*. Beograd: Savremena administracija.

Madzova, V., *Upravljanje so kreditniot rizik vo komercijalno bankarstvo*, Skopje, 2010

Makri V., Tsagkanos, A. and Bellas, A. 2014. "Determinants of Non-Performing Loans: The Case of Eurozone", Panoeconomicus, Volume 2, Pp. 193-206

Meka E, (2012), "Cikel Leksionesh – Tregu bankar dhe institucionet e tij",

Meka, E. (2015). *Non-Performing Loans – Thinking and Going Out of the Traditional Box*. European University of Tirana. Available at SSRN: http://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?Abstract_id=2612905

Mirkovic, V. (2013). *Solving the issue of bad debts as an essential factor of stability of the banking system*. Ekonomski vidici, Belgrade.

Moody's Investors Service. (2016). Rating Methodology Banking. Moody's Investors Service: https://www.moody's.com/researchdocumentcontentpage.aspx?docid=PBC_186998

Murgasova, Z., Nadeem, I., Jacques, M., Alasdair, S., & Vladkova-Hollar Ivanna, a. a. (2015). *The western Balkans: 15 years of economic transition*. International Monetary Fund, 2015

Mwanza, N. (2011). *Nonperforming Loans and Macrofinancial Vulnerabilities in Advanced Economies*. International Monetary Fund. Discussion Papers, 18, 1–45.

Otašević, D. (2013). *Macroeconomic determinants of the quality of banks' loan portfolio in Serbia*: http://www.nbs.rs/internet/english/90/90_0/2013_27_DO.pdf

Pradhan, R., & Pandey, A. (2016). *Bank Specific and Macroeconomic Variables Affecting Non-Performing Loans of Nepalese Commercial Banks*. Social Science Research Network: http://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract_id=2793495

Ranjan Rajiv and D. Chandra Sarat (2003): *Non-Performing Loans and Terms of Credit of Public Sector Banks in India: An Empirical Assessment*; India, Reserve Bank of India Occasional Papers Vol. 24, No. 3.

Rinaldi, Laura, and Alicia Sanchis-Arellano. (2006). “Household Debt Sustainability, ěhat Roaf, J. (2013). *Non-Performing Loans in CESEE*

Rottke, N., & Gentgen, J. (2008). *Workout management of non-performing loans, A formal model based on transaction cost economics*. Journal of Property Investment & Finance, 26(1), 59 - 79.

Saba, I., Kouser, R., & Azeem, M. (2012). *Determinants of Non-performing Loans: Case of US Banking Sector*. The Romanian Economic Journal, 44. Pp 479- 88.

Salas, V., & Saurina, J. (2002). *Credit Risk in Těo Institutional Regimes: Spanish Commercial and Savings Banks*. Journal of Financial Services Research, 22(3).

Salko, D. & Dhuci, O. (2008). “*Drejtimi Bankar*”

Selma M. Ahlem and Jouini Fathi (2013): *Micro and Micro determinants of Nonperforming*; Tunisia, International Journal of Economics and Financial Issues. Vol.3, No.4, pp 852-860.

Shehu, E., and Meka, E. (2015). *NPL-s; The Solution Recipe for Albania*.

Shëngjergji, A. (2013). *The Impact of Macroeconomic Variables on the NonPerforming Loans in the Albanian Banking System during 2005-2012*. Academic Journal of Interdisciplinary Studies, 2, 336-338.

Shingjergji (b), A. (2013). *The Impact of Bank Specific Variables on the Non Performing Loans in the Albanian Banking System*. Research Journal of Finance and Accounting, 4(7), 148 - 152.

Sinkey, J., & Greenačalt, M. (1991). *Loan – loss experience and risk – taking behavior at large commercial banks*. Journal of Financial Services Research, 5(1), 43 - 59.

Skarica Bruna (2013): *Determinants of Non-Performing Loans In Central And Eastern European Countries*: Financial Theory and Practice. 38 (1) 37-59.

Swamy, V. (2012). *Impact of macroeconomic and endogenous factors on non-performing banks assets*. International Journal of Banking and Finance, 9(1), 26–47.

Tanasković, S., & Jandrić, M. (2015). *Macroeconomic and institutional determinants of nonperforming loans*. Journal of Central Banking Theory and Practice, 1, 47–62.

Tanasković, S., & Jandrić, M. (2017). *Problematicni krediti: determinante rasta i moguća rješenja*. Kvartalni monitor, 39, 75 - 85.

Tang, H., Zoli, E., & Klytchnikova, I. (2000). *Banking crises in transition economies: fiscal costs and related issues*. The World Bank policy research working paper, no. 2484.

Tomak, S. (2013). *Determinants of Commercial Banks Lending Behavior: Evidence from Turkey*. Asian Journal of Empirical Research, 3(8), 933 - 943.

Trenca, I., & Benyovszki, A. (2008). *Credit risk, a macroeconomic model application for Romania*. Using Panel Data," Journal of Econometrics, 18, 47-82

Turan, G., & Koskija, A. (2014). *Nonperforming loans in Albania*. Academic Journal of Interdisciplinary Studies, 491Universiteti European i Tiranës.Universiteti Tiranës, Fakulteti Ekonomisë

Veličković, D., & Barać, S. (2009). *Makroekonomija*. Beograd: Univerzitet Singidunum.

Vera Zelenovic, Jelena Vitomir, Milan Radovic (2016): *Analysis of NPL in the Republic of Serbia and Selected Countries of South-Western Balkans*: Journal of US-China Public Administration, July 2016, Vol. 13, No. 7, 442-453doi: 10.17265/1548-6591/2016.07.002
Veselinović, P. (2010). *Ekonomija*. Beograd: Univerzitet Singidunum, Fakultet za turistički i hotelijerski menadžment.

Vienna Initiative (2017). NPL Monitor for the CESEE Region H2 2017

Virolainen, K. (2004). *Macro stress testing with a macroeconomic credit risk model for Finland, Bank*

Vogiazas, S. D. and Nikolaidu, E. (2011). “*Investigating the Determinants of Nonperforming Loans in the Romanian Banking System: An Empirical Study With Reference to the Greek Crisis*”, Hindaēi Publishing Corporation, Economics Research International. Vol. 2011.

William R. Keeton, 1999, “*Does Faster Loan Growth Lead to Higher Loan Losses?*”, Economic Review, Second Quarter 1999, fq. 57 – 75.

William, H. Green (2002), *Econometric Analysis*, Fifth Edition.

Williamson, S. (1987), “*Financial Intermediation, Business Failures, and Real Business Cycles*”, Journal of Political Economy, 95(6): 1196–1216

Wooldrige, J. (2012). *Panel Data Models with Heterogeneity and Endogeneity*. Programme Evaluation for Policy Analysis Institute for Fiscal Studies. www.worldbank.org/eca/ebrrer/.

Zeng, Shihong. 2011. “*Bank Non-Performing Loans (NPLS): A Dynamic Model and Analysis in China*.” Modern Economy, 3(1): 100-110.

Zorana Agić, Zoran Jeremić, (2018); *Macroeconomic and Specific Banking Determinants of Nonperforming loans in Bosnia and Herzegovina*, Industrija, Vol.46, No.1, 2018

Zribi, N., and Boujelbene Y. (2011), “The factors influencing bank credit risk: The case of Tunisia”, Journal of Accounting and Taxation, 3(4),7

НБРМ, Стратегија за поттикнување на справување на управувањето и подобрувањето со нефункционалните кредити, Декември, 2018

APENDIKSI

Modeli Pooled OLS

Source	SS	df	MS	Number of obs	=	76
Model	1492.67776	8	186.58472	F(8, 40)	=	49.37
Residual	151.18216	67	3.779554	Prob > F	=	0.0000
				R-squared	=	0.9080
				Adj R-squared	=	0.8896
Total	1643.85992	75	34.2470816	Root MSE	=	1.9441

npl	Coef.	Std. Err.	t	P> t	[95% Conf. Interval]
lnpl	.8553429	.0730269	11.71	0.000	.70775 1.002936
log_rgdp	-8.304137	3.341818	-2.48	0.017	-15.0582 -1.550071
infl	.5650788	.1994147	2.83	0.007	.1620466 .9681109
unemp	-.2920692	.0674854	-4.33	0.000	-.4284623 -.1556761
interest	.4930328	.1614008	3.05	0.004	.1668297 .8192359
roa	-.0906998	1.606177	-0.06	0.955	-3.336904 3.155504
roe	-.3039992	.1887365	-1.61	0.105	-.6854499 .0774516
kredit	.1418154	.0581044	2.44	0.019	.0243821 .2592488
_cons	71.18519	27.76147	2.56	0.014	15.07717 127.2932

Modeli Fixed Effects

Fixed-effects (within) regression	Number of obs	=	76
Group variable: code	Number of groups	=	5
R-sq:	Obs per group:		
within = 0.8224	min =		6
between = 0.6864	avg =		9.8
overall = 0.7450	max =		14
	F(8, 36)	=	20.84
corr(u_i, Xb) = 0.2615	Prob > F	=	0.0000

npl	Coef.	Std. Err.	t	P> t	[95% Conf. Interval]
-----	-------	-----------	---	------	----------------------

```

-----+-----
      lnpl |   .7036833   .0995206    7.07   0.000    .5018461   .9055204
log_rgdp | -10.16757    6.18744   -1.64   0.109   -22.71628   2.381144
      infl |   .1195944   .284437    0.42   0.677   - .4572707   .6964594
      unemp |  -.1365278   .1417237   -0.96   0.342   - .4239568   .1509012
interest |   .3369195   .2648309    1.27   0.211   - .2001824   .8740215
      roa |   1.528344   1.56377    0.98   0.335   -1.643129   4.699817
      roe |  -.3790118   .2019961   -1.88   0.069   - .788679    .0306553
      kredit | .3315768   .0799116    4.15   0.000    .1695086   .4936449
      _cons |  77.84618   55.24146    1.41   0.167   -34.1887   189.8811
-----+-----
sigma_u |   2.99518
sigma_e |   1.7039045
      rho |   .7554999   (fraction of variance due to u_i)
-----+-----
F test that all u_i=0: F(4, 36) = 4.02                      Prob > F = 0.0085

```

Modeli Random Effects

```

Random-effects GLS regression              Number of obs   =       76
Group variable: code                     Number of groups =        5

R-sq:                                     Obs per group:
      within = 0.7724                               min =        6
      between = 0.9799                               avg  =       9.8
      overall = 0.9080                               max  =      14

Ewald chi2(8) = 394.93
corr(u_i, X) = 0 (assumed)                 Prob > chi2      =    0.0000

```

```

-----+-----
      npl |      Coef.   Std. Err.      z    P>|z|     [95% Conf. Interval]
-----+-----
      lnpl |   .8553429   .0730269   11.71   0.000    .7122128   .9984729
log_rgdp | -8.304137    3.341818   -2.48   0.013   -14.85398   -1.754295
      infl |   .5650788   .1994147    2.83   0.005    .1742332   .9559243
      unemp |  -.2920692   .0674854   -4.33   0.000   - .4243382   -.1598002
interest |   .4930328   .1614008    3.05   0.002    .1766931   .8093725
      roa |  -.0906998   1.606177   -0.06   0.955   -3.238748   3.057348
      roe |  -.3039992   .1887365   -1.61   0.100   - .673916   .0659177
      kredit | .1418154   .0581044    2.44   0.015    .027933    .2556979
      _cons |  71.18519   27.76147    2.56   0.010   16.77371   125.5967
-----+-----
sigma_u |           0
sigma_e |   1.7039045
      rho |           0   (fraction of variance due to u_i)
-----+-----

```

Testi i Hausmanit

hausman fixed random

```

      ---- Coefficients ----
      |      (b)      (B)      (b-B)      sqrt(diag(V_b-V_B))
      |      fixed    random    Difference      S.E.
-----+-----
lnpl |      .7036833      .8553429      -.1516596      .0676123
log_rgdpc |     -10.16757     -8.304137     -1.863428      5.207367
infl |      .1195944      .5650788     -.4454844      .2028256
unemp |     -.1365278     -.2920692      .1555414      .1246247
interest |      .3369195      .4930328     -.1561133      .2099648
roa |      1.528344     -.0906998      1.619044      .
roe |     -.3790118     -.3039992     -.0750127      .0719788
kredit |      .3315768      .1418154      .1897613      .0548611
-----+-----
      b = consistent under Ho and Ha; obtained from xtreg
      B = inconsistent under Ha, efficient under Ho; obtained from xtreg

Test:  Ho:  difference in coefficients not systematic

      chi2(8) = (b-B)' [(V_b-V_B)^(-1)] (b-B)
              =      21.48
      Prob>chi2 =      0.0060
      (V_b-V_B is not positive definite)

```

Testi i homogenitetit

```

xthst npl lnpl log_rgdpc infl unemp interest roa roe kredit
Testing for slope heterogeneity
(Pesaran, Yamagata. 2008. Journal of Econometrics)
H0: slope coefficients are homogenous
-----
      Delta      p-value
      2.679      0.017
adj.   2.913      0.009
-----
Variables partialled out: constant

```

Testi Breusch-Pagan

xttest2

Correlation matrix of residuals:

	__e1	__e2	__e3	__e4	__e5
__e1	1.0000				
__e2	-0.6449	1.0000			
__e3	0.4027	0.0823	1.0000		
__e4	-0.0382	-0.3416	0.3491	1.0000	
__e5	-0.3318	0.0235	0.3937	0.9259	1.0000

Breusch-Pagan LM test of independence: $\chi^2(10) = 11.686$, $Pr = 0.3066$
Based on 5 complete observations over panel units

Modeli 2SLS

Instrumental variables (2SLS) regression	Number of obs	=	46
	F(3, 4)	>	99999.00
	Prob > F	=	0.0000
	R-squared	=	0.9038
	Root MSE	=	1.9959

(Std. Err. adjusted for 5 clusters in code)

	npl	Coef.	Robust Std. Err.	t	P> t	[95% Conf. Interval]
log_rgdp		-7.814334	3.884932	-2.01	0.115	-18.60064 2.971967
lnpl		.8443217	.0739237	11.42	0.000	.6390767 1.049567
infl		.5708289	.1821193	3.13	0.035	.0651848 1.076473
unemp		-.289915	.087569	-3.31	0.030	-.5330456 -.0467844
interest		.521399	.144228	3.62	0.022	.1209579 .9218401
roa		-.2747157	1.905504	-0.14	0.892	-5.565244 5.015812
roe		-.2874115	.2405943	-1.19	0.298	-.9554083 .3805853
kredit		.124655	.0939793	1.33	0.255	-.1362733 .3855833
_cons		67.76654	30.99799	2.19	0.094	-18.29768 153.8308

```
Instrumented:  log_rgdpdc
Instruments:  lnpl log_rgdpdc infl unemp interest roa roe kredit log_kredius
-----
```

Modeli GMM

```
Arellano-Bond dynamic panel-data estimation      Number of obs      =      71
Group variable: code                             Number of groups   =      5
Time variable: year

Obs per group:
    min =      5
    avg =      8.2
    max =     12
```

```
Number of instruments =      26      Wald chi2(4)      =      112.59
Prob > chi2          =      0.0000
```

One-step results

(Std. Err. adjusted for clustering on code)

	npl	Coef.	Robust Std. Err.	z	P> z	[95% Conf. Interval]
npl	L1.	.7074933	.2165261	3.27	0.001	.28311 1.131877
log_rgdpdc		-7.97334	7.178808	-1.92	0.046	-22.41952 8.072843
infl		.5241878	.2220728	2.36	0.023	.0753619 .9730136
unemp		-.1859058	.0675903	-2.75	0.009	-.3225108 -.0493008
interest		.50549	.2146632	2.35	0.024	.0716394 .9393406
roa		-2.119187	1.670604	-1.27	0.212	-5.495605 1.257231
roe		-.3039992	.2005273	-1.68	0.074	-.7476803 .139682
kredit		.0645855	.0797976	0.81	0.423	-.0966914 .2258623
_cons		2.308499	5.082146	0.45	0.652	-7.962901 12.5799

Instruments for differenced equation

GMM-type: L(2/.) .npl

Standard: D.log_rgdpdc D.infl D.unemp D.roa D.roe D.interest
D.log_kredius kredit roa

Arellano - Bond testi

```
. estat abond
```

Arellano-Bond test for zero autocorrelation in first-differenced errors

Order	z	Prob > z
1	-1.7622	0.0780
2	-2.6197	0.0354

+-----+
H0: no autocorrelation